PËRMBAJTJA











Portreti i muajit: Në luftë çlirim, në liri bashkim . 2

Dr. Milazim Krasniqi: Serbia përgatit sulm parlamentar – "e paprovokuar me asgjë" 3-4

Muhamet Jahiri: Kushtetuta ende po sfidohet ... 5-6

Muhamet Jahiri: Riformatizimi i Qeverisë 6

Lulzim Ahmeti: "Rruga e Kombit" nis më 1 Maj 7-8

Qëndresa Mustafa: EULEX-i propozon gjyqtarë serbë të riemëruar nga Beogradi 9-10

Dukagjin Avdyli: Serbia vodhi trashëgiminë tonë kulturore 10-12

Mr. Milazim Mustafa: "Rasti i Sopotit" – gjykimi i montuar i radhës 13-14

Osman D. Gashi: Sferizmi 15-16

Drita Vitia: Shumë shkolla e pak nxënës 16-18

Përparim Bublaku: Katër teste për gjashtë lëndë 19

Intervistë me Ismet Kabashin 20-21

Ferdi Kamberi: Edukata fetare – element konstruktiv apo dekonstruktiv? 22-23

Muhamed J. Kajolli: Në kërkim të marrëveshjes dhe Beteja e Siffinit 24-27

Drita Azemi: Muslimanët nuk skanohen 28

Somalia: aty ku puqet jeta me vdekjen 29-30

Shenasi Xheladini: Tragjikomedia e një diktatori?! . 31-33

Bujar Isma: Martesa dhe divorci nga këndvështrimi psikologjik 34

Flet për revistën 'Paqja', ish ministri Valton Beqiri . 35-36

Tetë shtete në "Monoakt" 36-37

Filmi shqiptar në Festivalin e Kanës 37

Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Astma bronkiale – problematikë në rritje 38

Alban Bilalli: Pas shënimit të golit bën sexhde ... 39

Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti V / Nr. 41

19 prill 2010 - 19 maj 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Në luftë çlirim, në liri bashkim



Ministri i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit Fatmir Limaj ka merita të veçanta në projektin madhor për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Merdar. Ai njëherësh është nënshkrues i kontratës ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumit amerikano-turk "Bechtel & Enka" për ndërtimin e autostradës Vërmicë – Merdar. Në një konferencë për gazetarë, ka shpalosur edhe hollësitë rreth fillimit të ndërtimit. Ceremonia e rastit do të mbahet më 25 prill, në ora 13. "Jemi krenarë të themi se kjo është kontrata më e mirë në regjion", - ka thënë Limaj. Lidhur me segmentin Dule - Shtime, Limaj konfirmoi se brenda gjashtë muajsh, kompania do të paraqesë së paku dy variante dhe më pas Qeveria do të vendosë për projektin më të leverdishëm. Ai përsëriti se Qeveria preferon që ky segment të mos ketë tunele. Autostrada është paraparë të jetë e gjerë 28 metra me 4 shirita qarkullues dhe çdo qendër do të mund të kyçet në të. Shpejtësia e qarkullimit do të jetë deri në 120km/h. ■

BIOGRAFIA: **Fatmir Limaj** lindi më 4 shkurt të vitit 1971 në Kosovë. Është një nga politikanët më karizmatikë dhe më aktivë të Kosovës, jurist shqiptar dhe ish-luftëtar i Ushtrisë Çlirmtare të Kosovës. Gjatë luftës çlirimtare, Fatmir Limaj ka qenë njëra nga figurat qendrore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas fitores së luftës së UÇK-së dhe aleancës veriatlantike të NATO-s mbi gjenocidin serb, Fatmir Limaj, megjithatë është detyruar të përballet edhe me sfidën e drejtësisë ndërkombëtare, akuzat e të cilës i sfidoi me mbrojtje briliante. Në një proces të vështirë gjyqësor në Tribunalin e Hagës, por gjithmonë me mbështetjen e popullit të Kosovës, Fatmir Limaj dhe bashkëluftëtarët e tij, arritën që edhe përmes këtij tribunali, të dëshmojnë pastërtinë e luftës çlirimtare dhe sakrificën sublime të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Si shef i Grupit Parlamentar të PDK-së në Kuvendin e Kosovës, Fatmir Limaj ka përçuar frymën e unitetit veprues të klasës politike të Kosovës. Ka të mbaruar Fakultetin e Drejtësisë dhe magjistraturën në drejtimin administrativo-politik në po këtë fakultet.





Ballkanoskopia

Serbia përgatitit sulm parlamentar "e paprovokuar me asgjë"

Me iniciativën më të re të Kuvendit të Serbisë, për dënimin e krimeve të shqiptarëve ndaj serbëve, strategjia për bllokimin e shtetit të Kosovës do të njohë eskalime të reja. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë shteg tjetër veçse të detyrohen të shikojnë edhe prapa, në të kaluarën e afërt, së paku si në retrovizor.



Dr. Milazim KRASNIQI

Kryetarja e Kuvendit të Serbisë ka filluar procedurat parlamentare për hartimin e një deklarate, me të cilën do të dënohen krimet që janë shkaktuar ndaj serbëve në Slloveni, në BeH, në Kroaci dhe në Kosovë, gjatë konflikteve dhe luftërave të viteve nëntëdhjetë. Sipas tezave që ajo tashmë ia ka ofruar komisionit përkatës të Kuvendit serb, pritet që të dënohen me fjalor të ashpër edhe "krimet e shqiptarëve", të kryera kundër serbëve në Kosovë. Tezat e deklaratës, sigurisht, që do të ndryshojnë gjatë punës në komisionet parlamentare, por ajo që nuk do të ndryshojë më është fakti se Kuvendi i Serbisë po e përgatit atë deklaratë/rezolutë me të cilën do të ngrihen akuza të reja kundër shqiptarëve të Kosovës. Akuzat për fajësinë e shqiptarëve, gjithsesi, do të shërbejnë si një stimulues i ri për nacionalizmin serbomadh, "që të mos harrohet Kosova", në kohën kur sipas hulumtimeve të opinionit publik, interesimi i qytetarëve serbë për Kosovën po pëson rënie. Mobilizimi me anën e prodhimit të emocioneve të forta nacionaliste, lidhur me krimet e kryera ndaj serbëve, do të arsyetohet me sintagmën e njohur, "nicim izazvanim", e cila praktikisht nuk mund të përkthehet tamam, por përafërsisht do të thotë që ata që kanë kryer krime ndaj serbëve, i kanë kryer ato "të paprovokuar me asgjë". Në retorikën parlamentare serbe paraqiten tepër paqësorë dhe të pafajshëm edhe policët, edhe paramilitarët, edhe ushtarët e Serbisë, pra, të gjithë ata që kanë djegur e pjekur gjithçka që u ka dalë përpara në marshimin e tyre satanik për krijimin e Serbisë së Madhe.

Sido që të venë punët, përpjekja e Kuvendit serb me deklaratën e re do të jetë shumë serioze, për të bërë edhe botën që të anojë drejt krijimit të ekuilibrit të krimeve, për të gjetur pastaj një mënyrë që ato të arkivohen në harresë të plotë. E pas harresës së krimeve, Serbia të rifillojë me entuziazëm të ri dhe me "moral të ri" betejën për riserbizimin e çështjes së Kosovës, jo vetëm në forumet ndërkombëtare, por edhe në terren, me riaktivizimin e falangave destabilizuese, si ato të "Cërna Rukës" e të "Narodna Odbranës", para pushtimit faktik të Kosovës në vitin 1912.

Hapin e parë për krijimin e ekuilibrit ndërmjet krimeve të kryera në hapësirat e ish- Jugosllavisë, Kuvendi serb e ka bërë më 31 mars, kur miratoi Deklaratën për Srebrenicën. Në pikën 1 të deklaratës dënohet ashpër " krimi i bërë mbi banorët boshnjakë në Srebrenicë në korrik 1995, në mënyrën që është dëshmuar me gjykimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe të gjitha proceset shoqërore e politike dhe dukuritë që kanë sjellë formimin e vetëdijes që realizimi i qëllimeve nacionale mund të arrihet me përdorimin e forcës së armatosur dhe dhunën fizike mbi pjesëtarët e popujve të tjerë dhe religjioneve të tjera, duke shprehur me këtë rast, ngushëllime dhe falje familjeve të viktimave, meqë nuk është bërë e gjitha për t'u shmangur tragjedia". Pra, në Deklaratë askund nuk përmendet fjala gjenocid, edhe pse

krimi në Srebrenicë është kualifikuar si gjenocid edhe nga Gjykata Ndërkombëtare. Por, edhe me këtë mangësi drastike, Deklarata e Kuvendit të Serbisë për Srebrenicën, tashmë është përshëndetur nga shumë shtete e shtetarë, si një hap i madh përpara. Entuziazmi i tyre në ndonjë rast është pervers, gati i ngjashëm me gëzimin e ushtarëve holandezë, kur po ia dorëzonin Mlladiqit Srebrenicën. Dhe me këtë gatishmëri, që çdo gjest simbolik i Serbisë të kualifikohet si "hap i madh përpara", ka mundësi që edhe Deklarata që do të dënojë "krimet e shqiptarëve" të paketohet si një "hap përpara".

Për të shmangur një zhvillim të atillë, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të duhej që t'i fillonte urgjentisht procedurat për hartimin e një rezolute, ku do të dënohej krimi serb i spastrimit etnik dhe i gjenocidit në Kosovë në vitet 1998/1999. Besoj se nëse do të nisnin procedurat parlamentare në këtë frymë, me siguri që do të aktivizohej "diplomacia e miqve", për ta ndalur, por në atë rast janë dy rrugë: ose ajo të hartohet e të miratohet, gjë që do të ishte e drejtë dhe në fakt e domosdoshme, ose do të kërkohej që të neutralizohej presioni dhe ndërhyrja e mëtejshme serbe në Kosovë.

E mira e punës ka qenë që një rezolutë të tillë Kuvendi i Kosovës ta kishte miratuar shumë më herët, sepse përmasat e krimeve serbe të spastrimit etnik dhe të gjenocidit janë të dokumentuara nga shumë institucione ndërkombëtare dhe nga vetë intervenimi i NATO-s dhe sjellja e misionit të OKB-së për ndalimin e "katastrofës humanitare". E mira e punës ka qenë, gjithashtu, që Kosova ta kishte paditur Serbinë edhe në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Lufte, për gjenocidin që ka kryer në Kosovë. Një akuzë të kësaj natyre ndaj Serbisë e pati ngritur BeH, por edhe Kroacia.

Fatkeqësisht, në këto vite, institucionet e Kosovës i kanë zbatuar tej mase këshillat e miqve, për të shikuar "vetëm përpara". Por, Serbia nuk ka ndjekur aso këshillash. Ajo tërë kohën ka mbetur duke shikuar prapa në të kaluarën dhe duke bërë përpjekje që ta bllokojë dhe ta rrënojë të tashmen e Kosovës. Me iniciativën më të re të Kuvendit të Serbisë, për dënimin e krimeve të shqiptarëve ndaj serbëve, strategjia për bllokimin e shtetit të Kosovës do të njohë eskalime të reja. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë shteg tjetër veçse të detyrohen të shikojnë edhe prapa, në të kaluarën e afërt, së paku si në retrovizor.

Një faktor që e ushqen entuziazmin e institucioneve ndërkombëtare me hapat simbolikë të Serbisë, duke i kualifikuar si "hapa të mëdhenj përpara", është natyra e opozitës serbe. Duke qenë një opozitë nacionaliste, ajo vazhdimisht po e frikëson Perëndimin, gjë që po e detyron t'i bëjë favore Boris Tadiqit, si një politikan më i moderuar dhe më europeist. Kjo skemë ka funksionuar në Serbi, gjatë dy viteve të fundit, me shumë sukses, madje që nga fushata parazgjedhore, kur Bashkimi Europian i dha si shpërblim Tadiqit ftesën e stabilizim-asocimit. Në fakt, Kosova nuk ka nevojë për një opozitë aq nacionaliste e destruktive si ajo që është në Serbi, por pa dyshim që ka nevojë për një opozitë më aktive dhe më kërkuese në raport me politikat ndaj Serbisë. Vetë fakti që lëvizja "Vetëvendosje" po afirmohet përditë e më shumë si një alternativë politike, është tregues i nevojës së qytetarëve të Kosovës që të kenë një zë më të vendosur në mbrojtje nga agresionet permanente të Serbisë.







Ndërsa, nëse vazhdon kjo indolencë e institucioneve shtetërore, po edhe e opozitës aktuale, në kontekstin e radikalizimit të arrogancës së Serbisë, kjo nevojë do të rritet gjithnjë e më shumë. Miratimi i deklaratës kundër shqiptarëve në Kuvendin e Serbisë dhe komplikimet që mund të sjellë brenda vetë Kosovës, po edhe në skenën ndërkombëtare, do të jetë një gur prove. Partitë politike dhe liderët politikë të Kosovës duhet ta harxhojnë më shumë energji në këtë problematikë, se sa në luftën e palavdishme kundër njëri-tjetrit. ■

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka shënuar dyvjetorin e saj të miratimit

Kushtetuta ende po sfidohet



Muhamet JAHIRI

Dy vjet pas miratimit Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfaqësues të ndryshëm të subjekteve politike kanë vlerësuar se akti më i lartë juridik i vendit po vazhdon të sfidohet në shumë forma, e sidomos me shtirjen e saj në pjesën ku banojnë pakicat serbe. Shumica prej tyre akuzojnë institucionet e vendit për mospërkushtim të zbatimit të saj si dhe për shkelje të vazhdueshme që po i bëjnë.

Bajrami: Kemi ende sfida për të kaluar



Deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Arsim Bajrami, njëherësh ekspert i çështjeve kushtetuese, duke folur për dyvjetorin e Kushtetutës ka thënë se janë dy segmente kryesore që sfidojnë në masën më të madhe shtrirjen e autoritetit kushtetues.

E para, sipas tij, është shtrirja e kushtetutshmërisë në veri dhe e dyta, definimi i përgjegjësive të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, që beson se do të ndodhë pas kalimit të fazës së pavarësisë së mbikëqyrur.

"E para ndër misionet e kësaj Kushtetute, që nuk është realizuar, pa dyshim se është shtrirja e autoritetit të saj në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe themelimi i strukturave legale kushtetuese në tërë territorin e vendit, sidomos në pjesën veriore, ku Kushtetuta nuk ka arritur ta shtrijë autoritetin e saj dhe ku ende kemi veprim të ligjeve të shteteve të tjera, që është një atak ndaj sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe kjo do të jetë sfida kryesore", - ka thënë Bajrami.

Kryeziu: Kushtetuta ka sjellë edhe gjëra pozitive



Edhe nënkryetari dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Eqrem Kryeziu, ka shprehur besimin se problemet e kushtetutshmërisë nuk duhet shikuar vetëm me gjendjen në veri, ku ekzistojnë probleme politike. Ai ka deklaruar se duhet të shikohen edhe gjërat pozitive në pjesët e tjera, ku gjendja është më e mirë.

"Veriu është një çështje gati teknike, krahasuar me problemet e tjera të institucioneve demokratike, që duhet të konstituohen gjatë këtij rrugëtimi të gjatë. Ky është një proces, që do të thotë se zbatimi i Kushtetutës është proces dhe të gjithë duhet të përpiqemi ta zbatojmë atë", - ka deklaruar Eqrem Kryeziu.


Daci: Kushtetuta në shërbim të fiseve qeveritare



Por ndryshe mendon opozita, sipas të cilës Kushtetuta e Kosovës është në krizë. Kjo jo vetëm për shkak të moszbatimit të saj në veri të vendit, por edhe nga shkeljet që po i bëhen asaj nga ana e institucioneve të Kosovës. Nexhat Daci, kryetari i Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD) dhe njëherësh edhe deputet i Kuvendit të Kosovës, ka thënë se dokumenti më i lartë juridik i vendit po shërben për interesat e fiseve dhe klaneve të qeverisë.

"Kushtetuta po zbatohet në përpikëri të plotë për interesat e fiseve të qeverisjes në Kosovë, të kryefiseve ose të shefave të fiseve dhe nuk respektohet në asnjë element të shtetësisë së Kosovës, në asnjë element të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës", - ka theksuar Daci, duke shtuar se të gjitha rrjedhat që po shkojnë në Kosovë, duke u nisur nga krimi i organizuar, dalin nga mosrespektimi i obligimeve të rëndomta.

Isufi: Presidenti i vendit dhe veriu po e shkelin Kushtetutën



Edhe deputeti dhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka deklaruar se Kushtetuta e vendit nuk po arrin të gjejë shtrirje në gjithë vendin, si dhe po shkelet nga prijësit më të lartë të institucioneve.

"Dy vjet pas Kushtetutës, kemi mosrespektim të saj, duke filluar nga presidenti i vendit e deri te mosshtrirja e saj në gjithë territorin e Kosovës dhe zbatimin e ligjit në nivel të ulët", - ka thënë Isufi, duke shtuar se ligjet dhe obligimet kushtetuese kanë mbetur vetëm të shkruara në letër.

"Mund të themi se dy vite kanë kaluar në këtë gjendje, por duhet që tash e tutje të kemi ndryshime në mënyrën e veprimit, sepse shtrirja në të gjithë territorin është obligim për institucionet tona", - ka theksuar Isufi.

Makolli: Kushtetuta ka probleme sepse është kompromis



Po ashtu, deputeti dhe nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Ibrahim Makolli, ka deklaruar se akti më i lartë juridik i vendit ka dalë si kompromis mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve dhe si pasojë e kësaj ka mjaft defekte.

"Kushtetuta, edhe në kohën kur është miratuar dhe është hartuar, ka dalë si kompromis mes vendorëve dhe

ndërkombëtarëve dhe për këtë arsye ka mjaft defekte, të cilat duhet të rregullohen në ecje e sipër, sepse ka pjesë të cilat e ngushtojnë hapësirën e veprimit dhe zhvillimit", - ka deklaruar Makolli.

Sipas tij, akti më i lartë juridik i vendit nuk po gjen zbatueshmëri në të gjithë territorin e vendit, si dhe po shkelet rëndë nga ata të cilët më shumti janë përgjegjës për ta ruajtur atë.

"Madje kemi pjesë të territorit të Kosovës ku kjo kushtetutë as që ka filluar ende të zbatohet, qoftë në ndonjë pjesë të saj. Institucionet e vendit, për shkak të paaftësisë së tyre, nuk kanë arritur të bëjnë asgjë për shtrirjen e saj në tërë territorin e vendit, prandaj kushtetuta është në krizë", - është shprehur Ibrahim Makolli.

Petroviq: Për komunitetin serb është bërë shumë



Pavarësisht kësaj, Sllobodan Petroviq, kryetar i Partisë së Pavarur Liberale, njëherësh deputet në Kuvendin e Kosovës, ka deklaruar se është i kënaqur me zbatueshmërinë e Kushtetutës. Ai ka thënë se viteve të fundit po vërehen përparime të dukshme në jetën e komunitetit serb.

"Varet se nga cila perspektivë e shikoni, por mendoj se për dy vjet e gjysmë, për komunitetin serb është bërë më shumë, sesa për dhjetë vjetët e fundit", -ka theksuar Petroviq.

Kushtetuta e Kosovës u miratua dy muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke i dhënë fund udhëheqjes dhe administrimit nëntëvjeçar të OKB-së mbi Kosovën.

Pra, Kushtetuta e Kosovës është miratuar më 9 prill të vitit 2008 dhe është fuqizuar po të njëjtin vit, më datën 15 qershor. ■



Riformatizimi i Qeverisë

Muhamet JAHIRI

Pas më shumë se gjatë muajsh nga paralajmërimet për riformatizimin e qeverisë, më në fund ka ndodhur një gjë e tillë. Thaçi ka thënë se ndërrimi i ministrave është bërë sipas kritereve në vlera profesionale, politike, afirmative dhe në kuadër të kredibilitetit, të cilin e gëzojnë këto personalitete. Ai i ka falënderuar ministrat e larguar për punën e deritashme, duke thënë se ministrat e larguar kanë pasur nderin e madh që së bashku me të si kryeministër, të jenë me sukses në krye të përgjegjësive të tyre gjatë procesit parapërgatitor për shpalljen e Kosovës shtet, pastaj në procesin e shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, por edhe në angazhimet e mëtutjeshme shtetndërtuese dhe rritjes së efikasitetit në qeverisjen e mirë.

Thaçi, ka paralajmëruar se në kuadër të riformatizimit të qeverisë, do të ketë edhe ndërrime të tjera në ditët në vijim.

LDK-ja ka vendosur vetë për ministrat e saj

Pas një varg mbledhjesh të Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kjo e fundit, më në fund, ishte përcaktuar për zëvendësimin e tre ministrave të saj.

Anëtari i Kryesisë i kësaj partie, Salih Asllani, i ka bërë publike emrat e ministrave të rinj që do të jenë nga radhët e kësaj partie.

"Jo, nuk mendoj se i jemi nënshtruar kryeministrit. Ky është vlerësim i LDK-së, nuk ka lidhje me vlerësimet e PDK-së. Kjo është punë e brendshme. Nuk është e ndikuar fare nga kryeministri", - është shprehur Asllani.

Opozita ndryshimet në qeveri i quan "kozmetike"

Pavarësisht ndryshimeve dhe ndërrimit të gjashtë ministrave në Qeverinë e Kosovës, për përfaqësuesit e partive opozitare kjo është vetëm një lojë e qeverisë dhe se nuk do të ndryshojë asgjë në mentalitetin e qeverisjes.

Nënkryetari i AKR-së, Ibrahim Makolli, duke folur për ndryshimet në qeveri ka thënë se ndërrimi i disa ministrave të kabinetit qeveritar nuk paraqet ndonjë lajm, por është i rëndësishëm ndryshimi i mentalitetit qeverisës.

"Ndryshimet më së miri do t'i dëshmojë e ardhmja. Tashmë edhe opinioni është lodhur, pasi këto ndryshime ishin paralajmëruar qe gjashtë muaj", -është shprehur Makolli.

Ndërkaq numri dy në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ndryshimet në Qeverinë e Kosovës i ka vlerësuar farsë, për t'i larguar ministrat, të cilët, sipas tij, nuk kanë qenë të përfshirë në afera korruptive.

Sipas tij, pavarësisht ndryshimeve të ministrave, kjo qeveri nuk do ta ketë prioritet interesin e qytetarëve.

Ngjashëm me mendimin e partive të tjera, edhe nënkryetari i LDD-së, Naser Rugova, ndërrimin e ministrave në Qeveri e ka quajtur ndryshim kozmetik dhe lojë me peshqit e vegjël.

"Është hipokrizi kur nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, gjatë fushatës e ka fyer dhe akuzuar qeverinë dhe kryeministrin Thaçi, tani bëhet Ministër i Kulturës", - është shprehur nënkryetari i LDD. ■



Ministrat e shkarkuar:
Nekibe Kelmendi (Ministre e Drejtësisë)
Alush Gashi (Ministër i Shëndetësisë)
Valton Beqiri (Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit)
Arsim Bajrami (Ministër i Administratës Publike)
Idriz Vehapi (Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural)
Zenun Pajaziti (Ministër i Punëve të Brendshme)

Ministrat e rinj:
Haki Demolli - Ministër i Drejtësisë
Bujar Bukoshi -Ministër i Shëndetësisë
Lutfi Haziri - Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Edita Tahiri - Ministër i Administratës Publike
Blerand Stavileci - Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Bajram Rexhepi - Ministër i Punëve të Brendshme
Besim Beqaj - Ministër i Integrimeve Evropiane

Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur marrëveshje me kompaninë "Bechtel & Enka" për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Prishtinë-Merdare

"Rruga e Kombit" nis më 1 Maj

Projekti për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Prishtinë-Merdare, e cila lidh Kosovën me Shqipërinë, pritet të fillojë në muajin maj, ndërkaq ndërtimi i saj do të kushtojë rreth 700 milionë euro, mjete këto që do të sigurohen nga buxheti i Kosovës, donatorët dhe nga marrja e kredive të buta.



Lulzim AHMETI

Punimet për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Prishtinë-Merdare, e cila lidh Kosovën me Shqipërinë pritet të fillojnë në fillim të muajit maj, pas miratimit nga ana e qeverisë së Kosovës së propozim-vendimit të komitetit drejtues ndërministror për nënshkrimin e marrëveshjes me konzorciumin amerikano-turk "Bechtel & Enka", për fillimin e ndërtimit të autostradës Vërmicë-Prishtinë-Merdare, i pagëzuar edhe ndryshe si "Rruga e Kombit". Projekti do të kushtojë rreth 700 milionë euro, mjete që duhet të sigurohen nga buxheti i Kosovës, donatorët potencialë dhe kreditë e buta. Marrëveshja e arritur i jep të drejtë qeverisë që, pas secilit segment të përfunduar, ta shkëpusë kontratën me kompaninë. Kohëzgjatja e punimeve, nga dita e fillimit të tyre, do të jetë 36 muaj ditë pune. Kryeministri Hashim Thaçi ka thënë se realizimi i këtij projekti dëshmon se shteti i Kosovës ka krijuar ambient të sigurt për realizimin e projekteve të mëdha. "Është projekti më i madh dhe dua të theksoj se është mrekulli që po fillojmë me këtë projekt madhor në kohën që kriza globale financiare ende nuk ka përfunduar", - është shprehur ai. Thaçi ka theksuar se i gjithë procesi i përzgjedhjes së kompanisë ka qenë i hapur dhe transparent dhe në përputhje me ligjet e Kosovës. "Autostrada i jep Kosovës definitivisht dalje në det, e ndihmon tregtinë e Kosovës, i ndihmon qytetarët, duke u krijuar mundësi të reja të lëvizjes së lirë. Po ashtu, ndërtimi i autostradës do të krijojë mijëra vende të reja pune". Sipas tij, autostrada do të ndërtohet me standardet më të larta evropiane.

"Për aq sa kemi para, rruga do të vazhdojë."

Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit (MTPT), Fatmir Limaj, tha se të gjitha fazat e këtij procesi të gjatë janë zhvilluar në mënyrë të efektshme dhe transparente. Sipas tij, deri më tani nuk është përcaktuar se nga do të shkojë autostrada, por dihet se deri në Duhël është e qartë, ndërsa se nga do të vazhdojë autostrada më tutje, kjo do të dihet pas studimit të kompanisë. "Kontrata do të bëhet sektor pas sektori që nënkupton varësisht nga mundësitë tona financiare. Për aq sa kemi para do ta vazhdojmë projektin e rrugës. Kështu do të vazhdojmë deri në Qafën e Duhlës. Kur të arrijë këtu, kompania do t'i ofrojë Qeverisë së Kosovës tri studime të mirëfillta të projektit. Më pas Qeveria të marrë vendimin qw të vazhdojë rrugën në drejtim të Carralevës, ose do të gjejë rrugë të tjera alternative, varësisht se si është interesi i vendit", - ka





shpjeguar ai. Ministri Limaj ka thënë se rruga do të fillojë në Vërmicë dhe do të përfundojë në Merdare, ndërsa po qe se nuk do të ketë mjete, sipas tij, mund të mbetet vetëm deri në Prizren, derisa të sigurohen mjetet. "Me këtë mënyrë të përzgjedhjes së financimit, mendoj se kemi para të mjaftueshme. Por, mund të ndodhë që të mos ketë para dhe këto gjëra duhet t'i kemi të qarta", - tha ai. Ndërkaq zëvendësministri i ekonomisë dhe financave (MEF), Bedri Hamza, ka thënë se janë tri mundësi për financimin e autostradës. "Burimi i parë do të jetë financimi nga buxheti, financimi nga të hyrat e njëhershme qoftë nga privatizimi ose koncesionimi dhe financimi ose burimi i tretë do të jetë nga kreditë", - u shpreh ai.

Kujdes me mënyrën e financimit

Eksperti i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka thënë se mënyra e financimit të autostradës duhet të analizohet me shumë kujdes dhe të shihen konsekuencat që mund të ketë hyrja në borxhe për qëndrueshmërinë buxhetore të Kosovës. "Ajo që unë sugjeroj është që të studiohet maksimalisht mundësia e dhënies me koncesion, aq sa ka mundësi edhe të shkohet me këtë formë, sepse hyrja në kredi mund të na krijojë më vonë vështirësi buxhetore dhe telashe me financimin e nevojave publike për zhvillim dhe për konsum", -ka deklaruar Mustafa, duke shtuar se nëse jepet me koncesion, atëherë për një kohë e shfrytëzon ai që investon në të dhe, pas asaj periudhe, kjo do të mbetet pasuri nacionale. Kurse ish-ministri i ekonomisë dhe financave, Haki Shatri, ka thënë se për një projekt që nuk dihet çmimi, nuk mund të kërkohet financim. "Është shumë primitive mënyra e veprimit të Qeverisë për këtë projekt, sepse për t'u bërë një punë ashtu si duhet, duhet të jetë projekti detal dhe teknik dhe të dihet saktësisht sa punë ka aty dhe të dihet kostoja e përgjithshme, e pastaj të merret vesh për burimin e financimit", - ka deklaruar ai. Anëtari i AAK-së thotë se hyrja e Qeverisë në kredi të reja, pa e pasur projektin e përgatitur, është shumë primitive. "Vetë mënyra e veprimit është shumë primitive, sepse nuk është brenda kritereve normale të veprimeve", - u shpreh ai. Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime të Avancuara, (GAP), Shpend Ahmeti, ka thënë se që nga fillimi projekti për autostradën ka qenë jotransparent, pasi që sipas tij nuk dihen kushtet sipas të cilave tenderin e ka fituar "Bechtel & Enka". "Në vlerësimet që janë bërë prej ekspertëve, ata vlerësojnë se pjesët e autostradës janë ekonomikisht të kthyeshme. Mirëpo ka pjesë që kushtojnë shumë shtrenjtë dhe është një pyetje për qytetarin e Kosovës se a dëshiron ta ndërtojë një rrugë të tillë dhe ta paguajë atë borxh", - është shprehur Ahmeti. Konsorciumi "Bechtel & Enka", në ofertën e vet, kishte propozuar që të eliminoheshin tunelet dhe traseja të kalonte nga Merdara, Prishtina, Sllatina, që lidhte aeroportin dhe të kalonte nga rruga ekzistuese në Komoran, Arllat, ku më pastaj do të vazhdonte drejt Malishevës, Suharekës dhe Prizrenit.

Çfarë përfshin autostrada?

Oferta e prezantuar nga kompania "Bechtel & Enka" përfshin ndërtimin e dy fazave të segmenteve të autostradës. Faza e parë përfshin ndërtimin e segmentit A1, A2, plus B3 nga Vërmicë-Prizren-Therandë-Orllat, me gjatësi prej 60.7 km, e cila pritet të përfundojë brenda 24 muajve nga dita e fillimit të punimeve, me një kosto përafërsisht 7. 5 deri në 8 milionë euro për kilometër rrugor. Ndërsa faza e dytë përfshin ndërtimet e segmentit Sllatinë-Besi, me gjatësi prej 27 km dhe pritet të përfundojë brenda 36 muajve nga nënshkrimi i kontratës, ku kostoja përafërsisht do të jetë e njëjtë - 7.5 deri në 8 milionë euro për kilometër rrugor. MTPT-ja, pas arritjes së marrëveshjes me kompaninë "Bechtel & Enka", konzorciumin amerikano-turk, është duke vazhduar negociatat për çështjet teknike se si do të realizohet kjo autostradë që të jetë më e leverdishme dhe më e favorshme për ekonominë e vendit tonë. Autostrada do të jetë e gjerë 28 metra dhe do të ketë dy shirita qarkullues me gjerësi 3.5 metra. Kjo autostradë do të jetë e tipit të mbyllur me hyrje dalje vetëm nëpër kyçje. Do të ketë mburojë mbrojtëse dhe mure kundër zhurmës. Numri në total i atyre që do të punësohen në këtë projekt, për tri vjet pune, do të jetë rreth gjashtë mijë punëtorë, prej të cilëve katër mijë vendorë. ■

Kundërshtohet që dy gjyqtarët serbë, të riemëruar nga Kuvendi i Serbisë, të kthehen në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

EULEX-i propozon gjyqtarë serbë të riemëruar nga Beogradi



Qendresa MUSTAFA

Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), javë më parë ka propozuar kthimin e dy gjyqtarëve shqiptarë, dy serbë dhe dy ndërkombëtarë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Ky propozim është produkt i konsultimeve të vazhdueshme që misioni i BE-së ka pasur me Prishtinën dhe Beogradin, për atë që EULEX-i e vlerëson si çështje emergjente - kthimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve vendës në veri të Mitrovicës.

Mirëpo jo të gjithë janë pajtuar me kthimin e dy gjyqtarëve serbë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, me arsyetim se janë të riemëruar nga Kuvendi i Serbisë.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Enver Peci, ka thënë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë duhet të funksionalizohet, por jo me gjyqtarët serbë të riemëruar nga Beogradi.

“Qëndrimi i KGJK-së është që Gjykata e Qarkut në Mitrovicë duhet të funksionalizohet, por jo me gjyqtarët që e kanë kaluar sistemin gjyqësor të Kosovës në një juridiksion tjetër”, - ka thënë Peci për revistën"Paqja".

Edhe Kapllan Baruti, kryetar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, e cila zhvillon punën në Vushtrri, e ka quajtur të parregullt përfshirjen e dy gjyqtarëve serbë në sistemin gjyqësor të Kosovës.

“Ne, prej fillimit, kemi qenë të gatshëm të punojmë me gjyqtarë serbë që edhe ata të inkuadrohen në punën tonë, por ndërkohë është ndërruar situata dhe këta gjyqtarë janë zgjedhur nga organet e Serbisë. Nuk është e rregullt që këta gjyqtarë të punojnë në gjyqësorin e Kosovës”, - ka theksuar Baruti.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Instituti Ballkanik të Politikave (IPOL), Seb Bytyçi, ka thënë se propozimi për funksionalizimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë është një ndër arritjet më të mëdha në punën e EULEX-it.

“Kjo ka qenë një prej arritjeve të EULEX-it në tremujorin e parë të këtij viti, sepse ka marrë disa hapa për funksionalizimin e Gjykatës së Qarkut në veri. Në këtë rast nuk varet gjithçka prej EULEX-it, por prej disponimit politik”, - ka thënë Bytyçi

Peci : Nuk kemi marr qëndrim për gjyqtarët serbë

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Enver Peci, ka treguar se ky këshill ende nuk ka marrë ndonjë qëndrim rreth propozimit të EULEX-it për vendosjen e gjyqtarëve në gjykatën në veri të Mitrovicës.

Peci ka thënë se një vendim i tillë nuk është marrë për shkak se dy gjyqtarët serbë, të propozuar nga EULEX-i, janë të riemëruar nga Kuvendi i Serbisë.

“Këta dy gjyqtarë nuk mund të vazhdojnë punën në gjyqësorin e Kosovës sepse nuk kanë legjitimitet”, - ka thënë Peci.

Ai ka deklaruar se qëllimi i KGJK-së është që në Mitrovicë të ketë vetëm një gjykatë dhe të mos krijohet ndasi për punëtorët administrativë të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

"Nuk duhet të ketë ndarje të gjykatave në veri të Mitrovicës. KGJK-ja

është duke u munduar që stafi administrativ i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të cilët punojnë që prej dy vitesh në Vushtrri, të kalojë në gjykatën në veri të Mitrovicës, por ky si duket është një problem politik", - ka thënë Peci.

Baruti: Refuzojmë që gjyqtarët serbë të shkojnë në veri e ne në Vushtrri

Edhe Kapllan Baruti, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, e cila zhvillon punën në Vushtrri, ka thënë se çështja e dy gjyqtarëve serbë të riemëruar nga Kuvendi i Serbisë duhet të zgjidhet nga institucionet e Kosovës.

"Nëse politika shtetërore dhe ajo e gjyqësorit pajtohen që në gjykatën e Mitrovicës të dërgohen gjyqtarët serbë që janë riemëruar nga Kuvendi i Serbisë, atëherë ne jemi organ që i zbatojmë vendimet e tyre", - ka deklaruar Baruti.

Ai ka thënë se është e pakuptimtë që dy gjyqtarët serbë të punojnë në veri të Mitrovicës, ndërsa një pjesë e punëtorëve të gjykatës të zhvillojnë punën në Vushtrri.

“Kategorikisht e kemi refuzuar këtë propozim që të shkojnë dy gjyqtarë ser-





bë në veri të Mitrovicës dhe ne tjerët të mbesim këtu në Vushtrri", - ka deklaruar Baruti, duke shtuar se gjykata që ai udhëheq që nga viti 2008 e zhvillon punën jashtë objektit të saj.

"Ne kemi kërkuar dhe insistojmë që të kthehet situata në gjendjen e mëparshme dhe të gjithë ata që kanë punuar deri më 20 shkurt 2008, pra e njëjta përbërje, të vazhdojnë punën në gjykatën në veri të Mitrovicës", - ka theksuar Baruti.

Bytyçi: Funksionalizimi i gjykatës hap i mirë i EULEX-it

Drejtori ekzekutiv i Instituti Ballkanik të Politikave (IPOL), Seb Bytyçi, ka deklaruar se EULEX-i, me propozimin për kthimin e dy gjyqtarëve serbë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, nuk është duke bërë lojë në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

"Nuk mendoj se EULEX-i po bën lojë me propozimin e dy gjyqtarëve serbë për Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, po është duke u përpjekur të bëjë një zgjidhje, por kjo varet prej Prishtinës dhe Beogradit. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe e heshtur vetëm për t'i pranuar këta gjyqtarë", - është shprehur Bytyçi

Ai ka theksuar se ky propozim është bllokuar nga zyrtarët kosovarë për shkak se dy gjyqtarët serbë janë të riemëruar nga Beogradi.

"Ky problem po mbahet i bllokuar për shkak se zyrtarët kosovarë nuk po pajtohen për kthimin e gjyqtarëve serbë të riemëruar nga Beogradi", - ka thënë Bytyqi.

Gjykatat në veri të Kosovës u mbyllën dy vjet më parë, pasi një numër protestuesish serbë, në kundërshtim të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, e morën atë nën kontroll. Ato u liruan vetëm pas ndërhyrjes së autoriteteve ndërkombëtare, që çoi në vdekjen e një pjesëtari të policisë së UNMIK-ut, pas përplasjes me protestuesit serbë. Ndërsa për momentin, gjykata në veri të Mitrovicës funksionon me dy prokurorë dhe katër gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it. ■

Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) konsideron se autoritetet nga Prishtina dhe Beogradi e kanë politizuar çështjen e kthimit të gjyqtarëve shqiptarë dhe serbë në gjykatën në veri të Kosovës. "EULEX-i nuk mund të ndërhyjë në vendimet politike mes Prishtinës e Beogradit. Është urgjente nevoja e kthimit të gjykatësve shqiptarë dhe atyre serbë në Gjykatën në veri të Kosovës", - ka thënë zëdhënësi i EULEX-it, Hanns Christian Klasing.
Ai ka deklaruar se ky mision është duke zhvilluar bisedime me autoritetet nga Prishtina dhe Beogradi për të arritur një zgjidhje sa më të shpejtë për kthimin e këtyre gjyqtarëve në veri të Mitrovicës.
"EULEX-i ka vendosur kontakte dhe po zhvillon bisedime me të dyja palët për të arritur një zgjidhje për Gjykatat në veri, por kjo çështje është komplekse dhe aspak të lehtë", - është shprehur Christian Klasing.

Serbia vod



Dukagjin AVDYLI

Politika degraduese e Serbisë ndaj Kosovës më së shumti ka qenë e drejtuar në aspektin e monumenteve kulturore, me qëllim që të na zhvishte nga trashëgimia jonë, e me këtë të vinte në përfundimin se shqiptarët e Kosovës nuk kanë kulturë, me çka do të mund ta dëshmonte autoktoninë e saj në këto troje si popull. Me këtë, ajo deshi t'ia mbushte mendjen botës se Kosova i përket Serbisë e, si rrjedhojë, nuk mund të ekzistojë si shtet më vete.

Këtë propagandë politike të Serbisë, në të gjitha sferat që kanë të bëjnë me të drejtën e shqiptarëve mbi Kosovën e sidomos në atë të monumenteve kulturore, e kanë përtypur si të vërtetë dhe vazhdojnë ta përtypin ende pothuajse të gjithë faktorët e rëndësishëm ndërkombëtarë. Bile, ky përvetësim i monumenteve kulturore shqiptare nga Serbia është pranuar nga shqiptarët me miratimin e Kushtetutës së Kosovës, e cila nuk është tjetër, veçse pjellë e Pakos së Ahtisarit. Mark Velleri, një njohës i mirë i çështjeve ndërkombëtare, në librin "Shtetësia e Kontestuar" për raportin Pako – Kushtetutë thotë: *"Në kundërshtim me nenin 16 të Kushtetutës, dokumenti i Ahtisaarit është në fakt dokumenti më i lartë juridik në Kosovë. Dokumenti i Ahtisarit ishte "propozim", i cili megjithatë doli të jetë "obligim" për Kosovën. Burimi i këtij obligimi është vetë kufizimi i sovranitetit që kishte ofruar Kosova në Deklaratën e Pavarësisë"*. (fq. 407)

(Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës] Pika 1 - Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.)

Pakoja e Ahtisarit, e cila mori vizën për t'u zbatuar në Kosovë, si nga ndërkombëtarët ashtu edhe nga Kuvendi i Kosovës duke e miratuar atë, është njëri nga dokumentet që e mban Kosovën ende peng të Serbisë dhe favorizon këtë të fundit, duke i dhënë eksterritorialitet në Kosovë.

hi trashëgiminë tonë kulturore

Në këtë dokument, i cili u kthye në Aktin më të Lartë Ligjor, ka tendenca që t'i falet Serbisë trashëgimia jonë kulturore e fetare, e me këtë të vuloset "lashtësia" e popullit serb, ndërsa ne të konsiderohemi ardhacakë, barbarë, a çfarëdo tjetër që i shkon për shtati manipuluesve serbë të kompleksuar nga inferioriteti në raport me ne, kur e dinë se ata janë të ardhur e jo ne. Me këto lëshime që kanë bërë shqiptarët nga trysnia e faktorit ndërkombëtar, me ndihmën e manipuluesve profesionistë serbë, janë shkelur faktet historike, arkeologjike, monumentet kulturore, demografike dhe çdo gjë tjetër që dëshmon në favor të shqiptarëve dhe në kundërshtim me propagandën e pashije serbe.

Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit, janë dy nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe fetare, të cilat nga pakoja e Ahtisarit janë përcaktuar si zona të mbrojtura, e që faktikisht asnjëherë nuk kanë qenë të rrezikuara nga shqiptarët. Të dyja këto dhe të gjitha monumentet e tjera ortodokse serbe, të cilat janë përcaktuar si Zona të Mbrojtura, udhëhiqen direkt nga Beogradi dhe ende vazhdojnë t'i implementojnë ligjet e Serbisë në Kosovë të nxjerra para vitit 1999, duke mos i respektuar ligjet e Kosovës.

Në bazë të aneksit V të pakos së Ahtisarit, Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit janë dy nga monumentet e trashëgimisë kulturore e fetare, të cilat gëzojnë mbrojtje dhe të drejta, privilegje e imunitete. Ushtrimi i këtyre të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve, bart më vete edhe detyra dhe përgjegjësi për të vepruar në pajtim me ligjet e Kosovës dhe për të mos shkelur të drejtat e të tjerëve. Me këtë tregohet se sa i mangët është ky dokument, kur në njërën anë thotë se kjo është pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe me seli në Beograd dhe, në anën tjetër, thotë se përgjegjësia për veprim duhet të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës. Si mund të zbatohen këto të dyja përnjëherë, kur dihet se politika e Beogradit nuk e njeh Kosovën si shtet dhe ligjet e Serbisë nuk mund të jenë të zbatueshme në një shtet tjetër, siç është në këtë rast Kosova?

Gjithashtu, në bazë të këtij aneksi dhe të çdo rregulle tjetër në lidhje me këtë, nuk lejohet të ndryshohet forma e as dukja e monumenteve kulturore, gjë e cila ka ndodhur në këto dy objekte. Në Patriarkanën e Pejës është ndërtuar muri, i cili është i gjerë 80 cm dhe i lartë 3 m, pastaj i është ndryshuar ngjyra çka realisht nuk është dashur të ndodhë, sepse nëse asaj dhe monumenteve tjera iu ndryshohet forma dhe ngjyra, atëherë ato do ta humbnin vlerën e tyre që kishin.

Drejtori i Institutit Regjional për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, z. Avdyl Hoxha, ka treguar se si trajtohet ky institut nga udhëheqësit serbë të këtyre objekteve. Ata nuk lejojnë as vizita në to pa bërë kërkesë dhe që së bashku me ta, të jenë edhe përfaqësues ndërkombëtarë dhe jo t'i vizitojnë ato në cilësinë e përfaqësuesve të këtij instituti, por si individë dhe pas vizitës të mos japin asnjë deklaratë për media. Derisa me shqiptarët ndodh kështu, serbët mund të vijnë kur të duan në këto objekte dhe kudo qoftë në Kosovë, madje edhe udhëheqësit serbë, vijnë në to si të ishin në Serbi, japin deklarata për media, të cilat gjithmonë kanë qëllime destruktive dhe nxisin dhunë ndëretnike.

Z. Hoxha, gjithashtu, theksoi se si të gjithë përfaqësuesit specialë të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, kanë dhënë pjesë të tokave të Kosovës për këto dy objekte. Duke i marrë këto vendime, pa u bazuar asnjëherë në akte ligjore, këto monumente kanë përfituar pjesë të mëdha të territoreve duke marrë 700 – 800 hektarë Manastiri i Deçanit dhe 60 hektarë Patriarkana e Pejës. Me këtë janë shkelur të drejtat e banorëve shqiptarë të dy qyteteve, sepse atyre iu është ndaluar shfrytëzimi i pasurisë së tyre, gjë që ka nxitur revoltë te ta. Banorët përreth këtyre monumenteve, për ndërtimin e një objekti në pronat e tyre, të cilat gjenden afër kishave e manastireve "serbe" në Kosovë, duhet ta marrin lejen për ndërtim nga Këshilli i Bashkësisë Ortodokse Serbe, çka bie ndesh me ligjin, që vë në pikëpyetje se a është më i lartë ligji e shteti, a një organizatë fetare.


Patriarkana e Pejës

Kjo i bie si të themi se rreth xhamisë nuk mund të ndërtohet asgjë pa u pyetur Këshilli i Bashkësisë Islame, pra është jonormale që për leje ndërtimi të pyetet një bashkësi fetare, kur dihet se me ligj këto leje i japin institucionet përkatëse për ndërtime, çka do të thotë se edhe në këtë pikë shkelet ligji vetëm për të mos ia prishur qejfin Serbisë.

Sipas z. Hoxha nuk është e nevojshme që të ruhen këto objekte, meqenëse këto për një kohë të gjatë janë ruajtur nga familjet shqiptare. Patriarkana është ruajtur nga familja Nikqi dhe Manastiri i Deçanit nga familja Kuqi.


Ndërkaq, derisa serbët pretendojnë që këto objekte i takojnë trashëgimisë kulturore e fetare serbe, historianët shqiptarë ofrojnë fakte se këto objekte në lashtësinë e tyre kanë qenë objekte fetare shqiptare, katolike ose iliro-romake dhe në themelet e tyre ose në afërsi të tyre janë ndërtuar objekte të reja. Ndryshe, Manastri i Deçanit njihet nga UNESKO si monument ortodoks bizantin dhe jo serbo-sllav dhe stili i ndërtimit të tij është i stilit iliro-romak ose gotik, çka nuk ka të bëjë me ndërtimet e stilit ortodoks serb.

Sipas deklaratave nga punëtorët shkencorë, të cilët merren me këtë çështje në territorin ku tani gjendet Patriarkana e Pejës, më herët ka qenë një monument shqiptar dhe në afërsi të themeleve të atyre tri kishave të vogla që kanë qenë, është ndërtuar Patriarkana, çka do të thotë se ajo nuk mund të quhet Patriarkanë. Thuhet se në Pejë patriarkana ka ekzistuar vetëm dhjetë vite, në shek. e 17-të, dhe ka pasur karakter politik, që shqiptarët katolikë të kthehen në fenë ortodokse serbe, mirëpo duke e parë mossuksesin në këtë drejtim Patriarkana është tërhequr në Beograd. Gjithashtu, në Pejë patriark nuk ka, por në Beograd.

Shteti serb e ka shfrytëzuar fuqinë që ka pasur, për ta vënë në diskutim çështjen nëse ne jemi popull autokton në këtë territor. Përveç moslejimit të pushtetit serb që të bëhen gjurmime për ta vërtetuar lashtësinë e kulturës shqiptare, në këtë drejtim ka ndikuar negativisht edhe gjendja e dobët materiale e popullit shqiptar, çka ka bërë që të mos bëhen hulumtime serioze. Historianët dhe arkeologët shqiptarë, kanë botuar kohëve të fundit edhe një libër, në të cilin janë hartat, të cilat tregojnë se ku duhet të bëhen studime, por kostoja e tyre është shumë e lartë. Gjithashtu edhe një këshill është duke punuar në drejtim të zbardhjes të së vërtetës.

Në nenin 6, pika 1, aneksi V i Pakos së Ahtisarit, është thënë se: "Republika e Serbisë brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, do t'i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike, të cilat janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë viteve 1998-1999". Një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe askush nuk çan kokën të merret me këtë çështje, pavarësisht se në pikat e tjera ndërkombëtarët kanë qenë shumë rigoroz për zbatimin e tyre, e sidomos në dhënien e tepërt të të drejtave për minoritetet, gjë të cilën nuk e kanë bërë as në shtetet e tyre "demokratike". Përsëri edhe këtu vërehet diskriminimi që u bëhet shqiptarëve në raport me serbët, ngase kur është një ligj në të mirë të serbëve, shteti i Kosovës duhet ta respektojë patjetër, ndërkaq kur diçka duhet të shkojë në favor të shqiptarëve, ai ligj shkelet shumë brutalisht para syve të ndërkombëtarëve, të cilët bëjnë kinse se nuk po shohin.

Duke e ditur që monumentet kulturore paraqesin vlera shpirtërore e materiale të një populli dhe se me anë të tyre vërtetohet lashtësia e një populli, institucionet e Kosovës duhet të bëjnë trysni më të madhe tek institucionet relevante ndërkombëtare, si UNESCO, që është institucioni më i lartë botëror për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të botës, që të njihet trashëgimia jonë kulturore e fetare. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpresojmë që statusi i Kosovës të mund të definohet njëherë e përgjithmonë dhe kështu të shkojmë drejt forcimit të shtetit dhe të fitojmë sovranitetin e vërtetë. ■


Manastiri i Deçanit

"Rasti i Sopotit" gjykimi i montuar i radhës



Mr. Milazim MUSTAFA

Derisa proceset e montuara gjyqësore, tashmë janë veç pjesë e historisë së popujve të lirë, në Maqedoni, për shqiptarët ato akoma kurdisen. Përkundër rekomandimeve dhe këshillave të shumta për reforma dhe qasje serioze të problemit të gjyqësisë, punët nuk lëvizin aspak nga e mbara.

Prej pavarësimit të këtij shteti, kemi me dhjetëra raste të proceseve të montuara politike gjyqësore, ku si zakonisht, të akuzuarit janë shqiptarët. Ndër rastet më të freskëta është i ashtuquajturi "Rasti i Sopotit". Sopoti është një fshat në Republikën e Maqedonisë, që shtrihet në zonën kufitare mes Republikës së Maqedonisë dhe Luginës së Preshevës. Nga po ky fshat janë 11 banorët të dënuar për vendosjen e një mine në mars të vitit 2003, me ç'rast humbën jetën dy ushtarë polakë të NATO-s dhe një përkthyes, shtetas i Maqedonisë. Duke e pasur parasysh faktin se në truallin e Maqedonisë u vranë dy ushtarë të NATO-s, politika shtetërore duhej të gjente një fajtor për këtë rast dhe të paraqitej para subjektit ndërkombëtar se fajtorët u gjetën dhe u dënuan. Me procedurë ekspresе, fajtorët u dënuan me gjithsej 156 vjet burg.

Pas kësaj filluan dhimbjet dhe katrahurat për familjarët dhe për gjithë shqiptarët e Maqedonisë. Prej kësaj periudhe, rasti i Sopotit, ka qenë dhe akoma mbetet pjesë e pandarë e kampanjës së partive politike, duke luajtur me ndjenjat e familjarëve të këtyre personave që, fatkeqësisht, po vuajnë dënimin e shqiptuar nga gjykatat e Maqedonisë.

Dënimi i shqiptuar është marrë në bazë të dëshmitarit Ramadan Bajrami, i njohur për qarqet shqiptare të anës së Kumanovës si person jostabil dhe herë-herë edhe si bashkëpunëtor i shërbimeve policore. I njëjti kinse "është keqtrajtuar dhe ka qenë i detyruar të tregojë se kush janë fajtorët për këtë rast". Aspekti logjik i këtij rasti na shtyn të mendojmë ndryshe, por edhe ai profesional juridik na bën që këtë rast ta fusim në rastet e turbullta, ku politika i përzien gishtat të drejtësi.



Dr. Afrim Osmani

I pyetur për këtë rast, Afrim Osmani, doktor i të drejtës dhe procedurës penale, tregon se, rasti i Sopotit është një rast politik, nga i cili fatkeqësisht pësuan 11 qytetarë shqiptarë të Sopotit, por edhe familjarët e tyre. Pikë së pari, procedura ka mbaruar si rezultat i dhënies së një dëshmie dhe deklarate të një dëshmitari me përdorim të dhunës, kërcënimit dhe torturës, gjë kjo që bie ndesh me ligjin e procedurës penale, ku thuhet se deklarata, dëshmia, prova, e cila jepet duke përdorur dhunën, kërcënimin, forcën, torturën nuk merret si provë e procedurës penale. Ndërsa kjo dëshmi ishte kryesorja në këtë procedurë. Më pas, "Rasti i Sopotit" mori një kah tjetër, duke hyrë nëpër labirintet partiake dhe politike, gjë që e shfrytëzuan partitë shqiptare, si ajo në pushtet ashtu edhe ajo në opozitë. Çështja e Sopotit nuk është çështje që duhet të zgjidhet në parlament, por është çështje e organeve gjyqësore dhe duhet të zgjidhet në gjyqësor. Por në një shtet siç është Republika e Maqedonisë ndodhin edhe gjëra të tilla, - thotë Osmani. Në qoftë se pas aktgjykimit gjyqësor kalon një kohë e caktuar, palës së pakënaqur i pamundësohet me ligj të parashtrojë mjet të rregullt juridik. Ligji i procedurës penale i mundëson parashtrim të mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Një nga ato mjete është edhe përsëritja e procedurës. Kjo ndodh kur dëshmohet se aktgjykimi është bazuar në dokumente të rrejshme ose në deklaratë dhe dëshmi të rrejshme të dëshmitarit, ekspertit ose interpretuesit.

Procedura përsëritet edhe nëse janë parashtruar fakte të reja ose prova të reja, që janë të përshtatshme për zgjidhjen e rastit. Si fakte të reja në "Rastin e Sopotit" na paraqitet vetë dhënia e dëshmisë se deklaratës së vetme të dëshmitarit nga i njëjti fshat, i cili deklaratën e ka dhënë nën presionin e policisë. Sipas Osmanit, momentalisht shpresa e vetme është në Gjykatën Supreme, si instanca e fundit gjyqësore e vendit. Shpresojmë që më në fund të fitojë drejtësia, - shtoi ai.

I pyetur për punën e komisionit anketues parlamentar, të formuar enkas për këtë rast, Osmani tha se "komisioni anketues i këtij rasti i dha vetëm një kah politik, duke u përdorur për marketingje politike të partive politike shqiptare. Të gjitha materialet e grumbulluara nuk u morën parasysh nga gjykata e apelit, por morën kah politik.

Vlen të ceket se në këtë procedurë si dëshmitar nga ky komision ishte i ftuar edhe ish-ambasadori i NATO-s në Maqedoni, Nikolas Bigman, i cili deponoi dëshminë e tij në interes të të dëmtuarve, duke thënë mes rreshtave se shqiptarët janë ndër përkrahësit më të mëdhenj të NATO-s në Ballkan dhe se dyshon se shqiptarët mund ta kenë bërë një akt të tillë dhe se ky rast është një montim nga organet e RM-së.

Për këtë rast u drejtuam edhe në prokurorinë e Republikës së Maqedo-

nisë, ku kontaktuam një nga pak prokurorët shqiptarë, i cili kërkoi të mbetej anonim, duke treguar se pozita e tij nuk ia lejonte të prononcohej për media për këtë rast. Ky person, në konfidencë, tha se nuk është respektuar procedura penale. Për vetë faktin se dëshmitari kryesor ka deklaruar publikisht në media se ka qenë i kërcënuar të japë dëshmi të rrejshme dhe se këto nuk i ka paraqitur gjatë procedurës, por pas mbarimit të saj, fillimisht është dashur që vetë ky person të shpallej fajtor për dhënien e dëshmisë së rrejshme dhe të meritonte dënimin në bazë të ligjit. Këtë ua kemi thënë edhe anëtarëve të komisionit anketues, por fatkeqësisht asnjëri prej tyre nuk është jurist që t'i kuptojë këto punë ashtu siç duhet. Me shpalljen e dëshmitarit si fajtor, do të binte poshtë procedura paraprake, ku janë dënuar banorët e Sopotit. Kjo ishte mënyra më e mirë për ta zgjidhur këtë rast.


Tahir Hani

Tahir Hani, koordinator i grupit parlamentar të partisë shqiptare në pushtet, ishte kryetar i komisionit anketues për "Rastin e Sopotit". Ai deklaroi se kanë kryer punë të madhe dhe se kanë mbledhur dëshmi të shumta nga institucionet shtetërore. Në mes të tjerash kanë intervistuar edhe ish-ambasadorin e NATO-s dhe ish- kryeministrin e Maqedonisë z. Vlado Buçkovskin, të cilët kanë dhënë dëshmi në favor të banorëve të Sopotit. Mirëpo dëshmitë e tyre dhe raporti përfundimtar i këtij komisioni nuk është marrë aspak parasysh nga Gjykata e Apelit, që në formacion të këshillit gjyqësor, të përbërë prej pesë gjykatësve, ka miratuar vendimin e Gjykatës themelore. Hani shpreson se Gjykata Supreme do të nxjerrë në pah padrejtësitë e gjykatave të instancave më të ulëta të gjyqësorit të Republikës së Maqedonisë.

Shpresojmë që "Rasti i Sopotit" do të nxjerrë në shesh defektet e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë. Do t'i nxjerrë të gjitha padrejtësitë, mosrespektimin e ligjit, shkeljen e të drejtave të njeriut, manipulimet e llojllojshme, montime të rasteve, përdorimin e dhunës gjatë dhënies së dëshmisë, si dhe një sërë rastesh ku qytetarët e pafajshëm bëhen viktimë e lojërave të mëdha politike dhe globale. Se me të vërtetë është jashtë çdo logjike që një minë ta vendosin 11 persona, të gjithë të moshave të ndryshme. ■

Xhezair Shaqiri

Pak kohë më parë, ish-deputeti Xhezair Shaqiri në një emision në TV Alsat M, përmendi edhe emrin e saktë të personit që ka vënë minën, për të cilën janë dënuar 11 banorët e fshatit Sopot. Ai përmendi emrin e Artim Destanit, një banor i fshatit Llojan, për të cilin tha se ka qenë i manipuluar nga strukturat e UDB-së dhe DBK-së së Maqedonisë. Ky person, sipas informatave nga disa banorë të fshatit Llojan, në kohën kur ka ndodhur ky rast, ka pasur vetëm 15 vjet. "Komandant Hoxha" e bëri këtë, pas kërkesës publike të familjarëve të të dënuarve të Sopotit, që ky i fundit ta tregojë emrin e personit nga vepra e të cilit po vuajnë familjarët e tyre.




Të akuzuarit në gjykatë


Familjarët në protestë para selisë së BDI-së


Prezantimi i zbulimit më të ri të shkencëtarit shqiptar, prof. dr. Rifat Gjota



Osman D. GASHI

Sferizmi

***Të gjitha të vërtetat janë të thjeshta për t'u kuptuar nëse i zbuloni, por duhen zbuluar njëherë.* – L. Da Vinçi**



Zbuluesi dhe shkencëtari shqiptar, prof. dr. Rifat Gjota, gjatë Panairit të Turizmit, i cili u mbajt në fillim të muajit prill në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë, prezantoi zbulimin e tij, Sferizmi, nën ndihmesën dhe organizimin e kompanisë softuerike Appdec.




Çka është sferizmi?

Sferizmi është një zbulim, që e përfaqëson profesor Gjota, përmes të cilit është arritur një definim i ri i pakufishmërisë dhe është bërë jetësimi i imagjinares, e cila tash e tutje mund të llogaritet si realitet. Ose me fjalë të tjera, sferizmi është një trajtim hapësinor i funksioneve në kuadër të sferës, një mundësi e vështrimit të pjesës imagjinare, ku edhe e pakufishmja bëhet e vazhdueshme, bëhet reale.

E tërë kjo ka filluar qysh në kohën e studimeve themelore në Shkup, atëbotë kur shkencëtari Gjota i kishte thënë profesorit të matematikës që "bota është e rrumbullakët, do shihemi prapë në shtator". Ishte kjo thënie që pastaj për 50 vite nuk e kishte lënë rehat këtë zbulues, duke ndërtuar shumë ide e mendime në kokë, por ishin dy pyetje që nuk mund t'i tejkalonte e të mos gjente përgjigje për to, dhe tani pas tërë këtyre viteve heshtjeje ai doli para opinionit publik, duke treguar përgjigjet për pyetjet që llogariteshin "pa përgjigje" nga kolegët, profesorët dhe shkencëtarët e tjerë. Gjota i gjeti përgjigjet për pakufishmërinë dhe me e pa imagjinaren dhe e tërë kjo mund të arrihet përmes sferizmit.

Si realizohet sferizmi?

Përmes shumë shembujve, profesor Rifat Gjota, i demonstroi opinionit publik se si realizohet sferizmi. Duke u nisur nga ajo se dukuritë natyrore janë ciklike, ai e ka parë edhe pakufishmërinë dhe imagjinaren si të rrumbullakët. "Nëse udhëtojmë në univers dhe e vështrojmë botën nga larg, shohim vetëm njërën pjesë të botës si një lloj objekti të rrumbullakët. Kurse unë kam dalë nga ajo pjesë që ju nuk e shihni botën. Pra, atë pjesë që ju nuk e shihni, unë e shoh dhe e kundërta" – theksoi profesor Gjota. Shtrohet pyetja, a ka mundësi që këto



dy këndvështrime t'i harmonizojmë? Në qoftë se bëhet kjo, atëherë ne kemi arritur që të realizojmë sferizmin.

Nëse funksionet matematikore, të cilat konsiderohen "të pakufishme" i zbatojmë në sferizëm dhe i parafytyrojmë në pjesën tjetër që opinioni nuk e sheh, kurse profesor Gjota nga ana e kundërt e sferës e sheh, atëherë ky funksion kufizohet dhe nëse për ne është imagjinar, për zbuluesin Rifat Gjota, është real dhe shihet.

Tani, përmes teknologjisë informative, përmes programeve kompjuterike moderne, zbulimi i profesorit është edhe më i qartë, pasi që më herët ky zbulim paraqitej vetëm në rrafshin dy dimensional 2D, kurse tani në saje të ndihmës së këtyre programeve, zbulimet qartësohen kur paraqiten në hapësirën tri dimensonale 3D dhe paraqitjes dinamike të vijës se nga shkon një funksion i caktuar përreth sferës.


"Ky zbulim është një qasje e re, është një begatim i shkencës, është një formim i një koncepti të ri për aspektet dhe dukuritë shkencore", - është shprehur prof. dr. Rifat Gjota.

Për çdo pyetje, vërejtje, sugjerim për këtë zbulim, mund të kontaktoni në e-mailin: sferizmi@appdec.com. ■

Rifat Gjota


Prof. dr. Rifat Gjota është lindur në Pejë, më 5 maj 1939, në një familje të njohur zejtare. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në vendlindje. Në vitin 1965 ka diplomuar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Shkupit, në vitin 1977 ka magjistruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, kurse në vitin 1985 ka doktoruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës. Deri në moshën 65 vjeçare ka punuar si profesor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Prishtinë.
Mbi njëzet vjet punoi në zbulimin e elektromotorit me veti shumë më të përparuara se ai i gjertanishëm, i cili kursen energjinë elektrike në përqindje të konsiderueshme.
Aktualisht jeton me familjen e tij në Pejë, me një pension që nuk i kalon as 70 euro, si "falënderim" për të gjithë atë që ka bërë ai për shkencën, për ardhmërinë e kombit tonë, si dhe për të mirën e gjithë njerëzimit.





Shumë shkolla e pak nxënës

Mareci gjendet tridhjetë kilometra larg nga qyteti i Prishtinës, por është në këtë komunë. Atje ndodhen dhjetë shkolla fillore, jo pse ka shumë nxënës, por për shkak të territorit shumë të madh dhe pamundësisë për të arritur të gjithë nxënësit në një shkollë. Ky fshat përfshin territorin më të madh në Kosovë. Nga banorët e vendit, ky fshat njihet si e njëqindta pjesë e Kosovës ngase llogaritet që ka afër njëqind kilometra katrorë



Drita VITIA

PRISHTINË, PRILL 2010

Fshati Marec gjendet rreth tridhjetë kilometra larg nga qyteti i Prishtinës dhe është fshat i kësaj komune. Në këtë fshat ka shkolla fillore më shumë se në çdo fshat tjetër në këtë komunë, madje më shumë edhe se në vetë lagjet e kryeqytetit. Në këtë fshat gjenden gjithsej dhjetë shkolla fillore, por me një numër mjaft të vogël nxënësish. Arta dhe Lendrit Gashi, të cilët vijojnë klasën e parë dhe të tretë të shkollës fillore "Liria", në Lagjen Qukë e Pajtimit në Marec, shokun e vetëm të shkollës e kanë mësuesin e tyre Fadil Pacollin. Motër e vëlla, janë dy nxënësit e vetëm të kësaj shkolle, pasi që të gjitha familjet e tjera në këtë pjesë, e kanë lëshuar



vendin. Shkolla "Liria" është paralele e ndarë në Qukë të Pajtimit, lagje e cila e ka marrë emrin për shkak të pajtimit të gjaqeve mes dy familjeve. Arta dhe Lendriti, edhe pse janë në klasa të ndryshme, mësojnë në një orar, sepse janë të vetmit nxënës në këtë shkollë. Ata udhëtojnë me një automjet xhip nga Lagja Zllash për në shkollë, për shkak të kodrinave të larta dhe rrugëve shumë të vështira për lëvizjen e banorëve. Ndërsa, kur ka borë dhe kohë më të vështirë, kryesisht gjatë stinës së dimrit, që në këtë fshat zgjat disa muaj më shumë se në pjesët e tjera të Kosovës për shkak të lartësisë mbidetare që ka, ata nuk shkojnë në shkollë, sepse në këtë pjesë nuk mund të lëvizë asnjë makinë. Lartësia më e madhe mbidetare e Marecit është njëmijë e dyqind metra.

Arta dhe Lendriti e kanë mjaft të vështirë shkollimin, megjithëse as shkollat e tjera në këtë fshat nuk kanë dallim të madh sa i përket numrit të nxënësve dhe kushteve për mësim. Shkolla "Fan Noli", e cila ka rreth shtatëdhjetë nxënës, mban mësim të kombinuar për katër klasa, pasi që në këtë shkollë nuk ka numër të mjaftuar për secilën klasë. Drejtori i kësaj shkolle, Zymer Haxholli, tregon vështirësitë me të cilat përballen në shkollë. "Shkolla është shumë e ftohtë. Këtu ngrohemi me ngrohje klasike, prandaj është pak e vështirë të ngrohet e gjithë hapësira", -thekson Haxholli. Sipas tij, problemi më i madh i nxënësve gjatë shkollimit është rruga deri në shkollë, ndërsa pas mbarimit të nëntëvjeçares, shqetësimi më i madh i gjithë banorëve të Marecit është vazhdimi i shkollimit për fëmijët, të cilët duhet të transferohen në qytetin e Prishtinës, ose qytetet më të afërta përreth, gjë e cila për këta qytetarë është shumë e vështirë. "Problemin më të madh e kemi me fëmijët të cilët e mbarojnë shkollimin fillor, sepse pas këtij fëmijët duhet t'i dërgojmë për shkollim në Prishtinë ose në ndonjë qytet tjetër, për shkak se këtu nuk ka nivele më të larta të shkollimit", - theksoi drejtori Haxholli, i cili përballet me hallet e njëjta si të banorëve të tjerë në këtë fshat.

Shumë shkolla, pak nxënës

Shkolla "Fan Noli", në Lagjen e Vitisë së Marecit, ishte vetëm një nga shkollat nxënësit e së cilës përballen me shumë probleme, ngase në këtë fshat të gjithë banorët i kanë hallet pothuajse të njëjta. Në një vend më të thellë të po këtij fshati, gjendet lagjja Bullaj. Në këtë lagje gjendet edhe shkolla fillore "Ramiz Sadiku". Në këtë shkollë ka një numër shumë të vogël nxënësish, për çka ata që vijojnë mësimin janë të detyruar ta vijojnë atë në klasë të kombinuara. Ramë Haxholli, drejtor i kësaj shkolle, rrëfen për transformimin e shkollës prej kohës kur kishte qindra nxënës e deri më tani kur numëron vetëm disa dhjetëra sosh. Por, edhe ata pak nxënës që mësojnë në këtë shkollë, me njëmbëdhjetë arsimtarë gjithsej, udhëtojnë nga lagje të ndryshme të fshatit, duke bërë kështu deri në nëntë kilometra në ditë për të arritur në shkollë. Këtu nxënësit mësojnë në dy ndërrime, në mënyrë të kombinuar, duke mësuar kështu nga dy-tre klasë në një dhomë, ngase numri i nxënësve në asnjë paralele nuk e kalon katërshin. Kjo shkollë ka edhe një aneks disa kilometra larg, në të cilën mësojnë vetëm shtatë nxënës. Ndërsa, në gjithë fshatin tani gjenden tri shkollat me nëntë klasë, ajo "Fan Noli", "Ramiz Sadiku" dhe "Liria", në paralelet e të cilave mësojnë gjashtë dhe shtatë nxënës.

9 kilometra rrugë për në shkollë

Edhe pse në këtë fshat gjenden një numër i madh shkollash, dikur ato shfrytëzoheshin të gjitha. Ndërsa tani, shumësia e shkollave ka filluar të jetë e panevojshme. Në lagjet e ashtuquajtura Vakofc, Vrajollt dhe Canaj, kanë pushuar së funksionuari katër shkolla fillore, për shkak të mungesës së nxënësve në këto lagje. Ndërsa, në lagjen Bullaj një objekt shkollor është djegë gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe nuk është ndërtuar më kurrë. Nxënësit e kësaj lagjeje detyrohen të mësojnë në shkollat e fshatrave afër ose në Prishtinë. Nga mijëra nxënës sa ishin dikur, tani arsimtarët në shkollat e Marecit janë të detyruar të mbajnë mësimin e kombinuar, duke mësuar kështu nga dy klasë bashkë. Mirëpo, edhe pse në Fshatin Marec ka një numër rekord të shkollave fillore, të cilat sipas banorëve janë ndërtuar për të shmangur udhëtimin e gjatë, disa nxënës të Marecit prapë janë të detyruar të bëjnë deri në nëntë kilometra në ditë për të shkuar në shkollë. Megjithatë, i gjithë numri i nxënësve në klasë nuk e kalon katërshin.

Mareci me 10 shkolla fillore

Mareci përfshin rreth njëqind kilometra katrorë territor, ose siç njihet ndryshe nga banorët, e njëqindta pjesë e Kosovës. I banuar dikur nga shtatëqind shtëpi dhe afër shtatë mijë banorë, tani ka mbetur gati i boshatisur. Mareci, fshati me hapësirën territoriale më të madhe në Kosovë, dikur ka numëruar katër shkolla tetë klasëshe, atë "Liria" në Lagjen Fllatacion, "Fan Noli" në Viti, "Ramiz Sadiku" në Bullaj me paralele të

ndara, po ashtu tetë vjeçare në Lagjen Canaj, si dhe gjashtë paralele të ndara, në Pacaj, Nizhnokoll, Mudri Potok, Vakofc, Qukë e Pajtimit dhe Canaj. As në atë kohë shkollat nuk janë ndërtuar për shkak të numrit të madh të nxënësve, por për shkak të hapësirës së madhe territoriale dhe pamundësisë për të udhëtuar nga një vend në tjetrin për të ndjekur mësimin, e sidomos për fëmijët në klasat e ulëta, gjë që u ka pamundësuar banorëve të fshatit shkollimin në një objekt të vetëm arsimor. Tani Mareci është afër boshatisjes totale. Sipas banorëve të fshatit, shpërngulja e banorëve ka filluar rreth viteve të nëntëdhjeta për shkak të gjendjes së rëndë sociale e ekonomike, mungesës së infrastrukturës dhe mungesës së kushteve elementare për jetë. Mirëpo, ata theksojë se kulmi i migrimeve në këtë vend ka arritur pas luftës së fundit në Kosovë, e cila la shumë familje pa kulm mbi kokë, e cila ishte edhe arsyeja më e madhe e largimit të tyre për të mos u kthyer më kurrë.



Para 6 dekadave shkolla e parë e fshatit

Shkolla e parë fillore në Fshatin Marec është hapur në Lagjen Viti, e adaptuar për mësim në shtëpinë e Qazim Vitisë, më 1946. Shkolla e hapur për herë të parë në këtë lagje, pas pak vjetësh së funksionuari, ishte transferuar në një Han në po këtë lagje, për të vazhduar më vonë në Shtëpinë e Kulturës. Ndërsa më 1979 mësimi ka filluar për herë të parë në objektin e shkollës së parë në Marec, “Fan Noli”, në Viti. Ndër mësuesit e parë në shtëpinë e Qazim Vitisë kanë qenë Bajram Llapashtica dhe Nuhi Krasniqi. Kurse shkolla e dytë fillore është ndërtuar në Lagjen Mudri Potok në Marec, e treta në Lagjen Vakofc dhe e katërta në Bullaj. Ejup Haxholli është nxënës i gjeneratës së parë në shkollën fillore në Bullaj, i cili ka filluar mësimin më 1948. Në klasën ku mësonte Ejupi, ishin tridhjetë e pesë nxënës gjithsej. Ata ishin të moshave të ndryshme, duke filluar nga fëmijët shtatëtetë vjeçar e deri te moshat më të shtyra, të cilët shkonin për të mësuar shkrim-lexim. Haxholli, tashmë i shtyrë në moshë, kujton me mall vitet e shkollimit të tij në këtë fshat, për të vazhduar pastaj me shkollimin e lartë në Prishtinë, ndërsa, gjatë viteve 1961 deri më 1986, Haxholli kthehet përsëri në shkollën e fshatit, mirëpo tani në cilësinë e mësimdhënësit dhe më vonë të drejtorit në disa nga shkollat e Marecit. Ai kujton kohën kur në shkollat “Fan Noli” dhe “Ramiz Sadiku” e kanë vijuar mësimin dyqind e pesëdhjetë e gjashtë deri në njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë nxënës.

100 km katrorë dhe 20 km vijë ajrore

Tetë lagje të Marecit kanë tri ambulanca shëndetësore, të cilat sipas banorëve janë të pamjaftueshme. Atje nuk shkon as shtypi ditor, ndërsa për të blerë gjëra ushqimore, nga lagjja më e afërt për në ndonjë qytet tjetër jashtë Marecit, banorët duhet të udhëtojnë rreth gjysmë ore për të arritur. Nga pika e parë ku fillon territori i Marecit, rreth tridhjetë kilometra larg nga Prishtina, pika e fundit më e largët e fshatit është rreth pesëdhjetë kilometra. Mareci, përveç të tjerash, është një fshat i cili njihet kryesisht për mikpritjen tradicionale. Në fshat flitet të ketë pasur disa lloje shtëpish të njohura si hane, të cilat banorët e vendit i kanë ndërtuar për të pritur mysafirë. Funksioni i tyre, sipas banorëve të Marecit, ka qenë ai i hoteleve të sotme, veçse pa pagesë. Sipas tyre, dyert e këtyre dhomave kanë qëndruar hapur ndërsa banorët, të cilët kanë udhëtuar gjatë, i kanë shfrytëzuar për strehim gjatë natës. Mareci ka pak tokë pjellore dhe të punueshme dhe kryesisht është i pasur me pyje, kullosa, pasuri nëntokësore si: ar, plumb dhe zink. Furnizimin me rrymë ky fshat e siguron nga katër burime të energjisë elektrike, një nga Fshati Mramor dhe Graçanica, një nga Novobërda, një nga Koliqi dhe një nga Krileva. Vija ajrore e Marecit është njëzet kilometra. Në luftën e fundit në Kosovë, në këtë fshat janë djegur shtatë lagje, gjë që ka shkaktuar edhe braktisjen e fshatit gati në tërësi nga banorët. Mariani njihet të jetë njeriu i parë i Marecit, prej të cilit e ka marrë edhe emrin fshati. Familja e tij njihet si familja e parë në këtë fshat, e cila është shpërndarë më pas në gjithë Marecin rreth shek. të XVI-të. ■



Komisioni qendror shtetëror i maturës (KQMSH) prezanton planin për testin e maturës

Katër teste për gjashtë lëndë

Për ndryshim nga viti i kaluar, kur kishim vetëm dy lloj testesh për gjimnazin, tani do të kemi katër lloje, që do të thotë që të tre gjimnazet që kanë të bëjnë me shkenca dhe gjimnazi i përgjithshëm janë të ndarë në teste në vete, ndërsa gjimnazi gjuhësor dhe ai shoqëror do të kenë një test të përbashkët", - tha kryetari i komisionit qendror shtetëror të maturës, Nehat Mustafa.

Përparim BUBLAKU

Testi i maturës këtë vit, për dallim nga testet e kaluara, do ketë disa ndryshime. Në të do të përfshihen katër lloje testesh në gashtë lëndë dhe disa dyshime të tjera. Testi i maturës këtë vit do të mbahet më 5 qershor dhe do te jetë pa pagesë. Ndërkaq, kalueshmëria e këtij testi do të jetë 50% e përgjigjeve. Kryetari i komisionit qendror shtetëror të maturës (KQMSH), Nehat Mustafa bëri të ditur se para se të vihet te përcaktimi i lëndëve janë organizuar debate të shumta, me qëllim që të merret mendimi i secilit që është i përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces. "Për ndryshim nga viti i kaluar kur kishim vetëm dy lloj testesh për gjimnazin, tani do të kemi katër lloje, që do të thotë që të tre gjimnazet që kanë të bëjnë me shkenca dhe gjimnazi i përgjithshëm janë të ndarë në teste në vete, ndërsa gjimnazi gjuhësor dhe ai shoqëror do të kenë një test të përbashkët", - është shprehur kryetari i komisionit qendror shtetëror të maturës, Nehat Mustafa. Ai, gjithashtu, bëri të ditur se, për dallim nga testet e kaluara, në pjesën e pyetjeve me zgjedhje ose lëndë të përafërta me drejtimin, ka pasur 4-5 lëndë, ndërsa këtë vit, kjo pjesë përbëhet nga tri lëndë. "Tri janë nga pjesa obligative e përgjithshme dhe tri të tjera nga pjesa e lëndëve me zgjedhje", - deklaroi Mustafa. Kryetari i KQMSH-ës bëri të ditur se janë bërë të gjitha përgatitjet e tjera materiale e teknike dhe se deri në kohën e testit, maturantët do të kenë mundësi më të mëdha të informohen. "Kemi përgatitur broshurat në të tri gjuhët (shqipe, boshnjake, turke), të cilat do të shpërndahen për çdo nxënës dhe fletushkat që do të shpërndahen nëpër shkolla. Do të kemi edhe një spot reklamues, përmes të cilit maturantët do të kenë mundësi edhe më të mëdha që të informohen", - bëri të ditur Mustafa. Testi i maturës do të organizohet në katër gjuhë: shqipe, angleze, turke dhe boshnjake. Testi në gjuhën angleze do të organizohet për shkak të kërkesës së shkollës "Prishtina High School". Ne kemi marr një kërkesë nga shkolla "Prishtina High School" që testi i maturës të jetë në gjuhën angleze për nxënësit që dalin nga kjo shkollë dhe ne i jemi përgjigjur pozitivisht kësaj kërkese", - tha Mustafa. Paraqitja e provimit të maturës do të fillojë që nga tre maji, ndërkohë që më 19 dhe 20 maj do të jenë riprovimet për ata nxënës, të cilët nuk kanë treguar ndonjë sukses pozitiv në ndonjë lëndë të caktuar. Testi i maturës këtë vit do të jetë falas. Publikimi i rezultateve do të bëhet pas 10 ditësh. Nga 15-18 qershor, maturantët do të kenë mundësi që të ankohen. Më 22 qershor përfundon edhe publikimi i rezultateve, të cilat dalin nga ankesat, që do të thotë se afati i qershorit, zyrtarisht, përfundon në këtë datë. Ndërsa, për të gjithë ata maturantë që nuk do të mund të tregojnë sukses pozitiv në afatin e qershorit, provimi do të organizohet edhe në gusht. Më 10-20 gusht do të bëhet paraqitja e provimeve, ndërsa më 27 gusht do të mbahet provimi. Publikimi i rezultateve për këtë afat do të jetë më 7 shtator, kurse nga 8-10 shtator bëhet shqyrtimi i ankesave eventuale, ndërsa më 13 shtator edhe publikimi i rezultateve të ankesave. Testi i maturës për shkollat e mesme në Kosovë organizohet që nga viti 2006 dhe, deri më tani, suksesi nga ky test nuk ka qenë i kënaqshëm, gjë që ka nxitur reagime të mëdha në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Maturantet në "ethe"

Ndërsa maturantët, të cilët do t'i nënshtrohen testit të maturës, tashmë janë nën ethet e këtij testi për faktin se ata këtë test e shohin si shumë të rëndësishëm për hapat e tyre të mëtejshëm. Granit Hajrizi, njëri nga maturantët e shumtë që do t'i nënshtrohet këtij testi, shprehet i shqetësuar për fatin e tij në këtë test. "Jam i shqetësuar për atë se çka do të bëj në test, edhe pse që një kohë të gjatë janë duke u përgatitur për test", u shpreh ky maturant duke theksuar se "testi i maturës është një sprovë, e cila do të ndikojë shumë edhe në fatin e vazhdimit të studimeve universitare". Për Leonora Krasniqin, një tjetër maturante, për të arritur sukses duhet të prijë edhe fati që ta kalosh testin e maturës. "Për mua është shumë i rëndësishëm edhe fati, pasi jo rrallë herë gjatë këtyre viteve ka nxënës të cilët kanë pas sukses të mirë gjatë shkollimit të tyre". Për këtë maturante, ndryshimet që janë bërë këtë vit në testin e maturës janë pozitive. "Këto ndryshime i vlerësoj si shumë të mira pasi mendoj se do të kemi më shumë mundësi dhe do të kemi lëndë nga drejtimi që kemi pasur gjatë shkollimit të mesëm", - ka përfunduar Krasniqi. ■



Intervistë me kryeprokurorin e Republikës së Kosovës, Ismet Kabashi

Prokurorët kanë guxim të luftojnë ko

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Është njeriu më kompetent i Prokurorisë së Kosovës, i cili tregon se bart përgjegjësi të veçantë mbi supe. Ai vlerëson se edhe përkundër sfidave dhe kushteve jo të mira të punës, prokurorët e Kosovës kanë guxim për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Sipas tij puna e prokurorisë së Kosovës nuk duhet të kritikohet për mosefikasitet, sepse vetëm gjatë vitit 2009, ky institucion ka përfunduar 76.4 për qind të lëndëve.

Ai mendon se të gjithë qytetarët e Kosovë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, sepse kjo, sipas tij, është kategori kushtetuese që duhet të zbatohet. Për më shumë flet për revistën "Paqja", kryeprokurori i Republikës së Kosovës, Ismet Kabashi.

PAQJA: ***Z. Kabashi, para një kohe keni marrë detyrën e re si Kryeprokuror i Republikës së Kosovës. Si po ndiheni në këtë post?***

KABASHI: Posti i kryeprokurorit të shtetit është post me përgjegjësi të veçantë. Sistemi prokurorial është i ndërtuar në bazë të principit të subordinacionit dhe secili prokuror më i lartë ka të drejtë t'i japë udhëzime të detyrueshme prokurorëve, andaj bart përgjegjësi edhe për punën e tyre dhe këtu qëndron përgjegjësia e veçantë. Për të gjitha këto isha i vetëdijshëm kur konkurrova për t'u emëruar në këtë post.

PAQJA: ***Z. Kabashi në çfarë gjendje e keni gjetur Prokurorinë e Republikës së Kosovës?***

KABASHI: Prokuroritë e Republikës së Kosovës kanë të njëjtën strukturë që kishin para vitit 1990, por kanë një numër më të vogël prokurorësh se atëherë. Prokuroritë kanë mungesë të numrit të prokurorëve, të stafit ndihmës dhe nuk kanë kushte pune, duke përfshirë lokalet në të cilat janë të vendosura, pozitën materiale, sigurinë dhe shumë çështje të tjera.

Gjatë procedurës së riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, fatmirësisht, është kompletuar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Janë emëruar kryeprokurori dhe tre prokurorë në Prokurorinë e Shtetit. Për vendet e paplotësuara në këtë prokurori është përsëritur konkursi, ndërsa së shpejti do të emërohen prokurorët në pesë Prokuroritë e Qarkut.

Në prokurorinë e Kosovës është gati të aprovohet edhe infrastruktura ligjore. Sa i përket Ligjit për Gjykatat e Rregulltа mund të them se ai është në Parlamentin e Republikës së Kosovës, ndërsa Ligji mbi Këshillin Gjyqësor, mbi Këshillin, Prokurorinë dhe ai mbi Prokurorinë e Shtetit janë dorëzuar në Qeveri.

PAQJA: ***Z. Kabashi, në raportet e ndryshme është kritikuar edhe Prokuroria e Kosovës për mosefikasitetin e punës. Cilat janë problemet dhe sfidat që ju mendoni se e kanë kapluar këtë institucion?***

KABASHI: Unë them se prokuroritë kanë kryer një punë shumë të madhe dhe të mirë. Gjate vitit 2009 ato kanë krye 76.4 për qind të lëndëve të arritura gjatë vitit. Në bazë të akteve akuzuese të prokurorive, gjykatat kanë marrë vetëm 2.6 për qind aktgjykime liruese, ndërsa 88.2 për qind aktgjykime gjykuese.

Ndërsa 9.2 për qind, që kanë të bëjnë me aktgjykimet me të cilat është refuzuar akuza, mund të jenë pasojë e heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja penale ose parashkrimit të ndjekjes penale në procedurë pranë gjykatave. Këto shifra nuk tregojnë mosefikasitet në punë. Dua të ju them se secili prokuror i prokurorive komunale, gjatë këtij viti, ka pranuar mesatarisht nga 467 lëndë në punë dhe ka zgjidhur nga 437 lëndë. Norma vjetore e lëndëve për ta është 250 lëndë. Sa u përket prokuroreve të qarkut, secili prej tyre kanë zgjidhur mesatarisht nga 103 lëndë, ndërsa norma e tyre vjetore është 60 lëndë në vit. Prokurorët, përveç ngritjes së aktit akuzues, kanë edhe hetimin, përfaqësimin në gjykata, konsultimet me policinë dhe kryerjen e shikimeve në vendin e ngjarjes, që po ashtu mar- rin shumë kohë.



orrupsionin dhe krimin e organizuar



Në prokuroritë në të cilat ka pasur organizim më të mirë të punës janë arritur edhe rezultate më të mira. Në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, çdo prokuror ka zgjidhur 138 kallëzime penale, 35 kallëzime mbi mesataren e zgjidhjes së lëndëve për një prokuror. Mirëpo ka edhe të meta në kuptimin e dhënies së prioritetit lëndëve më të ndjeshme, sidomos atyre të korrupsionit. Prokuroritë, në të ardhmen, do t'i eliminojnë këto të meta.

PAQJA: ***Z. Kabashi, sa kanë bashkëpunim prokurorët e Kosovës me prokurorët ndërkombëtarë të EULEX-it, kryesisht në hetime?***

KABASHI: Bashkëpunimi me prokurorët e EULEX-it është i mirë. Ne kemi kontakte të rregullta me qëllimin e koordinimit të punëve dhe bashkëpunimit. Ata kryesisht janë të përqendruar në monitorim dhe këshillëdhënie, mirëpo punojnë edhe lëndë konkrete, sidomos prokurorët e emëruar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës që kanë kompetenca të veçanta dhe plotësuese në bazë të Ligjit mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

PAQJA: ***Z. Kabashi, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për krijimin e një departamenti të veçantë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, ose "Task Forca", në të cilën do të përfshihen 6 prokurorë dhe 30 hetues. Z. Kabashi, a do kenë guxim që prokurorët vendorë të merren me luftimin e këtyre dukurive?***

KABASHI: Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës themelimin e një forme të tillë organizative me qëllim të realizimit të prioriteteve të saj në ndjekjen e kryesve të veprave penale të korrupsionit. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka caktuar prokurorët vendorë dhe të EULEX-it që do të merren me këto lëndë.

Prokurorët e dinë ligjin dhe kompetencat e secilës prokurori. Sikur të mos kishin guxim, ata nuk do të paraqiteshin për këto poste. Ka shumë e shumë profesione që paguhen më mirë se prokurorët dhe, megjithatë, ata kanë zgjedhur lirshëm këtë profesion.

PAQJA: ***Z. Kabashi, muaj më parë është deklaruar se Prokuroria e Kosovës së bashku me EULEX-in janë duke hetuar disa "peshq të mëdhenj" siç shprehen ata. A mund të na thoni a është duke u hetuar ndonjë personalitet i rëndësishëm për korrupsion?***

KABASHI: Nuk dua të spekuloj. Kam lexuar në shtyp dhe në media se ajo është thënë, por edhe kam lexuar demante se është thënë një gjë e tillë.

Gjyqësori, duke përfshirë edhe prokurorinë, duhet t'i trajtojë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në mënyrë të barabartë para ligjit dhe kjo është kategori kushtetuese, të cilën ne do ta respektojmë dhe do ta zbatojmë.

PAQJA: ***Z. Kabashi cila është strategjia e juaj e punës që Sistemi i Drejtësisë në Kosovë të mos vlerësohet i korruptuar?***

KABASHI: Transparenca, sigurimi i qasjes së lehtë të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, kontrolli i brendshëm dhe vlerësimi i punës së secilit prokuror.

PAQJA: ***Z. Kabashi, për fund, cili është mesazhi juaj për prokurorët vendorë dhe për sistemin e drejtësisë së Kosovës?***

KABASHI: Të respektohet ligji, të respektohen afatet kohore për zgjidhjen e lëndëve, të vlerësohen dhe caktohen prioritetet reale që mund të arrihen me këtë numër të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të njoftohet publiku për punën e sistemit të drejtësisë në Kosovë. ■



Edukata fetare – element kon



Ferdi KAMBERI

Debati mediatik mbi futjen e lëndës fetare nëpër shkolla shqipe nuk ka të ndalur. Individë, me backgrounde të ndryshme, mendojnë dhe mbrojnë me fanatizëm se një gjë e tillë është në kundërshtim me etikën kushtetuese të vetë shtetit tonë. Lënda e edukatës fetare nëpër shkollat kosovare, pa dyshim, se do të ishte një element pragmatik, por, në anën tjetër, do të ishte një element konstruktiv drejt ndalimit të disa elementeve devijante, të cilat e kanë kapluar kohët e fundit shoqërinë kosovare, e veçmas të rinjtë shqiptarë. Është fakt që bota tani, gjithnjë e më shumë, është duke u globalizuar. Shkenca, teknologjia dhe informatika kanë arritur një hierarki piramidale, e cila de facto tregon se njeriu modern ka përparuar dukshëm. Krahas këtij hiper-zhvillimi me proceset e sekularizmit, shekullarizmit, postmodernizmit, etj., edhe religjioni si një proces i ndjeshëm i shoqërisë është laicizuar dukshëm. Në këtë kontekst, vendi i celulës së përhapjes së laicizmit, Franca, por edhe shtetet e tjera, janë duke kontribuar gjithnjë e më shumë në përmbushjen e objektivave drejt raporteve me organizatat fetare si institucione legjitime për organizimin e jetës dhe shërbesave fetare. Shteti si shtet është i obliguar që të paktën organizatat fetare t'i ndihmojë financiarisht, duke kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e vetë kushteve të qytetarëve të atij shteti. Te ne, për habi, shohim të kundërtën. Madje shpesh flitet për raporte të tolerancës dhe për një bashkëpunim mes vetë institucioneve shtetërore dhe organizatave fetare zyrtare. Por kur jemi te gjërat madhore, siç janë: financimi i këtyre organizatave dhe tashmë edhe futja e lëndës fetare nëpër shkollat kosovare, gjërat marrin një kthesë tjetër. Atëherë, shtrohet pyetja: Kujt po i pengon lënda e edukatës fetare? Kush fshihet pas kësaj heshtje, e cila si duket i dërgon në afekt disa nga individët që mbrojnë me fanatizëm egocentrizmin e tyre, se kjo ide nuk bën të aprovohet? Njeriu pa komb dhe pa religjion është i verbër, madje këto dy elemente janë pjesë e identitetit të vetë njeriut. Andaj, duke mos dashur të bëjmë një përkufizim shkollor lidhur me kombin, kombi është bashkësi popullore – njerëzore që paraqitet me lindjen e shoqërisë qytetare si rezultat i ndryshimit historik të formave të bashkimit të njerëzve me qëllim të zhvillimit dhe mbijetesës së tyre që e karakterizon: territori i përbashkët, jeta e përbashkët ekonomike, kultura specifike, religjioni i caktuar, por edhe gjuha që, sipas Karl Dojç-it, përbën elementin më thelbësor të kombit. Mirëpo, edhe religjioni sikurse kombi është proces i ndjeshëm, ai (religjioni) është një lidhje emocionale, shpirtërore, motivuese, psikologjike, metafizike me një fuqi mbinatyrore. Prandaj, nga ky prizëm, shohim se këto dy elemente janë procese të ndjeshme dhe, si të tilla, meritojnë një analizë të thellë të një qasjeje holistike.

Pse të futet edukata fetare nëpër shkolla?

Ekskluziviteti i tërë kësaj mund të jetë një projeksion drejt asaj që futja e lëndës fetare në shkollat kosovare do të ishte një pragmatizëm, por edhe në vetë interes të qytetarëve. Sot, jemi dëshmitarë të asaj që në shkollat tona shohim probleme të shumta, që tanimë janë bërë edhe rutinë. Vlen të hedhim një vështrim në terren dhe do të habitemi nga rrahjet e shumta mes të rinjve, nga përdorimi pa masë i alkoolit, nga përdorimi i drogës, mosmbajtja e mësimit si dhe shumë probleme të tjera që, pa dyshim, nuk do të mjaftonin t'i renditnim me një refleksion të tillë me pak rreshta. Së këndejmi, duhet pohuar se futja e lëndës fetare nëpër shkolla jo vetëm që do të mundësonte një shmangie të të rinjve nga dukuritë negative, por secili nxënës do të mësonte të paktën një element inkluziv mbi religjionin e tij. Edukata fetare përbën një element konstruktiv, jo vetëm pse neve na pëlqen të theksojmë, por është realiteti i cili e dëshmon këtë. Hulumtimet e shumta tregojnë që futja e një lënde të tillë, pa dyshim, se do të ishte një hap i rëndësishëm, por edhe një hap drejt raporteve ndërfetare. Shtetet e ndryshme, që nga Franca që është djep i laicizmit e deri te SHBA, të gjitha pothuajse e kanë të rregulluar një gjë të tillë me ligj. Prandaj, nëse një shtet është laik ashtu siç është Kosova, nuk do të thotë që të mungojë mësimi fetar nëpër shkolla, sepse të gjitha shtetet laike e kanë një gjë të tillë në parim, por edhe e praktikojnë. Madje, një gjë e tillë është edhe në luginën e Preshevës, gjë që dëshmon qartë se mësimi fetar është një nga karakteristikat e vetë të drejtave dhe lirive të njeriut. Në Kosovë, edhe pse shumica është me identitet islam (mbi 90%), askush nuk i përfill fjalët e tyre lidhur me futjen e lëndës fetare në shkolla, gjë që tregon se shumica diskriminohet në shumë raste. Madje, fanatikët që mbrojnë me këmbëngulje idetë e ateizmit, theksojnë se pikërisht ISLAMI na ka lënë mbrapa. Por realiteti tregon të kundërtën, pra se ata vetë e kanë lënë vetveten mbrapa. Vetëm nëse ia hedhim një vështrim his-



...struktiv apo dekonstruktiv?

torisë, shohim se kur jemi të religjioni islam, Islami në trojet shqiptare nuk ka ardhur më dhunë, ashtu siç pretendojnë disa historianë, por konvertimi i shqiptarëve ka ndodhur në mënyrë vullnetare, të paktën këtë e dëshmon historia. Andaj, individë të ndryshëm, islamofobë etj, tentojnë që të nxjerrin justifikime të ndryshme, duke etiketuar shumicën muslimane në Kosovë, vetëm e vetëm që ta njollosin. Madje teoria e etiketimit thotë se: Njerëzit ndryshojnë kur e dinë se si të tjerët do të reagojnë me sjelljen e tyre, gjë që tregon qartë se, në disa momente, njerëzit janë të prirë të ndryshojnë në mënyra të ndryshme, por edhe për përfitime të tyre personale. Egocentrizmi dhe narcizmi tejet i lartë i shumë individëve tregon kompleksin e inferioritetit në raport me të tjerët, e sidomos me shumicën muslimane. Këtu duhet theksuar se edukata fetare nuk ka të bëjë aspak vetëm me njërin religjion, por, në esencë, me të gjitha konfesionet fetare, të cilat ekzistojnë në Kosovë.



Nëse jemi shtet laik, kjo nuk do të thotë se nuk kemi të drejtë të fusim edukatën fetare nëpër shkolla

Euforizmi i tepruar, narcizmi, por edhe egoizmi relativ, kanë bërë të mundur që disa gjëra në terren edhe të hiperzmadhohen, madje të marrin konotacion negativ në raport me religjionin. Procesi i laicizmit si duket po keqkuptohet dhe po keqinterpretohet në versione të ndryshme. Sipas sociologut bashkëkohor Anthony Giddens, "laicizmi paraqet procesin nëpërmjet të cilit feja e humb ndikimin e saj në sfera të ndryshme të jetës sociale". Pra, laicizmi ka të bëjë me shkëputjen e fesë nga shteti (teokracia) dhe shtetit nga feja (totalitarizmi). Andaj, në këtë drejtim, laicizmi nuk do të thotë që populli nuk ka drejtë të fusë në shkolla lëndën që ka të bëjë me konfesionin e tyre fetar, por laicizmi është procesi ku ka pluralizëm dhe pikërisht erdhi pas revolucionit francez 1789, sepse u pa që ishte e nevojshme një pluralizëm dhe një demokratizim, i cili do të mundësonte popullit një mozaik dhe një shumëllojshmëri kulturash, religjionesh, grupesh etnike, etj. Megjithatë, duhet theksuar se shteti laik iu jep përkrahje institucioneve fetare, i financon ato por nuk i kontrollon, sepse ato janë në shërbim të komuniteteve fetare, të cilat jetojnë në po atë shtet. Kosova tashmë është pavarësuar dhe është duke ecur me hapa të sigurt drejt mekanizmave euroatlantikë, ka një kushtetutë moderne, andaj edhe në kushtetutë, në nenin 8, thuhet: "Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare". Pra, edhe nga ky "nen'" tregohet qartë se Kosova është shtet laik dhe se ajo nuk përzihet në çështjet e besimit, deri në atë moment që një organizatë e caktuar fetare bie ndesh me normat, vlerat, dhe ligjet e vetë shtetit kosovar. Mirëpo, në shumicën e vendeve demokratike, si Zvicra, Italia, SHBA-atë etj, ekziston e ashtuquajtura "Iniciativa qytetare", ku qytetarët japin mendimin e tyre lidhur me proceset aktuale, preokupimet dhe mendimet e ndryshme, sepse, në fund të fundit, ato institucione ekzistojnë me votën e qytetarëve. Në këtë drejtim, duhet pohuar se edhe pse te ne nuk ekziston një gjë e tillë, sipas deklaratës së drejtave dhe lirive universale, është e drejtë e njerëzve që i takojnë një konfesioni të caktuar fetar të kërkojnë të drejtat e tyre, e në këtë rast të kërkojnë futjen e edukatës fetare nëpër shkolla. Prandaj, procesi i laicizmit nuk e ndalon një gjë të tillë, madje shumica e vetë shteteve laike e kanë rregulluar këtë element që herët. Kështu që, nga prizmi sociologjik, mund të themi se lënda fetare jo vetëm që integron shoqërinë në një element pragmatizmi, por krijon edhe një kohezion social, madje edhe vetë edukata fetare është pjesë e identitetit dhe, normalisht, luan një funksion në shoqëri, ose të paktën krijon një vetëdijesim te secili nxënës për konfesionin e tij fetar, pavarësisht se cilit besim i përket.

Si përfundim, mund të themi se pavarësisht nga elementet egocentrike e narcizoide të shumë kundërshtarëve të kësaj ideje, edukata fetare nuk është aspak në kundërshtim me ligjin, apo kundër konfesioneve të tjera. Përkundrazi, ajo është një element me rëndësi në vetë jetën e individit, madje në aspektin psiko-social ndikon në personalitetin e vetë individit. Duke marrë parasysh dinamikën e shpejtë të jetës, globalizmin, procesin e sekularizmit, proceset radikale të liberalizmit, konkurrencën e tregut të lirë, si dhe vetë jetën postmoderne, ose atë që Giddens e quan "Modernitet i lartë'", jemi dëshmitarë që krahas këtyre proceseve, po shohim që çdo ditë rinia (e sidomos nxënësit) ballafaqohen me shumë probleme, duke u nisur që nga: delikuenca, alkooli, drogat e ndryshme, humbja e imazhit dhe vlerës së femrës, por edhe probleme të tjera. Edukata fetare nëpër shkolla nuk mund që t'i ndalojë këto plotësisht, por të paktën mundet të krijojë një vetëdijesim te ta. Nëse nxënësit mësojnë për përkatësinë e tyre fetare, kjo nuk do të thotë se ata do të bëhen prijës fetarë, priftërinjë hoxhallarë ose pastorë, por sikurse në çdo shoqëri demokratike-laike, edhe këtu, secili do të ketë qasje për konfesionin e tij. Madje, një gjë e tillë mund të bëhet edhe në kuadër të lëndës së kulturës fetare, ose edhe të lëndës së edukatës qytetare, sepse nuk paraqet ndonjë rrezik potencial për shoqërinë kosovare. ■

Në kërkim të marrëvesh

Sigurisht që Ti (Muhamed), nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as nuk mund t'i bësh të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen Tënde, kur të kthejnë shpinën!" "Ti nuk mundesh t'i nxjerrësh as të verbrit nga humbja e tyre! Ty të dëgjojnë vetëm ata që besojnë Shpalljet Tona dhe na nënshtrohen Neve (si muslimanë)". *(Neml: 80-81)*



Muhamed J. KAJOLLI

Siç u tha më herët në Betejën e Devesë, asnjëra palë nuk ishte për luftë. E gjithë ajo që kërkohej ishte të kuptoheshin më saktë se për çfarë do të luftonin. Për fat të mirë, ata u kuptuan mes vete dhe beteja nuk do të zhvillohej, por ndodhi ajo që ndodhi pasi një grup brenda ushtrisë së Aliut r.a. dredhoi. Sidoqoftë, në këtë betejë u vranë dy personalitetet kryesore të treshes dhe me të mbaroi çdo gjë.

Në Luftën e Devesë muslimanët u sprovuan rëndë, duke nxjerrë mësim vetëm pasi lanë të vrarë nga 6500-10000 vetë dhe shumë të plagosur.[1] Pasi beteja u ndërpre, Aliut iu desh të qëndronte edhe dy javë në qytetin e Basrës, derisa u bind se situata ishte qetësuar. Edhe pse që nga dita e parë pasi hynë në qytetin e Basrës nuk kishte më vrasje, individë të zemëruar herë pas here shprehnin revoltën e tyre.[2]

Nëse mund të themi se palët ndërluftuese pas betejës, midis Aliut dhe treshes, u morën vesh, a mund të themi se ushtria e Aliut e ndryshoi përbërjen e saj? Përgjigja do të ishte jo, sepse akoma në mesin e ushtrisë së tij mbetën komplotistët. Me të drejtë dikush do të pyesë pse Aliu nuk e pastroi ushtrinë e tij nga ata që morën pjesë në vrasjen e halifit Osman r.a. kur ai tani kishte fuqinë ushtarake? Me sa duket ai nuk e bëri këtë, sepse përleshja ia prishi strukturën dhe gjendja ndryshoi. Po ashtu, doli sërish se nuk ishte prioritet gjykimi i tyre dhe se largimi tyre mund t'i shkaktonte probleme të paparashikueshme.

Historia na mëson se atje vërtet lindën shumë probleme të tjera të reja dhe u zhvilluan shumë beteja të përgjakshme, por ajo që është me rëndësi këtu është se shkaktari i të gjitha atyre problemeve dhe përçarjeve nuk ishte Aliu r.a. Roli i tij, si halif dhe dijetar i madh, ishte afrimi dhe uniteti i mbarë umetit musliman. Ai ishte kundër çdo ndarjeje regjionale midis muslimanëve dhe për këtë arsye atë do ta gjejmë në çdo vend që frynte era e përçarjes.

Ndërsa Muaviu nuk mendonte si Aliu r.a., sepse arsimimi tij ishte më shumë i një ushtaraku, se sa i ndonjë dijetari. Ky, gjithashtu, kishte fituar një eksperiencë të shkëlqyer politike. Ai nuk posedonte as për së afërmi diturinë e Aliut, por, si ushtarak që ishte, kishte aftësi të përballej me kë dëshironte në botë. Ai ua kishte futur frikën në palcë krerëve të perandorisë bizantine. Edhe pse në shtetin islam kishin plasur luftërat civile, bizantinët as që provuan t'i sulmojnë musimanët në regjionin ku sundonte Muaviu. Ai, edhe në këtë gjendje që ishte, kishte gatishmëri të përballej me bizantinët.

Problemi esencial ishte tek parimet. Aliu r.a. kërkonte bashkimin e muslimanëve, ndërsa Muaviu, si i përjashtuar që ishte për të qenë halif,[3] kishte dalë në 'mbrojtje' të kushëririt të tij të vrarë. Shumë historianë e vënë në pikëpyetje sinqeritetin e Maviut,[4] kur ai kërkonte hakmarrje. Përderisa Muaviu nuk e pranonte Aliun r.a. si halif legjitim, ai sigurisht që nuk do ta pranonte edhe gjyqin e tij, sepse parimet themelore të edukatës së këtyre dy personave ishin të kundërta, prandaj edhe prioritetet nuk i kishin të njëjta.

Kjo botë apo tjetra?[5]

Aliu r.a. me ushtrinë e tij të bashkuar doli nga Basra për në Kufe. Ky qytet u bë çerdhja kryesore e Aliut r.a. deri në vdekjen e tij. Derisa qëndroi aty, ai bëri përpjekje ta bindte Muaviun që ta njihte si halif të muslimanëve, sepse tani ai veç e kishte ndryshuar demografinë politike. Përveç Shamit, atë e kishin pranuar të gjitha qendrat e mëdha të shtetit islam, duke filluar nga Jemeni, Basra, Kufja dhe Egjipti. Nga prefektura e Egjiptit vetëm një territor i vogël, i quajtur Khurbe, vend që gjendej në perëndim të qytetit të Aleksandrisë, e kundërshtonte Aliun r.a. për halif. Banorët e këtij territori kërkonin me këmbëngulje gjakun e Osmanit, ndërsa prefekti Kajs Ibën Sead el Ensarij[6] e refuzoi urdhrin e Aliut r.a. që ta nënshtronte këtë territor, me pretekst se këta ishin muslimanë të devotshëm, edhe pse ishin përkrahës të Muaviut.

Për këtë arsye, në vend të tij, u dërgua Eshter En Nuhaij, i cili nuk pati fat të arrinte në Egjipt, për shkak se vdiq i helmuar në afërsi të Egjiptit.[7] Më pas u dërgua Muhamed Ibën Ebi Bekri. Ai mbajti fjalimin e tij në namazin e xhumasë, ku edhe e informoi popullin për postin e tij. Pa vonuar shumë, ky e dërgoi Ibën Hudhejfen për në Khurbe, i cili e mposhti këtë vend në muajin Ramazan të vitit 36 h. Muaviu, pasi kishte mësuar se ç'kishte ndodhur me përkrahësit e tij, shkoi vetë me një ushtri të madhe dhe e ndaloi Ibën Hudhejfen të hynte në Fustat (Kajron e sotme). Por, pasi u morën vesh me njëri-tjetrin, ushtria e Ibën Hudhejfes hyri në Kajro.[8]

Secili që lexon rreth luftërave të para civile të muslimanëve shokohet. Askush nuk beson se si kanë mundur të zhvillohen ato beteja midis shokëve e vëllezërve. Askush nuk mund të pajtohet me motivin e futjes në betejë, por ja që fatkeqësisht ndodhën. E mira dhe e keqja, interesi i kësaj bote dhe interesi i botës tjetër do të jenë prezent gjithmonë ndër njerëz sa për ta ngacmuar mendjen e njeriut. Njeriu do të provohet deri në fund të jetës së tij. Allahu në Kuran thotë: *"Vallë, a nuk e shohin ata se çdo vit vihen në provë një herë ose dy herë..."* dhe ajeti tjetër: *"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë: 'Ne besojmë', pa u vënë në provë"* .

Egjipti, si dhe qendrat e tjera të mëdha, për të treguar lojalitetin e tyre ndaj halifit, kishin dërguar ushtarë. Tani numri i përgjithshëm i ushtrisë së halifit, që po grumbullohej në Kufë, ishte mbi 120 mijë ushtarë.[9] "Nëse bazohemi në historinë e Taberiut, vërejmë se ai e ka llogaritur numrin e ushtarëve të rajoneve, pas luftës së Siffinit. Kufasit ishin në gjendje të nxirrnin sa herë që dëshironin

njes dhe Beteja e Siffinit

një kontingjent prej 40 mijë ushtarësh, ndërsa Basra 60 mijë ushtarë. Në vitin 55h, Basra ishte në gjendje të mobilizonte 70 mijë ushtarë, ndërsa në vitin 64h ajo mobilizoi 80 mijë ushtarë." (Xhait:173)

Të bazuar në këto të dhëna, shumica dërmuese e historianëve e pranojnë numrin e prezantuar nga historianët e mëhershëm, por ajo që duhet potencuar këtu është se ushtria e Aliut r.a. ishte e re dhe pa eksperiencë. Ushtarët ishin të krahinave të ndryshme dhe nuk e njihnin mirë njëri-tjetrin. Kjo mos eksperiencë dhe kjo njohje e shkurtër do të dëshmohej në luftën e Siffinit. Ushtria e Muaviut ishte kompakte dhe e disiplinuar. Ai ishte dëshmuar kundër Bizantit, prandaj edhe fjala e tij dëgjohej. Me një fjalë, eksperienca kishte bërë të vetën.

Sidoqoftë, derisa Aliu r.a. po grumbullonte ushtrinë e tij në Kuffe, ai dërgoi në Sham një njeri nga elita e fisit El Bexhelij, që njëkohësisht ishte edhe sahabij[10] shumë i nderuar, edhe pse kishte qëndruar në Islam vetëm 40 ditë me Muahmedin s.a.v.s. Relacionet e tij me Muaviun kishin qenë të mira, prandaj ai ishte edhe shpresa e fundit për përmirësimin e gjendjes. Mirëpo ai nuk pati mundësi të kthehej shpejt tek Aliu r.a., pasi Muaviu ia vonoi përgjigjen për një kohë të gjatë.[11] Me t'u kthyer ai, Aliu r.a. do të vendoste të marshonte drejt Shamit, sepse kështu durimi tij ishte i pakuptimtë.

Lufta e Siffinit

Ushtria e halifit u nis, përafërsisht, në muajin Sheval 37h, ose mars të vitit 657-të. Në Kuffe[12] ai la si zëvendës të tij Abdulla Ibën Abasin. Me të kaluar lumin Eufrat, te qyteti i Rikk-ës, dy ushtritë u përballën me njëra-tjetrën, në afërsi të Siffinit[13]. Kjo fushë, asnjëherë më parë, nuk ishte mbushur me ushtri kaq të mëdha si këto dy ushtri dhe as që u mbush ndonjë herë tjetër më pas, deri në ditët e sotme. Me të shikuar njëra-tjetrën, shpërtheu një zënkë midis tyre rreth përdorimit të ujit të lumit, por pa pasoja të mëdha.

Dy ushtritë ishin të gatshme t'i lëshonin pe njëra-tjetrës, për shkak se konsideroheshin vëllezër mes vete, por fatkeqësisht krerët e tyre nuk mendonin kështu. Me t'u stabilizuar situata, Aliu r.a. i dërgoi Muaviut një tjetër delegacion, të përbërë prej tri vetave: 1. Beshir Ibën Amër El Ensarij, 2. Seid Ibën Kajs El Hamedani dhe 3. Shebeth Ibën Rubej et Temimi.

Beshiri kishte marrë nga Aliu instruksione që ta ftonte në paqe dhe t'i ulin armët, në mënyrë që të mos bëheshin prej atyre që ndiqnin rrugën e shejtanit. Muaviu tha: -*Si thoni, ta lëmë në harresë gjakun e Osmanit!?* Natyrisht, Muaviut nuk i pëlqeu kur atij i thanë se me atë punë do të merrej halifi, por fillimisht do të duhej që të merreshin vesh. Kur do të uleshin armët dhe do të njihej Aliu për halif, do të formohej një gjyq, i cili do të vendoste për fatin e tyre. Atëherë Muaviu e akuzoi Aliun *se kishte gisht në vrasjen e Osmanit, nëse nuk ishte ashtu siç thoshte ai, atëherë le tua dorëzonte komplotistët, të cilët ishin në rrathët e ushtrisë së Aliut r.a., dhe pastaj të formohej një komision, i cili do të vendoste për zgjedhje të reja për halif.*[14]

Delegacioni u kthye pa marrëveshje. Kështu rifilloi fërkimi midis dy ushtrive. As pala e Aliut r.a., e as ajo e Muaviut nuk sulmonin me gjithë potencialin që kishin në dispozicion. Si duket, Aliu kishte akoma shpresa për të arritur një marrëveshje paqësore. Përshkruesit e historisë japin detaje të hollësishme rreth kësaj beteje, saqë luftimet e dymujorit të parë[15] të jepnin përshtypjen se aty nuk po luftohej fare. Me këso farë akrobacionesh luftarake arritën në muajin Muharrem (të vitit 37h, ose qershor 657) dhe u morën vesh që të mos luftonin gjatë gjithë këtij muaji. Qëllimi i Aliut r.a. ishte që gjatë këtij armëpushimi, të bënte përpjekje të sërishme për paqe. Për të ishte tmerrësisht e vështirë të jepte urdhër për sulm të përgjithshëm.

Aliu r.a., pak para se të përfundonte muaji Muharrem, dërgoi edhe një delegacion të përbërë prej katër vetash: 1. Adij Ibën Hatim, 2. Jezid Ibën Kajs El Erhebij, 3. Zijad Ibën Hafsan dhe përsëri do të dërgojë 4. Shebeth Ibën Rubej



Adij-i e filloi bisedën i pari Edhe ky nuk e ndryshoi fjalimin e tij prej shokut të tij Beshirit, i cili ishte në përbërje të delegacionit të mëhershëm. Fatkeqësisht, Muaviu fjalimin e tij e mori si kërcënim: *"Pale po më kërcënoni me këto kujtesa...,"* atëherë Shebeth-i i tha, ndërsa ti po na end poshtë e lart me llafe, kur ti e di fare mirë se kush është Aliu dhe cilat janë meritat e tij në umet...Muavia ia ktheu: *"Ju ftoni për bindje dhe unitet. Sa i përket unitetit jam në mesin tuaj, ndërsa sa i përket shokut tuaj (Aliu), ai është i cili e vrau prijësin tonë dhe i përçau muslimanët, e veç kësaj i mban afër vrasësit."*

- Ai thotë se nuk e ka bërë, - iu përgjigjën. *Po ju nuk e shihni se vrasësit e Osmanit janë me të? Nëse është i sinqertë le të na dorëzojë ata që t'i vrasim dhe atëherë ka bindje dhe bashkim.* -A mos vallë dëshiron ta vrasësh Amarin? - E çfarë më ndalon kjo mua, - ia priti Muaviu, - nuk do ta vrisja për Osmanin, por

për Natilin.[16] Shebeth-i ia ktheu "Nuk ke për të arritur tek ai, pa shkelur mbi trupat tanë të vdekur dhe pa t'u bërë toka e ngushtë...(Taberi: 5/ 5-6)

Këtyre fjalëve të ashpra, Muaviu ju përgjigj me fjali edhe më ashpra...dhe sërish nuk u morën vesh. Po në këtë kohë, edhe Muaviu e kishte dërguar delegacionin e tij të përbërë nga: 1. Hubejb Ibën Mesleme El Fihrij, 2. Shurhebil Ibën El Simt El Kindi[17], 3. Mean Ibën Jezid Ibën El Ekhnes. (Taberi: 5/6)

Biseda e Hubejbit qe e cekët dhe e thjeshtë: "Osmani ishte prijës meritor dhe punonte sipas Librit të Allahut dhe vetëm Atij i nënshtrohej, ndërsa ju ia rënduat jetën atij, i shpallët luftë dhe e vratë. Nëse pretendon se nuk e ke vrarë, atëherë na i dorëzo dorasit që t'i ekzekutojmë. Më pas, lëri njerëzit të lirë të zgjedhin kë të duan për halif. - *Po ti ç'ke në këtë mes, kjo nuk është punë për ty*, - ia ktheu Aliu r.a.

Edhe të tjerët nga delegacioni ndanë të njëjtin mendim të Hubejbit, ndërsa Shurhebili i tha: -Ke për të shtuar diçka më shumë se kaq? – Po, - ia ktheu - pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s., njerëzit e zgjodhën Ebu Bekrin dhe ky vetë e la pas Omerin r.a. Këta ishin shembulli më i përsosur në drejtësi e mirësi. Pas tyre drejtimin e mori në dorë Osmani, i cili bëri gjëra për të cilat njerëzit e qortuan, duke shkuar deri në vrasjen e tij. Pas kësaj më erdhën njerëzit e më kërkuan që ta pranoj drejtimin, por e refuzova. Pas këmbënguljes së tyre u binda se duhet ta pranoj, pasi nuk desha përçarje. Të gjithë më pranuan, përveç Muaviut të cilit Allahu nuk i dha përparësi në besim, as paraardhës të sinqertë në fe. Ai i takon një pjese që e luftoi të Dërguarin deri në momentet e fundit kur bashkë me babanë e tij pranuan të hyjnë në fe pa dëshirën e tyre, prandaj nuk ju takon t'i shkoni pas atij e t'i ktheni krahët familjes së Pejgamberit, e t'i mundoni ata ose t'i barazoni me këdo.

E pra, unë ju ftoj për te Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit s.a.v.s., si edhe që të largoheni prej kotësive. Shurhebili tha: -Dëshmoj se Osmani është vrarë padrejtësisht! - *Nuk them se është vrarë padrejtësisht, e as me të drejtë* - ia ktheu Aliu r.a. U ngritën të nervozuar dhe thanë: -Ata që nuk e pranojnë se Osmani është vrarë mizorisht, nuk kanë punë me ne dhe u larguan. (Taberi: 5/6-7, Xhait: 189) Aliu pastaj citoi ajetet kuranore: *"Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as nuk mund t'i bësh të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen Tënde, kur të kthejnë shpinën!" dhe ajetin tjetër: "Ti nuk mundesh t'i nxjerrësh as të verbrit nga humbja e tyre! Ty të dëgjojnë vetëm ata që besojnë Shpalljet Tona dhe na nënshtrohen Neve (si muslimanë)".* (Neml: 80-81)[18]

Kështu të dy palët filluan të përgatiten për luftë. Me të filluar dita e parë e muajit Sefer rifilloi lufta, por edhe kësaj radhe intensiteti i luftimeve ishte i vogël. Ndërsa Aliu r.a. çdo ditë dilte në fushëbetejë, midis dy palëve ndërluftuese dhe thoshte:

- Nga cila ditë e vdekjes të iki?
- Nga ajo e cila nuk më është caktuar, apo nga ajo e cila më është caktuar?
- Nga dita e cila nuk më është caktuar, nuk trembem.
- Ndërsa nga Caktuesi nuk shpëton i kujdesshmi (Shelebi:2/628)

Në këtë betejë, derisa intensiteti i luftimeve ishte i ulët u vra djali i Omerit, Ubejdullahu[19]. Kështu vazhdoi deri në ditën e gjashtë të luftimeve. Në të gdhirë të ditës së shtatë, pas një fjalimi të gjatë që u mbajti ushtarëve të tij, Aliu r.a. urdhëroi për sulm të përgjithshëm. Atë ditë u zhvillua një luftë e rreptë deri në muzg. Dita e nesërme, e teta me radhë, në Sefer të vitit 37 hixhrij, ishte edhe më e rëndë, sepse Amari[20], i cili mbante flamurin e ushtrisë së Aliut po futej gjithandej, por askush nga luftëtarët kundërshtarë nuk e vriste, bile i bashkëngjiteshin atij.

Këtë ditë u vra një komandant shumë i rëndësishëm i Muaviut, por atë nuk e dëshpëroi vrasja e tij[21]. Ushtria e Aliut r.a. po avanconte shpejt dhe kjo dukej qartë. Dikush[22] iu afrua Amarit dhe e goditi për vdekje. Me t'u përhapur lajmi se Amari u vra, ndaluan shpatat nga të dy palët. Ndërsa Muaviu thirri në bisedime personat më të afërt të tij[23] për të diskutuar për mbarëvajtjen e mëtutjeshme.

Vrasja e Amarit nënkuptonte humbjen definitive të Muaviut. Ndërsa Abdullahu ia përkujtoi babait të tij Amrit, hadithin e Pejgamberit s.a.v.s. për Amarin. Muaviut i shkrepi nga goja thënia: e vranë ata që e sollën këtu e jo ne. Kjo fjali sikur i pëlqeu dhe e përsëriti disa herë me zë të lartë, derisa e dëgjuan të tjerët që ishin jashtë. Kjo fjali e ndezi flakën dhe ushtria filloi të brohoriste: vrasës janë ata që e sollën këtu, e jo Muaviu. Kështu Muaviu vazhdoi të kishte përkrahje dhe luftimet rifilluan. Megjithatë, ushtria e Aliut kishte epërsi dhe po ngadhënjente. Luftimet vazhduan edhe gjatë natës. Goditjet filluan me gurë e me grushte, sepse municionet (heshtat dhe shigjetat) ishin sosur dhe shumë shpata ishin thyer.

Këto tri ditë të fundit u vranë dhjetëra mijëra vetë nga të dy palët.24 Muaviut nuk i mbetën shpresa për ndërprerjen e betejës. Ai po zhytej dhe për herë të parë po shikonte humbjen e thellë. Në këtë gjendje të tmerrshme, Amër Ibën Asi iu afrua dhe i tha: -Të propozoj që t'i ngremë Mus'hafat (Kur'anin) në shtiza dhe të brohorasim se duam të gjykojmë me Kur'an.25 Pra, le të gjykojë Kur'ani midis nesh, ose le ta shikojmë ligjin e Zotit që është në Kur'an. Ishte ide brilante për shpëtim.



Kur Aliu e pa këtë gjest tha se kjo ishte një prej hileve të Amr-it, dhe kërkoi që lufta të mos ndërpritej, sepse ishin pranë fitores së përgjithshme. Por nuk menduan kështu disa prej komandantëve të Kufes dhe ata i sugjeruan Aliut r.a. t'i ndalonin luftimet menjëherë, sepse thirrja ishte që të gjykohej sipas Kur'anit. Këtu u tregua dobësia e ushtrisë së re. Aliu r.a. përpiqej t'i bindte, por ishte e kotë. Atëherë ai u tha: "...Na ke ftuar që mes nesh të gjykojë Kur'ani, ndonëse ti nuk je nga ithtarët e tij. Ne nuk të jemi përgjigjur ty, por i jemi përgjigjur Kur'anit, që ai të gjykojë." (N. Belaga:272) ■

(Në numrin e ardhshëm, inshaeAllah, do të flasim për arbitrazhin.)

---

1 Numri i saktë i të vrarëve nuk dihet, por nëse bazohemi në numrin e të humburve të numëruar prej fiseve pjesëmarrëse në betejë mendohet se numri i të vrarëve nuk ishte më pak se 6500, ndërsa disa historianë japin shifra deri në njëzet mijë të vrarë. Personalisht përkrah mendimin se nuk ka pasur të vrarë më shumë se 10 mijë luftëtarë.

2 Sikurse kemi rastin kur disa të zemëruar e fyenin Aliun, ndërsa ai heshte. Njëherë, njëri prej shoqëruesve të tij i tha: -A nuk i ndëshkon këto gra? Ai iu përgjigj: -Jemi urdhëruar t'i durojmë gratë politeiste, e si mos t'i durojmë edhe gratë muyslimane? Ose rasti i dy personave që e ofenduan Aishen (r.a.) Aliu (r.a.) e dëgjoi zërin e dy burrave duke e ofenduar Aishen (r.a.). Ai (r.a.) e urdhëroi Ka'ka' Ibën Amirin që t'i rrihte me kamxhik secilin, pa rroba në pjesën e sipërme të trupit. Ai u përpoq t'ia kujtonte secilit individ, se ajo ishte nëna e besimtarëve: "Mos harroni se është gruaja e të Dërguarit s.a.v.s. në këtë botë dhe në ahiret". (Taberiu4/ 370)

3 Muslimanët kishin krijuar disa standarde për emërimin e halifëve. Ai i cili kishte përvojë më të madhe me Pejgamberin s.a.v.s. dhe më së tepërmi dije, kishte të drejtën për të kandiduar për halif. Këto standarde përjashtonin nga të gjitha format familjen e Ebu Sufjanit. Këta kishin luftuar për njëzet vjet radhazi Islamin dhe muslimanët, dhe njëri prej tyre kishte qenë edhe Muaviu. Ndonëse këta ishin të përjashtuar nga këto standarde, ata nuk pengoheshin që të kontribuonin për shtetin e ri, prandaj edhe kishin poste të larta në administratën e Ebu Bekrit, Omerit dhe Osmanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre).

4 Historianët bazohen në letrat që endeshin midis prefektëve. Muaviu në çdo formë mundohej t'i bindte prefektët të dëgjonin zërin e tij, pasi ai do t'i shpërblente me poste të larta...

5 Këtë nëntitull e nxora nga këshillat që ia dhanë Amër Ibën Asit dy djemtë e tij, Abdullahu dhe Muhamedi.

6 Ky refuzim nuk duhet të kuptohet se ishte kundër Aliut r.a., por kundër bindjes së tij për të vepruar, sepse ky pasi dha dorëheqje u rreshtua në radhët e ushtrisë së Aliut r.a. dhe mori pjesë në luftën e Siffinit.

7 Disa historianë thonë se Eshteri u dërgua pas vrasjes së Muhamedit…(Allahu e di më së miri), por ajo që duhet theksuar këtu është se Amër Ibën Asi, pasi u këshillua me dy djemtë e tij, kishte vendosur të përkrahte Muaviun për halif dhe e kishte këshilluar atë që secili njeri që do të caktohej në Egjipt duhej të vritej.

8 Për sigurinë e marrëveshjes kishin këmbyer pengje. Prej pengjeve doli Ibni Hudhejve, prefekti i Egjiptit. Me të shkuar në territorin e Muaviut, ky i fundit e burgosi atë. Si duket, pas një kohe, Ibën Hudhefe me shokët e tij paskan arritur të ikin disi, por janë kapur sërish. Muaviu gjeti si shkak arratisjen e tij dhe vendosi që ta dënonte me vdekje, gjë që edhe e bëri. (Mukhtar Pasha:f. 68)

9 Disa historianë mendojnë se numri i dy ushtrive (Aliut dhe Muaviut) ishte 120 mijë, e jo vetëm ushtria e Aliut r.a. Disa të tjerë thonë se numri ishte 140 ose 150 mijë. Numri i ushtarëve kundërshtarë ka qenë, nga të dy palët, thuajse i barabartë.

10 Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) kishte dërguar te Muaviu disa personalitete që të merreshin vesh, por secili prej tyre ishte kthyer pa rezultat. Së fundmi, kishte dërguar edhe Xherir Ibën Abdullahun El Bexhelijun, të cilit i kishte dhënë një letër... Duke qenë se Xheriri numërohej si njëri prej elitës muslimane, dhe kishte relacione të mira me Muavinun, ai ishte mbajtur më gjatë. Disa thonë se ai e kishte burgosur. Shkak i vonesës së përgjigjes nga ana e Muaviut ishte se ai po konsultohej me anë të letrave me disa nga këshilltarët e tij, sikur që ishte Amër Ibën Asi, i cili në atë kohë ishte në Palestinë. Muaviu gjatë kësaj kohe dërgoi letra në Mekë e Medinë. Ai nuk e anashkaloi as Abdullah Ibën Omerin, e as Sead Ibën Vekasin. Të gjitha këto letra gjenden në librin e Dinurit "Imametu we sijase", si dhe disa prej tyre edhe te libri rreth sahabëve - Usdul Gabe. Si ata të Mekës, po ashtu edhe ata të Medinës, e qortuan Muaviun në letrat kthyese të tyre, me përjashtim të Amër Ibën Asit, i cili ishte këshilluar me dy djemtë e tij, Abdullahun dhe Muhamedin. I pari e këshilloi babanë të qëndronte përkrah Aliut r.a., ndërsa Muhamedi e këshilloi të shkonte me Muaviun. Amër Ibën Asi, ju tha: -Abdullahu po më këshillon ahiretin, ndërsa Muhamedi këtë botë. Përfundimisht, ky njeri merret vesh me Muaviun që, pasi të mbarojnë punë me Aliun, t'ia jepte Egjiptin në këmbim të ndihmës së tij...

11 Thuhet se Muaviu e kishte futur në burg shtëpiak derisa të merrte përgjigjen nga Amër Ibën Asi, i cili ishte atëkohë në Palestinë, dhe nga disa qendra të tjera, prej të cilave ai kishte nevojë për mendimin e tyre.

12 Si duket Aliu r.a. do të përcaktonte që Kufja të bëhej kryeqyteti i shtetit islam, sepse filloi ta bartë tërë administratën e shtetit në këtë qytet.

13 Fusha e Siffinit tani është nën administrimin e regjionit të Rikës, në shtetin e sotëm të Sirisë.

14 Për më shumë lexo historinë e Taberiut, libri 4/389-39 dhe libri 5/5-24, si dhe Bidaje we Nihaje, libri 5/485-510

15 Kemi disa mendime rreth kohëzgjatjes së kësaj beteje. Ka prej tyre që thonë se lufta ka zgjatur 40 ditë (Jakubi: f. 188) deri në 110 ditë (Muhtar Pasha: f. 69)

16 Për shkak të një shërbëtori të Osmanit r.a., e jo për vetë Osmanin. Kjo shprehje sikur e nervozoi edhe më keq Shebeth-in.

17 Gjatë kohës së Muaviut, ishte emir i Himsit. Ai i qëndroi besnik Muaviut në luftën e tij kundër Aliut r.a.. Shkaku i besnikërisë së tij lidhet ngushtë me të dërguarin e Aliut te Muaviu, Xherir Ibën Abdullahun, i cili paska qenë kundërshtari i tij i kamotshëm. Muaviu e paska burgosur të dërguarin e Aliut derisa t'ia jepte përgjigjen e duhur për Aliun r.a., ndërkohë paska mësuar se Sherhebili paska qenë kundërshtar i tij, gjatë gjithë jetës. Për këtë arsye e thërret atë për të debatuar me të, ndërkohë derisa ai po shkonte tek ai, rrugës i paskan dalë disa individë të caktuar prej Muaviut që t'i thonë atij se ai që e vrau Osmanin ishte Aliu. (Ibn Ethir- "Usudul Gabe fi Mearifeti Sahabe": 2/513)

18 Për më shumë lexo: Historia e Taberiut, libri pestë, faqja 5-9.

19 Për shkak të mëkatit që kishte bërë, Omeri, prijësi i besimtarëve e kishte dënuar me kërbaç. Ky njeri kishte ikur te Muaviu nga frika se mos Aliu r.a. do ta ekzekutonte, pasi u emërua halif. Vërtet, Aliu r.a. do ta kishte ekzekutuar, sepse ishte prej atyre që tha se ky njeri të ekzekutohej ditën kur ky vrau ndihmësin e vrasësit të babait të tij. Ai që e shpëtoi ishte Amër Ibën Asi, ndërsa Osmani r.a. pagoi gjakun për të.

20 Kishte marrë sihariqin se atë ditë do të vritej, pasi i kishin ofruar një enë me qumësht. Ai e kishte dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. të kishte thënë se: "Do të vritet nga grupi që nuk do të ishte me të drejtën dhe e fundit që do të merrte nga kjo jetë do të ishte një enë qumështi që do ta pinte." Këtë thënie, për herë të parë, Pejgaberi s.a.v.s. e kishte thënë derisa muslimanët po e ndërtonin xhaminë në Medinë...

21 Dhu El Kila'a ishte njëri prej elitës së Shamit. Ai e kishte paralajmëruar Muaviun se Amari është me ushtarët e Aliut, ndërsa Muaviu, duke qenë një njeri i zgjuar ia ktheu: - Kush të siguron se ai nuk mund të kalojë në ushtrinë tonë? Koha do të tregojë se ne jemi në rrugë të drejtë. Më pas ai i tha: -Nëse Amari vritet duke qenë në ushtrinë e Aliut, unë do t'i them ushtrisë së Shamit të kthehet me Aliun. Muaviu kishte frikë se mos vritej Amari, por për 'fat' të Muaviut, Dhu El Kila'a u vra pak kohë para Amarit.

22 Ibën Xheua Es Suksukij dhe Ebu Gadije El Tizarij nuk iu besonin hadittheve të Pejgamberit dhe e vranë …(Thartori:164)

23 Në këtë mbledhje ishin: Muavi Ibën Sufjan, Amër Ibën As me djalin e tij Abdullahun dhe Ebu El Aëvel Es Silmij.

24 Shumica e historianëve theksojnë se në këtë luftë u vranë mbi 75 mijë luftëtarë. 45 mijë nga ana e Muaviut, ndërsa 25 mijë nga ana e Aliut. Ushtria e Aliut, numerikisht, ishte shumë më shumë se e Muaviut.

25 Formës së ngritjes së Mus'ahavëve, Ahmend Shelebia i ka kushtuar rëndësi të veçantë. Për më shumë lexo: librin e parë, faqe 627-630 (Tarihul Islamij).

Etika dhe teknologjia

Muslimanët nuk skanohen

Drita AZEMI

Lufta kundër terrorizmit i ka detyruar shumë qeveri perëndimore që të ndërmarrin masa shtesë për sigurinë e vendeve të tyre. Rreziku prej akteve kamikaze është bërë edhe më i ndjeshëm kur kihet parasysh fakti se në mesin e kamikazëve ka edhe femra me ferexhe. Një ndër masat e sofistikuara parandaluese që kanë instaluar vendet perëndimore është edhe teknologjia detektive e sofistikuar e skanimeve. Megjithatë, kjo masë ka përplasur etikën me teknologjinë. Kështu dy gra myslimane janë bërë pasagjeret e para, të cilat kanë refuzuar të futen në skanerë për shkak se ai tregon trupin e tyre të zhveshur. Të dyja, për të cilat zyrtarët e sigurimit insistojnë se ka qenë një rast i rrallë, kanë zgjedhur të humbin fluturimin për në Pakistan dhe të humbin biletat e tyre me vlerë prej 400 funtesh, për shkak se nuk kanë dashur që trupi i tyre të fotografohet. Njëra grua ka refuzuar të bëjë skanimin e trupit të saj në Aeroportin e Manchester'it për shkak të arsyeve fetare, përderisa shoqja e saj ka thënë se këtë e bën për shkak të "arsyeve mjekësore". Të dy gratë ishin duke udhëtuar së bashku për në Islamabad, kur është dashur që të kalojnë nëpërmes procedurave të sigurimit në terminalin e dytë të aeroportit të Manchesterit. Përafërsisht 15 000 njerëz kanë kaluar nëpërmes skanerëve, por ky është çifti i parë që ka refuzuar të skanohet. Të dyja i kanë thënë stafit të aeroportit se nuk dëshirojnë të skanohen. Atyre u është tërhequr vërejtja se nëse nuk e bëjnë këtë, nuk do të mund të aterojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Pakistanit. Ato kanë vendosur që më parë do të preferonin t'i humbnin biletat në vlerë 400 funte dhe të largohen nga aeroporti me bagazhin e tyre. Skanerët që kushtojnë 80 000 funte britanike janë vendosur në aeroportet Heathrow dhe Manchester, më pesë shkurt. Makinat me rreze X i japin mundësi stafit të sigurimit të shikojnë pasagjerët krejtësisht të "zhveshur" dhe kështu ata mund t'i shohin armët e fshehura dhe eksplozivet, por ka pasur kritika pasi që ata mund të shohin shumë pastër edhe gjenitalet e pasagjerëve. Aeroporti i Manchesterit ka konfirmuar që pasagjerët kanë refuzuar të futën në skaner, por kanë thënë se ata nuk kanë marrë asnjë ankesë nga dy gratë. Megjithatë, militantët për të drejtat civile thonë se incidenti në fjalë mund të testohet si një gjë legale, e cila do t'i sfidojë zyrtarët e aeroporteve dhe pajisjet e tyre. Alex Deane, drejtor i fushatës "Big Brother Watch", ka thënë se organizata do të prezantojë gratë, të cilat mund të sfidojnë shtetin edhe në gjykatë. "Njerëzit nuk duhet të sakrifikojnë shëndetin, besimin, dinjitetin dhe privacinë e tyre vetëm për të fluturuar. Njerëzit me shëndet dhe pikëpamje fetare nuk duhet që të futen në skaner, nëse nuk kanë arsye ta bëjnë këtë. Është çmenduri që qeveria e injoron këtë problem dhe i injoron shqetësimet për privacinë e njeriut, që për mendimin tim është gabim", - tha ai. Ka një skaner të tipit "Rapiscan", që përdoret në terminalin e dytë të Aeroportit të Manchesterit, nëpër të cilin kanë kaluar gjatë muajit të kaluar 15 000 njerëz. Edhe dy pajisje të tjera, njëra në secilin terminal, do të vendosen gjatë muajit të ardhshëm. Skanerët janë kritikuar nga grupet për të drejtat e njeriut, madje edhe nga vetë Komisioni për të Drejtat e Njeriut në Qeveri. Vetëm pasagjerë të caktuar skanohen. Stafi i sigurisë thotë se ata i zgjedhin sipas dyshimeve të tyre dhe këtu nuk luan rol raca, feja ose etnia. Këshilltari Afzal Khan, i cili ishte njëri prej udhëheqësve të parë aziatikë të Manchester'it, thotë se shumica e muslimanëve besojnë që çdo shqetësim për privaci mund të peshohet me sigurinë e tyre kur ata fluturojnë. "Qindra pasagjerë mulimanë kanë shkuar përmes tyre pa ndonjë problem. Më pëlqen kur njerëzit shqetësohen për privacinë e tyre - por këto masa janë të nevojshme për sigurinë tonë". " Muajin e kaluar, sekretari i transportit, Lord Adonis, ka theksuar se për skanimin e trupave të pasagjerëve do të përdoret një kod i brendshëm dhe në të do të futen vetëm personat e dyshuar. Dy javë më parë, një javë pasi skanerët u vendosen në aeroportet e Manchester dhe Heathrow, edukatorët e islamit në SHBA thanë se udhëtarët muslimanë nuk duhet të kalojnë nëpërmes skanerëve, sepse ata shkelin rregullat fetare për nudizmin. Këshili i FIXH-it në Amerikën Veriore ka lëshuar një fetva, ose rregull fetare, që ua tërheq vërejtjen muslimanëve të mos hynë në skanerë. "Është një shkelje e mësimeve të Islamit që gratë dhe burrat të shihen të zhveshur nga burrat dhe gratë e huaja", - thuhet në këtë urdhër. "Islami e vlerëson lart 'haya'n' (modestinë) dhe e konsideron atë si pjesë të besimit. Kur'ani i urdhëron besimtarët, si gratë, ashtu edhe burrat, që t'i mbulojnë pjesët e tyre private". Tani në SHBA janë të vendosur 40 skanerë nëpër aeroporte dhe, deri në fund të këtij viti, mund të ketë më shumë se 450. Këshillit, të përbërë prej 10 hoxhallarëve, që kanë lëshuar këtë "fetva"', i është bashkuar edhe "Këshilli Islamik në Amerikën Veriore".■



Somalia – aty ku puqet jeta me vdekjen

Afganistani dhe Iraku kanë monopolizuar faqet e para të gazetave që prej disa vitesh, për shkak të luftës dhe viktimave, por Somalia është një tjetër viktimë e madhe dhe tragjike e politikave ndërkombëtare dhe veçanërisht e "luftës kundër terrorizmit". Ndërhyrjet e jashtme gjatë viteve të shkuara kanë qenë aq katastrofale, sa aktualisht shpresa më e mirë për të qetësuar situatën e rëndë është një president që e hodhën nga pushteti tre vjet më parë, i cili kontrollon disa kilometra katrorë të një vendi që është tre herë më i madh se Britania. Somalia është aktualisht shteti i fundit i dështuar dhe i falimentuar që kërcënon të destabilizojë gjithë rajonin. Piratët e saj kanë penguar edhe tregtinë e rregullt, që ka qenë një nga burimet e fitimit të vendit. Popullsia e këtij vendi po kalon aktualisht krizën më të rëndë humanitare të botës. Gjatë Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara futën shumë armë në Somali për të kundërshtuar mbështetjen që sovjetikët i jepnin Etiopisë fqinje. Në vitin 1991, krerët e klaneve të ndryshme rrëzuan nga pushteti diktatorin Siad Barred dhe e mbajtën për vete arsenalin e armëve. Në vitin 1992, Bush senjor dërgoi marinsat për të ndihmuar njerëzit që po vuanin, një mision që përfundoi në shpartallimin e Black Hawk Down-it, që u shoqërua me një tërheqje të amerikanëve. Më pas erdhën vitet e anarkisë dhe kaosit, ndërsa pushtetin e morën në dorë krerët e klaneve luftarake. Në vitin 2006, lindi një lëvizje me emrin Unioni Islamik i Gjykatave. Uashingtoni, nga frika se gjykatat do të shndërroheshin në gjykata të tipit taleban dhe vetë Somalia në një Afganistan të dytë, synuan që të ndalonin islamikët, duke furnizuar krerët e klaneve luftarake me miliona dollarë për armatime. Por këta ishin të njëjtët që e zhgënjyen Amerikën në vitin 1993 dhe si pasojë shkaktuan shumë masakra dhe kaos. Plani dështoi. Gjykatat i nxorën krerët e klaneve nga Mogadisho dhe vunë rregullin për herë të parë pas shumë vitesh. U zhdukën armët nga rrugët dhe postblloqet ushtarake. Biznesmenët dhe njerëz të tjerë të shkolluar u kthyen nga mërgimi dhe nisën të punonin në vendin e tyre. Titullari i gjykatës ishte Sheikh Sharif Ahmed, relativisht i moderuar, por lëvizja vetë përfshinte një krah ushtarak, si dhe elementë ekstremistë që vendosën ligje strikte. Evropianët ishin pro marrëdhënieve me liderët e moderuar të gjykatës. Administrata e Bushit mbështeti një sulm nga Etiopia e krishterë, armikja më e egër e Somalisë. Pas këtij pushtimi, gjykata u zëvendësua përmes një tranzicioni shumë të dhimbshëm nga pushteti i liderëve të klaneve luftarake. Pas gjashtë muajsh paqeje relative, Somalia u zhyt sërish në luftë dhe shpresat e paqes avulluan. Pushtetin e morën në dorë al-Shabaab-ët nacionalistë, që e quajnë veten mbrojtës të vendit. Sot ata kontrollojnë pjesën më të madhe të vendit. Në këtë vend duhet të ecësh ngadalë mes mbeturinave, për të mos shkelur në ndonjë predhë ose granatë të pashpërthyer, sepse nuk ka mënyrë tjetër për të parë atë çfarë mbetet nga Mogadisho, kryeqyteti somalez i shkatërruar prej 20 vjetësh luftime. Bombat dhe plumbat e kanë transformuar qytetin e mrekullueshëm kolonial në një varrezë ndërtesash të shkatërruara. Mijëra të pastrehë janë zhvendosur në gërmadhat e ndërtesave përgjatë bregdetit të Xamarweyne-s. Në lagjen e



vjetër tregtare të Scinganit, disa tabela të kujtojnë të kaluarën "Officina Fiat", "Caffe capuccino". Lufta civile e nisur në vitin 1991, pas rrëzimit të regjimit të korruptuar dhe autoritar të Mohamed Siad Barre-s, vazhdon të shkaktojë viktima, në indiferencën thuajse absolute të komunitetit ndërkombëtar dhe medias. Në luftën mes klaneve dhe nënklaneve për kontrollin e kryeqytetit mes ushtrive private të zotëve të luftës, milicitë islamike dhe trafikantët e armëve kanë shkatërruar gjithçka: ministri, ambasada, kazerma, dyqane, madje edhe hotelet janë rrafshuar plotësisht. Në fund të vitit 1992, imazhet e masakrave dhe të mungesës së ushqimit të shkaktuar nga lufta bënë që Kombet e Bashkuara të aprovonin zbarkimin në vend të një force shumëkombëshe. Por pjesëtarët e kontingjentit të operacionit "Restore hope", të minuar nga konfliktet e brendshme, pa një strategji koherente dhe qëllim final, gjendeshin shpesh nën zjarrin e milicive somaleze. Përpjekjet diplomatike të mëvonshme dhe konferencat e panumërta për paqen nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Kështu, për më shumë se një dhjetëvjeçar, Somalia u izolua në veten e saj. Agjencitë e OKB-së evakuuan personelin e huaj. Thuajse të gjitha OJQ-të u detyruan të tërhiqeshin. Presidenti aktual i qeverisë së tranzicionit, islamisti i moderuar Sheikh Sharif Ahmed, jeton i rrethuar në zyrën e tij, në një vilë madhështore. Qyteti është në duart e muhaxhedinëve të Al- Shabab-it dhe nga Hizbul-Islam-i i udhëhequr nga Hassan Dahir-i, i cili që prej vitit 2001 gjendet në listën e personave të kërkuar për aktivitete terroriste. Shababët, që kontrollojnë tashmë pjesën më të madhe të Somalisë Qendrore dhe Veriore, kanë pushtuar qytetin e Baidois, selinë e Parlamentit somalez, Dhusa Mareb, 500 kilometra në veri të Mogadishos dhe një pikë strategjike në jug të vendit. Deri disa vjet më parë, në Somali sulmet më të shumta që verifikoheshin ndodhnin pranë Nigerisë, në dalje të lumit Niger, meqë aty kishte një trafik të konsiderueshëm naftëmbajtësesh. Gjithashtu, në rrugët detare, që fillonin nga Deti i Kuq deri në gjirin Aden dhe për të përfunduar në oqeanin Indian, varkat e peshkimit nuk ishin shumë të rrezikuara nga pirateria, pasi afroheshin së tepërmi në brigjet veriore. Ndërsa gjatë këtyre tre viteve të fundit, në këto zona, të paktën në 3300 kilometrat e brigjeve somaleze, fenomeni është bërë alarmant. Nga dy sulme në vit (2004), tashmë ndodhin 67 sulme (2009). Dhe ky fakt është tepër shqetësues. Nëse në vitin 2003 peshkatarët këshilloheshin të rrinin të paktën 50 milje detare larg bregut, sot nuk konsiderohet e sigurt as distanca prej 200 miljesh. Por vetë ata e dinë se në detin somalez nuk ka asnjë autoritet që të ruajë sigurinë. Tashmë, pirateria aty është bërë një biznes i mirë, me shumë pak rrezik për keqbërësit. Madje, ajo zonë është bërë parajsa e piratëve. Në fakt, vendi nuk ka një qeveri të qëndrueshme që prej vitit 1991. Qeveria federale e tranzicionit, tentativa e fundit për të sjellë normalitetin dhe për të vendosur ligjet në Somali, arriti të zinte vend në Mogadisho vetëm në vitin 2007, falë ndërhyrjes ushtarake të Etiopisë. Por, nga një anë kjo nuk shërbeu për mirë, pasi gjatë gjashtë muajve që islamikët dominonin vendin, kontrolli i vijës bregdetare ishte absolut. Por pasi islamikët ranë nga pushteti, sulmet e piratëve u rritën ndjeshëm. Qeveria aktuale e përkohshme kontrollon vetëm disa zona të kryeqytetit dhe disa lokalitete të vendit. Milicitë islamike më parë u futën në luftë të vërtetë kundër piraterisë, por gjithsesi tashmë nuk ka rregull në tokë e jo më në det. Kështu, duke përfituar nga kaosi në vend, keqbërësit rifilluan sulmet. Në fund të fundit, 90 për qind e tregtisë botërore bëhet me anë të rrugëve detare. Pra, piratët i kanë përmirësuar cilësitë e tyre organizuese dhe ushtarake, për të qenë sa më efikas. Kanë marrë motoskafë më të mëdhenj dhe më të fuqishëm, mjete komunikimi të ndërlikuara dhe një armatim të përshtatshëm për synimet e tyre. E vetmja zonë relativisht paqësore e vendit është ish-territori britanik i Somalindadit. Aty janë duke u ndërtuar hotele të reja, restorante dhe qendra tregtare. Në raportet e OKB-së dhe në analizat e opinionistëve të politikës ndërkombëtare, Somalia përfaqëson shtetin e dështuar, me pak fjalë një "Far west" pa ligje, pa qeveri, pa shpresë. Aty një brez i tërë është formuar me armë në dorë, ku për të jetuar u duhej të vrisnin. Aty "killerat" janë të gatshëm që, për pak dollarë, të bëjnë gjëmën më të madhe. Statistikat përshkruajnë një tragjedi të pafund: 3.5 milionë somalezë, rreth 43 për qind e popullsisë rrezikojnë të vdesin urie; të pastrehët janë 1.3 milionë dhe 500 mijë janë refugjatë, sidomos në Kenia dhe Jemen. Një ndër gjashtë fëmijë nën 5 vjeç është i kequshqyer dhe jo më shumë se 15 për qind e popullsisë ka akses ndaj shërbimit shëndetësor. Në Mogadisho, të varfrit mbushin qendrat ushqimore të organizatave ndërkombëtare, ndërsa spitalet pa ujë, drita dhe ilaçe, përpiqen të shpëtojnë sa më shumë jetë që munden. Natën qyteti zhytet në errësirë. Vdekje për së gjalli. ■



Përktheu: Arsim JONUZI

Tragjikomedia e një diktatori?!

Shenashi XHELADINI

Adolf Hitler u lind më 20 prill 1889, në Braunau mbi Inn në Austri. Vonë do të merrte vesh se kishte lindur nga një baba i paligjshëm dhe që nga ajo ditë nuk do ta zinte kurrë në gojë mbiemrin e të atit, as kur e sulmonin kundërshtarët politikë për këtë të vërtetë. Jo, se i vinte turp, por, sepse vetë Hitleri kishte pasur marrëdhënie me vajzën e motrës së tij. Incesti, në atë familje po kalonte nga njëri trashëgimtar te tjetri. Vetë babai i Hitlerit ishte martuar me mbesën e xhaxhait të tij, me Klara Pölzl. Ndoshta, si një shenjë mallkimi, Hitleri lindi si fëmijë i shëmtuar dhe i dobët sikur të kishte dalë nga varri. Mbi të gjithë ishte një dështak i lindur. Edhe kur deshi të shkonte ushtar nuk e pranuan, sepse ishte aq i dobët sa nuk mund të mbante dot as armën. Në këtë kohë nuk dinte as si t'i krihte flokët dhe as si t'i mbante mustaqet; lënia e mjekrës e bënte edhe më të shëmtuar. Sa herë që ndërronte modelin e flokëve, aq më në pah delte shëmtia e tij. Kur i ati i tij, Alois Shikelgruber (Hitleri), doli në pension, familja e tij në vitin 1898 u shpërngul në fshatin Leoding, afër Linzit të Austrisë, por që nga ajo ditë e më pas, familja Hitler vetëm do të shpërngulej kohë pas kohe në fshatrat pranë Linz-it dhe gjithnjë do të kishte sherr. Babai i tyre ishte i padurueshëm, por jo më pak i padurueshëm ishte dhe Adolf Hitleri. Në këto rrethana njeri prej vëllezërve të tij, Aliosi i Ri u largua nga shtëpia kur ishte 14 vjeç dhe kjo gjë detyroi një shpërngulje tjetër të familjes. Më pas vdiq vëllai i vogël i Hitlerit, Edmundi, duke zbrazur kështu një tronditje të radhës në atë familje. Kur Adolf Hitler ishte 11 vjeç, i ati deshi ta çonte në një shkollë teknike, por ai nuk dëshironte, sepse gjithnjë kishte pasur fiksimin se kishte lindur për pikturë. Ky konflikt do të merrte fund vetëm me vdekjen e të atit, më 3 janar të vitit 1903. Hitleri, më shumë u gëzua për vdekjen e të atit sesa u pikëllua. Për sa kohë që i ati ishte gjallë, prania e njëri-tjetrit u kujtonte martesat perverse; ishin shëmbëlltyra morale të njeri-tjetrit. Por nuk ishte vetëm kjo: Hitleri u gëzohej parave që kishte lënë pas i ati. Ai braktisi shkollën e mesme dhe i shkapërderdhi paratë rrugëve të Linzit, së paku deri në vitin 1907. Një vit më vonë vdiq edhe nëna e tij Klara Pölzl, e dëshpëruar, veçanërisht për Adolfin që nuk mundi dot ta kthente në rrugën e Zotit.

Adolf Hitleri gjithnjë kishte menduar se kishte qenë një talent i veçantë në pikturë. Pas vdekjes së të atit, ai e braktisi shkollën e mesme për të studiuar në Institutin e Arteve të Bukura. U paraqit dy herë atje, por edhe në paraqitjen e parë, edhe në të dytën rezultoi i paaftë. Depresioni nervor nuk po i ndahej. Dëshironte me çdo kusht që të tregonte se ai ishte dikushi, por përkundër kësaj po vërtetonte se ishte një dështak i lindur. Duke mos gjetur asnjë mundësi tjetër u nis për në Vjenë, ku qëndroi nga viti 1908 deri në vitin 1913, për t'u ndalur më pas në Mynih. Në këtë qytet nisi të bridhte rrugëve i vetëm dhe i dëshpëruar. Nuk kishte aftësinë të shoqërohej me njerëz të tjerë. Gjithnjë gjendej nën një depresion të thellë nervor. Kjo sëmundje do ta ndiqte gjithë jetën. Nisi të pikturonte, duke menduar se do të nxirrte të ardhura, por gjithçka e krijuar nga dora e tij ishte e pavlerë, e rëndomtë, pa asnjë aftësi shprehëse. Në këtë kohë shpërtheu Lufta e Parë Botërore. I vemi shpëtim i tij ishte të shkonte në luftë. Kjo do ta shpëtonte nga vetmia, dëshpërimi dhe depresioni, por, në të vërtetë, ai nuk u shërua asnjëherë. U afrua si vullnetar në ushtrinë gjermane të këmbësorisë. Në tetor të vitit 1916 u plagos, ndërsa më 1918 u dëmtua nga gazrat kimike. Fal plagosjeve ai u dekorua dy herë me Kryqin e Hekurt. Nëse nuk do të ishte plagosur, ndoshta edhe lufta do ta kishte evidentuar si dështak. Plagosjet i hapën rrugën drejt politikës, drejt masakrës më të madhe njerëzore.

Në vitin 1919, ai ishte bërë pjesë e Partisë Punëtore Gjermane, e cila më pas do të riemërohej, si Partia Nacional Socialiste e Punëtorëve Gjermanë (NSDAP), e njohur ndryshe si Partia Naziste. Pas këtij çasti ai gjithnjë kishte dashur ta merrte pushtetin me dhunë, veçanërisht kur në vitin 1921 u zgjodh si president i kësaj partie me fuqi të pakufizuara. Truri i tij punonte vetëm në kufijtë e çmendurisë. Për të realizuar ardhjen në pushtet mblodhi rreth vetes njerëz si: Alfred Rozenberg, Herman Goering, Rudolf Hes dhe Julius Shtraiher. Bashkë me Erih Ludendof, në vitin 1923, bënë të pamundurën për hedhjen e popullit në revolucion dhe për rrëzimin e qeverisë përmes puçit, por të gjitha intrigat u mbetën në dorë. Adolf Hitleri u dënua me 9 muaj burg, por falë amnistisë, ai bëri vetëm 5 muaj. Gjatë kësaj kohe ai shkroi çmendurinë e tij që njihet me emrin "Mein Kampf" (Beteja ime). Më pas do të vinte lufta për spastrimin e bashkëpunëtorëve të tij... dhe "Nata e thikave të gjata". Një njëri i sëmurë nuk mund të bënte dot ndryshe…



Martesa me vetëvrasje

Pas gjithë krimeve të bëra, luftërave të përgjakshme e mizore me miliona viktima të pafajshme, Adolf Hitleri kishte vendosur të vetëvr-

itej, por në të njëjtën kohë kishte vendosur edhe të martohej. Dasma u caktua më 29 prill 1945, ndërsa vetëvrasja do të ndodhte një ditë më pas, më 30 prill. Gjendja në Kancelari ishte e rënduar dhe alarmante. Askush nuk e kishte jetën të sigurt. Vendimi i Hitlerit: edhe të martohej, edhe të vetëvritej, dukej absurd. Vendime të tilla dinte të merrte vetëm ai. Të tjerët nuk thoshin dot as "po", as "jo". Bashkë me të do të vetëvritej edhe nusja e tij, Eva Braun. Hitleri ishte 56 vjeç, ndërsa Eva vetëm 33 vjeç. Pas martesës që të dy do të shkonin në varr. (Por a do të kishte varr për ta vallë?) Dy ditë më parë, Adolf Hitleri kishte vrarë qenin e tij, Blondin. Ai nuk kishte pasur fëmijë dhe qeni i dukej si pjella e vet. Nuk dëshironte ta linte gjallë, kur vetë ai Furheri do të vdiste. Nuk kishte asnjë dëshirë të linte gjallë as Eva Braunin. Për Hitlerin të gjithë njerëzit kishin vlerën e një qeni. Gjatë luftës së tij, ai zhduku nga planeti 14 milionë njerëz. Eva Braun do të ishte një prej tyre. Vetëvrasja ishte përgatitur deri në detajet më të imta, që askush prej tyre të mos mbetej gjallë. E para do të pinte pilulën e cianidit Eva Braun. (Hitlerit i duhej të bindej për këtë). Pas saj, të njëjtën gjë do të bënte edhe ai (për të treguar besnikërinë e tij!), por Fyhreri për të pasur një vdekje të sigurt, pasi të pinte pilulën e cianidit, do ta qëllonte veten edhe me pistoletë. Fill pas aktit të vetëvrasjes, trupat e tyre do të spërkateshin me benzinë dhe do t'u vihej zjarri. Asgjë nuk duhej të mbetej nga eshtrat e tyre. (Për herë të parë Hitleri merrte vendimin që meritonte). Në këtë atmosferë të rënduar po bëhej gati fillimi i dasmës. Gjeneralët dhe oficerët e tij nuk dinin si të silleshin: të qanin apo të këndonin, apo duhej t'i bënin të dyja njëherësh. Çuditërisht, Furheri përpiqej të bënte ndonjë shaka, por nuk përhapte dot humor. Vdekja në çdo çast rrinte varur mbi kokën e dasmorëve me uniformë, të lodhur nga lufta deri në kapitullim të plotë. Edhe ata do të kishin të njëjtin fat. Dukej sikur qanin për Hitlerin, por në të vërtetë qanin fatin e tyre. Eva Braun përpiqej të ishte e gëzuar, por trishtimi nuk i shqitej nga sytë…Kishte mbërritur çasti i celebrimit. Hitleri mori lapsin dhe firmosi martesën e vet. Të njëjtën gjë bëri dhe Eva Braun. Pastaj firmosi edhe Wagneri. Dy dëshmitarët e martesës së tyre, Gebels dhe Borman që kishin ardhur në kohën e duhur, u përkulën disi për të firmosur edhe ata. Nuk kuptohej qartë: firmosnin vdekjen apo jetën. Atë ditë, Eva Braun kishte veshur një fustan mëndafshi ngjyrë blu (e vetmja gjë që binte në sy në gjithë pamjen e saj), por ajo kishte harruar se çfarë kishte veshur, madje kishte harruar të shkonte edhe para pasqyrës. As Hitleri nuk e kishte vënë re se çfarë kishte veshur ajo. Ceremonia e celebrimit qe mjaft e shkurtër. Nuk ishte e nevojshme që çifti të pyetej nëse do t'i qëndronin njëri-tjetrit besnik deri në vdekje. Ata do të jetonin bashkë vetëm një natë. Pas firmosjes së aktit të martesës, ata shkuan drejt sallës ku do të vallëzonin. Hitleri iu afrua Eva Braunit dhe i tha: "Më mirë kështu, të paktën unë nuk do të kem fatin e Musolinit dhe ti nuk do të kesh fatin e Klareta Petacit (bashkëshortes së Musolinit). Sa të na djegin të tjerët, do të digjemi vetë". Me këtë shprehje Hitleri përpiqej ta bënte të lumtur nusen e tij, por ajo nuk mundi as të vinte buzën në gaz. Kërkoi të vihej muzikë në gramafon, por dikush tha se kishte mbetur vetëm një pllakë: "Trëndafilat e kuq". Deshën të vallëzonin, por nuk mundeshin. Edhe të tjerët nuk dinin si të silleshin. Si për të bërë situatën më paqësore, doktori i Hitlerit u afrua drejt çiftit dhe u tha:





“Kjo lloj vdekje është mjaft e ëmbël, mos u shqetësoni, nuk do të ndieni asnjë lloj dhimbjeje…”. “Gjithçka do të ndodhë shumë shpejt”. Eva e vështroi me sy të zgurdulluar: “Nuk do të kem spazma?”- pyeti. “Jo - tha doktori, - do të mbeteni si një vajzë e bukur, që sapo e ka zënë gjumi”. Fjalët e doktorit edhe pse mund të ishin gënjeshtra, u duk sikur e qetësuan disi. Të paktën të mos vuante edhe në çastet e fundit të jetës, sepse për të rrugë tjetër nuk kishte mbetur…. Bëhej dasmë, por në të vërtetë flitej për vdekjen… Pikërisht në këtë çast, Eva Braunit iu kujtua jeta e saj. Eva Anna Paula Braun kishte lindur më 6 shkurt 1912, në Munih të Gjermanisë. Për sa kohë ishte rritur në familjen e saj kishte qenë një vajzë e lumtur... Me Hitlerin ishte njohur në tetor të vitit 1929, kur ishte vetëm 17 vjeçe dhe kur ende nuk kishte një njohje të mirë për njerëzit. (Eva Braun njihej si një vajzë naive). Atëherë Hitleri ishte 40 vjeç. Deri në atë kohë Eva Braun kishte punuar si asistente e Heinrich Hoffmann, fotografit të Hitlerit. Prindërit e Evës nuk e deshën kurrë këtë martesë, por Eva mendonte se kishte kapur zenitin e lumturisë. Që nga dita e njohjes, ajo u përpoq t’i dhuronte dashuri Adolfit të saj, por ai në shpirtin e tij se ç’kishte diçka shkatërrimtare të ngjashme me vdekjen. Madje gjithnjë fliste për varre, djegie kufomash dhe vdekje të çuditshme. Sjellja e tij e kishte detyruar Eva Braun të shkonte drejt vetëvrasjes. Herën e parë, tre vjet pas njohjes, ajo kishte marrë pistoletën dhe kishte dashur t’i jepte fund jetës. Pistoleta i dridhej në dorë. Duhej të qëllonte në kokë, apo diku tjetër? “Në kokë?”- pyeti veten. Jo, këtë nuk e kishte dashur. Hitleri i kishte treguar se plumbi e hap kafkën e kokës dhe e bën njeriun të shëmtuar. Ai i tregonte gjithnjë se ç’ndodhte me njeriun pas vrasjes. “Rrjedh shumë gjak”- i kishte thënë ai. Braun nuk dëshironte që njerëzit ta shihnin me kafkë të çarë e të mbuluar në gjak. Vendosi ta shkrehë pistoletën drejt e në grykë. Ngaqë dora i dridhej, plumbi i përshkoi vetëm anën e qafës. Eva Braun mundi t’i shpëtonte vdekjes. Megjithatë Hitleri nuk hoqi dot dorë nga brutaliteti i tij. Tre vjet më pas, në vitin 1935, Eva Braun, tentoi të vetëvritej sërish. Meqenëse ajo nuk ishte e zonja të përdorte pistoletën, dhe ngaqë dëshironte një vdekje të sigurt dhe pa u shëmtuar, vendosi të përdorte pirjen e një mbidoze ilaçesh, por edhe kësaj radhe e ndihmoi fati: Eva Braun mbeti gjallë. Vërtet Ana Braun mbeti gjallë, por asnjëherë nuk provoi lumturinë, ashtu siç do të dëshironte ajo. Adolf Hitleri, asnjëherë nuk e bëri publike lidhjen e tij me Eva Braun, aq të dëshiruar prej saj. Askush nuk e dinte që Eva Braun ishte e dashura e Hitlerit; askush nuk e dinte që ajo rrinte gjithnjë e mbyllur në dhomën e saj; askush nuk e dinte që Hitleri çmendej nga dëshpërimi kur Eva Braun përpiqej të bëhej e bukur; askush nuk e dinte që Eva gjithnjë i kishte kërkuar që të kishin një fëmijë dhe që ai nuk ia fali dot kurrë këtë kënaqësi. Adolf Hitleri gjithnjë kishte pasur një lloj frike të pashpjegueshme nga gratë... Tashmë Evës i duhej të shkonte drejt vetëvrasjes ditën e parë të martesës! Eva Braun e dinte që Hitleri kishte pasur njohje edhe me gra të tjera, por kurrë nuk kishte besuar se edhe ajo vetë do të kishte fatin e tyre. Një nga të dashurat e Hitlerit kishte qenë vajza e motrës së tij, Gela Raubali. Kishte qenë një marrëdhënie incesti, madje e turpshme. Lidhjet e tij me Gelën përfunduan me vetëvrasjen e saj, kur ajo ishte 23 vjeç. Askush nuk e di se çfarë e detyroi atë vajzë të vetëvritej. Në vitin 1927, ai u njoh me Unity Mitford. Si të gjithave, edhe asaj, Hitleri i solli mjaft dëshpërime dhe makthe. Tentoi të vriste veten, por fatmirësisht mundi të jetonte. Më pas, në vitin 1930, Hitleri u njoh me aktoren Renate Muller, por edhe ajo u gjet e vetëvrarë. Edhe lidhjet e tij me Maria Roiterin dhe me Ema Hanfstaengl rezultuan të dështuara. Njohjet me Hitlerin përfundonin tragjikisht...

Adolf Hitler, i mbetur në sallonin ku po bëhej dasma e tij, edhe pse nuk pinte alkool kishte marrë një gotë verë “Takai” dhe qëndronte ulur duke vështruar nga Eva Braun, por në të vërtetë nuk e kishte mendjen tek ajo. “Shkojmë!”, - i tha Eva. Dasma ishte mbërthyer nga velloja e zezë e vdekjes dhe heshtja e dasmorëve me uniformë, por Hitleri ose nuk e dëgjoi, ose nuk deshi të ngrihej. Gurgullima e kujtimeve ziente në kokën e tij.

Hitlerit i kishte mbetur gota e verës në dorë. “Shkojmë!”, - i tha Eva Braun, por kësaj radhe e kishte fjalën për të shkuar te bunkeri i zyrës atje ku do t’i jepnin fund jetës së tyre. Hitleri u çua. Në fytyrë kishte një buzëqeshje ironike. U drejtua nga Eva dhe i tha: “E keni menduar ndonjëherë pse lashë si trashëgimtarë të mi, Gebelsin dhe admiralin Denitz?”... “Jo!”, - u përgjigj, Eva Braun. Është fare e thjeshtë: -Dëshiroj që edhe ata të dy të kenë fatin e Musolinit dhe të Klareta Petacit”. Buzëqeshja ironike e Hitlerit u shndërrua në një qeshje të çmendur. Dhe vërtet ashtu do të ndodhte. Edhe Gebelsi dhe fëmijët e tij do të digjeshin në atë bunker. Çifti i sapomartuar kishte mbërritur te bunkeri. E para e piu helmin Eva Braun. Kishte menduar se nuk do të kishte dhimbje dhe se vdekja do të kishte qenë e ëmbël, por befas filloi të përpëlitej, ra përdhe dhe gjunjët i mblodhi pas gjoksit të saj. Deshi t’i thoshte Hitlerit: “Më ke gënjyer!”, por ai, atë çast, kishte hedhur trutë të erë. Një çmenduri e tillë, e lindur në vitin 1889, mundi të merrte fund vetëm më 30 prill të vitit 1945, pas 56 vjetësh... ■



Martesa dhe divorci nga këndvështrimi psikologjik

Neuropsikiatri Ferid Agani, duke folur për martesën dhe divorcin, ndër të tjerash ka cekur edhe shkaktarët kryesorë që e prishin një martesë. “’Zakonisht janë nevoja neurotike, nevoja këto të cilat kanë bazë në konfliktet psikologjike që nga fëmijëria e hershme dhe burojnë nga marrëdhëniet e pazgjidhura emocionale me prindërit, në radhë të parë me nënën ose me babanë….



Bujar ISMA

Neuropsikiatri Ferid Agani, duke folur për martesën dhe divorcin, në përgjithësi, ka theksuar edhe shkaqet kryesore se përse ndodhin ato. Gjatë përshkrimit të historikut të martesës dhe domethënies së saj, ai theksoi se njeriu e ka të nevojshme që të martohet pasi që ai i plotëson nevojat biologjike dhe psikologjike të tij .”Si në aspektin biologjik, ashtu edhe në aspektin psikologjik, mashkulli dhe femra kanë veçori dhe nevoja të veçanta psikologjike, emocionale dhe njohëse, të cilat kur ata mësohen dhe bashkohen në një marrëdhënie të ligjshme martese të pranueshme në mënyrë sociale, ata edhe e realizojnë plotësinë e tyre psikologjike”, - ka thënë Ferid Agani.

Sipas psikologut Agani, mashkulli dhe femra kanë nevojat e veçanta psikologjike dhe emocionale, prandaj siç tha ai, martesa në kushtet e mira psikologjike, fiziologjike dhe biologjike tregon një ambient të realizimit të plotësisë psikologjike dhe biologjike të mashkullit dhe femrës. Ndërkaq mosha që është më e mirë për martesë varet nga kushtet dhe rrethanat e një vendi, ndërsa mosha që është me e përshtatshme për vendin tonë është prej moshës 18 vjeçare.

Shikuar nga aspekti biologjik, martesa është e mundshme që kur mashkulli dhe femra arrijnë moshën e pubertetit, por në aspektin psikologjik, sipas këtij psikiatri, individët në këtë moshë nuk arrijnë pjekurinë e duhur emocionale dhe psikologjike, sidomos në rrethanat e vendit tonë.

“Edhe pse në aspektin biologjik, martesa është e mundshme kur mashkulli dhe femra arrijnë moshën e pubertetit, mendoj se pjekuria emocionale dhe psikologjike e të rinjve në atë moshë, është shumë e mangët dhe e ulët dhe nuk rezulton në plotësinë psikologjike dhe biologjike, të cilën ata duhet ta realizojnë, veçanërisht në kushtet dhe rrethanat e vendit tonë”, - ka shtuar ai.

Në anën tjetër, marrëdhëniet bashkëshortore që të jenë sa më të mira, duhet të ruhen duke pasur sinqeritet në marrëdhënie, respekt për njëri-tjetrin, gatishmëri për sakrificë, përkushtim për nevojat e partnerit, si dhe përpjekje për një jetë sa më të lumtur. Nëse partnerët mendojnë në këtë mënyrë, atëherë do të kenë një lidhje të fortë kolektive. Ndërkaq, sipas doktor Aganit, shkaqet që e prishin një martesë vijnë nga problemet e individit që burojnë nga fëmijëria e hershme. “Zakonisht janë nevoja neurotike, nevoja këto të cilat kanë bazë konfliktet psikologjike nga fëmijëria e hershme që burojnë nga marrëdhëniet e pazgjidhura emocionale me prindërit, në radhë të parë me nënën ose me babanë. Kur një individ i tillë martohet, kjo martesë ka një kohëzgjatje të shkurtër të kënaqësive personale dhe shumë shpejt manifestohet dëshpërimi i njërit partner, pastaj edhe i tjetrit, atëherë shkurorëzimi, në ato raste, është një pasojë shumë normale”, - ka theksuar Agani


Dr. Ferid Agani

Megjithatë divorci sjellë dëme të mëdha në familje dhe në rrethanat e jetesës, e sidomos tek fëmijët, sepse në këtë rast krijohen vështirësitë e mëdha në zhvillimin psikologjik të fëmijëve. “Janë pasoja të rënda edhe te fëmijët. Pra nëse fëmijët janë anëtarë të familjes, atëherë këtu krijohen vështirësitë e mëdha në procesin e zhvillimit psikologjik. Kjo varet edhe nga mënyra se si ndodh shkurorëzimi. Pastaj pasojat mund të jenë edhe në rrafshin familjar më të gjerë, e edhe në rrafshin individual. Ka variacione të ndryshme që mund të reflektohen gjatë aktit të shkurorëzimit”, - ka thënë neuropsikiatri Agani. ■



Flet për revistën 'Paqja' ish-Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Valton Beqiri

Vendimi për largim - politik

Intervistoi: Muhamet JAHIRI



Është njeriu i cili ka udhëhequr Ministrinë e Kulturës për më shumë se tri vite. Tregon se cilat kanë qenë projektet e tij, sa ka arritur t'i konkretizojë, si dhe sa ka bërë që ta përmirësojë gjendjen e përgjithshme të këtij sektori. Ai tregon se ka bërë investime të shumta për ta ngritur lart imazhin e kulturës, pavarësisht buxhetit të vogël që e ka pasur.

Sipas tij, vendimi për ta larguar nga posti i ministrit ka qenë politik, ndërsa thotë se nuk ka qenë në dijeni për një gjë të tillë, derisa e ka informuar partia se s'do të jetë më ministër. Deklaron se nuk ka ditur asgjë për riformatizimin dhe se nuk do të largohej asnjëherë nga të qenit ministër i kulturës. Sipas tij, pavarësisht kësaj, ai do të vazhdojë të mbetet i njëjtë brenda partisë së tij dhe nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër. Është i kënaqur që ka shërbyer për qytetarët e Kosovës si ministër për këtë kohë, ndërkaq, thotë se një gjë të tillë do ta bëjë edhe në të ardhmen, pavarësisht pozitës se ku do të jetë.

Për më shumë flet për revistën "Paqja", ish-Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Valton Beqiri

PAQJA: ***Z. Beqiri, ju deri para pak ditësh keni qenë Ministër i Kulturës. A mund të na thoni se çka keni arritur të realizoni nga projektet tuaja brenda kësaj kohe?***

BEQIRI: Viti i parë i mandatit tim ka qenë vit i mbijetesës së MKRS, gjegjësisht vit i konsolidimit të punës, bazuar në disa probleme të trashëguara si: borxhet, grevën e ansamblit "Shota", vonesën e pagave në institucionet e kulturës deri në 6 muaj, etj. Megjithatë, edhe me këto probleme, kemi arritur që të vazhdojmë përkrahjen e të gjitha aktiviteteve më të rëndësishme kulturore, si dhe të përmirësojmë kushtet e punës në institucionet tona kulturore. Realisht, viti 2009 ka qenë vit i fillimit të realizimit të planeve dhe politikave të parapara. Në fushën e kulturës, për herë të parë, është instaluar konkursi për projekte, është investuar në renovimin e objekteve të teatrit, galerisë dhe ansamblit "Shota" , ka filluar ndërtimi i teatrit të "Operës dhe Baletit", për herë të parë është ndarë buxhet për kinematografinë, institucionet e kulturës e kanë pasur të siguruar buxhetin vjetor për projekte, është zgjeruar gama e çmimeve dhe shpërblimeve në fushën e teatrit, letërsisë dhe muzikës, është rritur përkrahja e veprimtarisë botuese, fusha e trashëgimisë kulturore është përkrahur me investime kapitale, është përmirësuar infrastruktura ligjore, është themeluar forumi i trashëgimisë kulturore si dhe është funksionalizuar këshilli për TK, etj. Në fushën e rinisë është aprovuar ligji për fuqizimin e rinisë, është aprovuar plani i veprimit për rini, janë vazhduar projektet dhe përkrahja e qendrave rinore si dhe OJQ-ve në tërë Kosovën, janë siguruar fonde dhe është vazhduar bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, etj. Së fundi, në fushën e sportit, ka filluar ndërtimi i 6 palestrave të reja sportive, si dhe vazhdimi i punëve në palestrat e tjera në ndërtim. Për herë të parë është ndarë buxhet i veçantë për ndërkombëtarizimin e sportit, me ç'rast kemi pasur edhe anëtarësimin e 3 federatave në federatat ndërkombëtare, kemi vazhduar përkrahjen e federatave, kemi arritur që të përkrahim sportin elitar, etj.

Pra, në përgjithësi, edhe pse me buxhet të vogël, është punuar në përmirësimin e infrastrukturës, në menaxhimin më të mirë të mjeteve, përmirësimin e infrastrukturës ligjore si dhe sigurimin e mjeteve shtesë nga donatorët.

PAQJA: ***Atëherë, a mund të na tregoni se çka ju ka mbetur pa realizuar brenda projekteve tuaja?***

BEQIRI: Të gjitha këto që u përmendën më sipër janë procese në vazhdimësi, por disa prej tyre duhet të përfundojnë gjatë këtij viti. Ndoshta duhet theksuar se me gjithë angazhimet për të siguruar buxhet të mjaftueshëm për institucionet e kulturës, ende nuk është rregulluar statusi i punonjësve të këtyre institucioneve. Në bazë të rekomandimeve të MKRS është arritur që, në kuadër të ligjit për shërbyesit civilë, punonjësit e institucioneve të kulturës të mos llogariten si shërbyes civilë dhe, njëherësh, kjo jep mundësi që statusi i tyre të rregullohet njëherë e përgjithmonë.

PAQJA: ***Buxheti i ministrisë, të cilën e keni udhëhequr ka qenë mjaft i kufizuar, ndërsa kërkesat kanë qenë shumë më të mëdha. A mund të na thoni si keni arritur t'i tejkaloni sfidat?***



BEQIRI: Me shpalljen e konkurseve, me seleksionimin profesional të projekteve dhe me monitorimin e drejtpërdrejtë. Është jashtëzakonisht inkurajues fakti se për dallim nga viti 2009, ku kërkesa kapte shumën prej rreth 7 mil. euro, në konkursin e vitit 2010, kjo shumë ishte 2 mil. më e vogël (pra, rreth 5 mil. euro), e në anën tjetër, numri i projekteve ishte më i madh. Kjo dëshmon në besimin e përzgjedhjes nga MKRS, si dhe në ekonomizimin e kërkesave dhe afrimin e tyre shpenzimeve reale. Në asnjë mënyrë nuk janë dëmtuar projektet me rëndësi shtetërore, projektet të cilat kanë stimuluar krijimtarinë dhe ato të cilat kanë promovuar vlerat artistike.

PAQJA: ***Këtë vit Ministria e Kulturës ka pasur një buxhet edhe më të vogël. Sa e ka penguar kjo suksesin e saj?***

BEQIRI: Padyshim se mungesa e buxhetit të mjaftueshëm ka rezultuar zvogëlimin e përkrahjes së nevojshme të shumë projekteve, e sidomos zvogëlimi i buxhetit për vitin 2010 do të jetë pengesë e realizimit të objektivave të parapara.

PAQJA: ***Sa është e vështirë të jesh Ministër i Kulturës?***

BEQIRI: Besoj se përgjigjet e deritashme pasqyrojnë qartë vështirësitë e udhëheqjes së një ministrie me probleme të trashëguara dhe me buxhet të limituar. Megjithatë, të arriturat dhe rezultatet pozitive, japin motiv shtesë në punë dhe ndikojnë në qetësinë shpirtërore të çdo të punësuari në MKRS.

PAQJA: ***Z. Beqiri, ditë më parë ka ndodhur edhe i ashtuquajturi riformatizim i qeverisë dhe nga ju është kërkuar që ta lini postin e Ministrit të Kulturës. Si e keni pritur këtë lajm?***

BEQIRI: Jo, nuk kam pas kërkesë për t'u larguar ose për të dhënë dorëheqje, gjë që nuk do ta kisha bërë. Mua më është kumtuar vendimi, me keqardhjen më të madhe, nga strukturat partiake, për ndërprerjen e mandatit tim si ministër.

PAQJA: ***Këtë vendim të marrë nga qeveria e vlerësoni si vendim politik, apo si ndonjë vendim tjetër?***

BEQIRI: Unë kam deklaruar se vendimi ishte politik dhe duke e marrë parasysh postin e ministrit si post politik, është e kuptueshme se partnerët e koalicionit, secili për ministrat e vet, kanë të drejtën e lëvizjeve ose nderimit të "personelit" politik .

PAQJA: ***Z. Beqiri, cili do të jetë pozicioni juaj tash në LDK?***

BEQIRI: I njëjtë sikurse para emërimit tim. Duhet theksuar se rezultatet e punës, para së gjithash, u dedikohen qytetarëve të Kosovës. Në anën tjetër, suksesi i ministrit i bën nder qeverisë dhe partisë.

PAQJA: ***Nëse kërkohet nga ju që të jeni prapë në Qeveri, në ndonjë pozitë tjetër, për të dhënë kontributin tuaj, a do ta pranoni këtë ofertë?***

BEQIRI: Unë nuk e konsideroj veten të aftë për ndonjë funksion ose pozitë tjetër, meqë edhe vetë jeta ime dhe profesioni im lidhen ngushtë me artin dhe kulturën.

PAQJA: ***Për fund, z. Beqiri, a mund të na thoni se ku do të jetë një njeri i suksesshëm si ju, pas gjithë kësaj që ka ndodhur?***

BEQIRI: Unë do të vazhdoj ta jap kontributin tim në të mirë të artit dhe kulturës, pa marrë parasysh se në çfarë pozite do të jem. Jam i bindur se ky është obligim qytetar i secilit prej nesh. ■

Tetë shtete n...

Një nga festivalet e vetme në Kosovë, pjesëmarrës në rrjetin ndërkombëtar, Festivali i Monodramës "Monoakt", po bën përgatitjet për të vazhduar traditën me edicionin e dytë.

Prezantimi i kulturës sonë në një garë ndërkombëtare është më se i nevojshëm për zhvillimin e artit skenik në Kosovë. Gjithashtu, pjesëmarrja në arenën ndërkombëtare si dhe prezantimi i kulturës sonë para kulturave të tjera ka, pa dyshim, rëndësi të veçantë.

"Anëtarësimi në rrjetin ndërkombëtar i këtij festivali mes festivaleve të tjera në botë, ka rëndësi etike, pasi që është nivelizuar edhe me festivalet më të mëdha të monodramave në botë. Vetë fakti i pjesëmarrjes së tri kontinenteve në Kosovë, njohja e tyre me artin skenik dhe me vetë Kosovën, është një nga vlerat me të veçanta", - shprehet Mentor Zymberaj, themelues dhe drejtues i festivalit.

Për t'u prezantuar mirë, gjithashtu edhe për të pritur mysafirë nga vendet e ndryshme, duhet kujdes i veçantë, që kushton. Sado që ky festival është i mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe Komuna e Pejës, stafi udhëheqës i festivalit, sipas Zymberajt, është duke bërë të pamundurën që të mundësojë jetësimin e këtij festivali.

"Ardhja e shumë shteteve, madje edhe e atyre që nuk e kanë pranuar Kosovën, në një konkurrencë shumë të madhe, kërkon hapësirë dhe mundësi të bashkëpunimit me të gjitha institucionet dhe kompanitë, të cilat e mundësojnë realizimin e këtij festivali", - u shpreh Zymberaj.

Ky festival ka për qëllim trajtimin e një gjinie shumë të veçantë në artin skenik, siç është monodrama.

"Monodrama te ne nuk është dhe aq shumë e favorizuar në raport me vendet e tjera të botës. Bashkëpunimi me skena të ndryshme ndërkombëtare, si gjithmonë, sjell vlerë, risi, koncept. Kjo traditë duhet të ruhet me fanatizëm për shkak të interesit të vlerave të artit dhe kulturës, të cilat kanë nevojë për t'u dëshmuar", - theksoi Zymberaj.

Në Festivalin Ndërkombëtar të Monodramës "Monoakt", këtë vit marrin pjesë nëntë



ë "Monoakt"

shfaqje nga tetë shtete të ndryshme të botës: Australia, Polonia, Gjermania, Zvicra, Maqedonia, Ukraina, Shqipëria dhe dy shfaqje të Kosovës: monodrama e Selman Lokës dhe shfaqja mysafire "Një përkujtim në kafe teatër" e Haqif Mulliqit.

Përveç pjesëmarrësve të shteteve, do të jenë mysafirë edhe drejtorët e festivaleve të ndryshme nga vendet e ndryshme të botës. Po ashtu, në këtë festival do të marrin pjesë edhe anëtarë nga asociacioni ndërkombëtar i monodramave.

E reja në këtë edicion është edhe minifestivali i "Monoperformancave" për aktorë të rinj, gjegjësisht studentë të artit dramatik në fakultetin e arteve në Prishtinë.

Këtë vit qendrat që do të kenë rastin të marrin pjesë drejtpërdrejt në festival. Në kuadër të këtij festivali do të vizitohen Peja, që njëherësh është qytet nikoqir, Prizreni, Istogu si dhe qendra të tjera të vogla.

Juria profesionale përbëhet nga tre anëtarë jurie nga: Ukraina, Belgjika dhe Kosova.

Ky festival, përveç karakterit garues, ka edhe karakterin e vizitës së vendit nikoqir të monumenteve historike, kulturore të trashëgimisë, etj.

Festivali do të ketë këto çmime: shfaqja më e mirë, aktori më i mirë, aktorja më e mirë dhe çmimi special. Këto çmime do të ndahen nga juria profesionale, nga festivali i Monodramës "Monoakt". Gjithashtu do të jetë edhe çmimi i gazetarëve dhe monostripi më i mirë, i cili ndahet nga juria profesionale dhe përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Prishtinës. ■

(Përgatitur nga F. Maloku)


Mentor Zymberaj



Filmi shqiptar në Festivalin e Kanës

Një botë e tërë shqiptare në Kanë. Lufta, diktatura, vitet e vështira të tranzicionit, emigracioni, gjakmarrja... Të gjitha përmes filmit. Përgjatë 10 ditëve (12-23 maj), në një prej aktiviteteve më të mëdha të filmit në botë, në Festivalin e Kanës, do të jetë e pranishme edhe kinematografia shqiptare me prodhimet e saj të fundit. Sipas kryetarit të QKK-së, Artan Minarolli, prej kohësh ishte marrë ftesa nga CEE dhe, pas miratimit të projektit dhe fondit në mbledhjen e bordit, u konfirmua pjesëmarrja në këtë pavijon.

Për të marrë pjesë në të, QKK-së i duhet të paguajë një shumë prej 4 milionë lekësh të reja, që sipas Minarollit është fare e vogël, krahasuar me përfitimet që kinematografia shqiptare do të ketë nga kjo pjesëmarrje. Nëse Shqipëria do të merrte pjesë e vetme në këtë festival, atëherë do të duhej të paguante rreth 70% më shumë, por duket se nuk është thjesht çështje parash.

"Ndër të tjera është edhe një veprim politik, pasi në këtë pavijon do të marrin pjesë të gjitha vendet e Ballkanit...", thotë Minarolli. Sipas tij, Shqipëria do të ketë në dispozicion një hapësirë prej rreth 20 metrash katrorë... Atje do të bëhet një ekspoze e prodhimtarisë së kinematografisë shqiptare prej vitit 1997, por më së shumti do t'i jepet rëndësi krijimtarisë së dy viteve të fundit, duke qenë se kjo është edhe pasqyra e asaj çka ndodh në kinematografinë shqiptare aktualisht. Nëpër ekrane të mëdhenj do të shfaqen 24 orë trailerat e filmave shqiptarë. Do të ketë një të tillë të përgjithshëm, por do të realizohet edhe një promocional për Qendrën Kombëtare Kinematografike, si financuesi dhe mbështetësi kryesor i filmit në Shqipëri. Një kënd i pavijonit do të shërbejë si videotekë, ku çdo i interesuar mund të shohë filmat shqiptarë në DVD. Së shpejti do të vendosen titujt e filmave që do të shfaqen, por edhe detaje të tjera, për një paraqitje sa më të plotë dhe dinjitoze. Gjithçka do të jetë gati brenda një kohe të shkurtër. I gjithë pavijoni ku përfshihen vendet e Evropës Juglindore do të jetë nën përkujdesjen e një kuratori kroat, por gjithsesi do të jetë edhe një koordinator shqiptar që do të merret me të gjitha punët. Gjatë ditëve të festivalit mendohet të organizohen aktivitete të përbashkëta me vendet e tjera pjesëmarrëse në këtë paraqitje. Do të jetë një rast i mirë, jo vetëm për promovim, por edhe për shkëmbim eksperiencash dhe lidhjesh mes kineastësh dhe producentësh. Pas një përpjekjeje që është bërë gjatë kohës kur QKK drejtohej nga Petrit Ruka, kjo është hera e parë që Shqipëria bën një paraqitje të këtyre përmasave në një aktivitet kaq të madh të filmit botëror. ■

Astma bronkiale - problematikë në rritje

Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI

Astma bronkiale është një sëmundje me predispozicion për inflamacion kronik të mushkërive. Rrugët e frymëmarrjes (bronket) ngushtohen.

Sipas vlerësimeve të OBSH, 300 milionë njerëz vuajnë nga astma dhe 255 000 njerëz kanë vdekur nga astma në vitin 2005. Mbi 80% e vdekjeve nga astma ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe mesatare.

Karakteristikë e astmës është i ashtuquajturi sulmi astmatik, që karakterizohet nga episode të gulçimit ose "urisë për ajër", gjatë të cilit qelizat e muskujve të lëmuar në bronke ngushtohen, rrugët e frymëmarrjes bëhet si të inflamuara dhe të ënjtura, ndërsa frymëmarrja bëhet e vështirë ngase rrugët e frymëmarrjes janë ngushtuar. Bronket janë rrugët e komunikimit nëpërmjet të cilave ajri hyn në mushkëri gjatë frymëmarrjes.

Ky sulm (atak) shpesh përshkruhet si ngushtim i gjoksit dhe paraqet shenjë ose sinjal që të merren menjëherë ilaçet e përshkruara nga mjeku.

Astma bronkiale, për nga natyra e prejardhjes, karakterizohet si një sëmundje me natyrë alergjike për rrugët e frymëmarrjes. Në pjesën më të madhe, gati 80% të rasteve, shkaqet përgjegjëse për shfaqjen e sëmundjes ndodhen në ajër dhe përcaktohen me anë të provave të alergjisë. Në një pjesë të vogël, gati 20 %, fillimi i sëmundjes "nuk ka shkaktarë" përgjegjës, gjegjësisht nuk dihen shkaktarët.

Në kuadër të simptomave ose shenjave të sëmundjes, pacienti shfaq në veçanti vështirësi në frymëmarrje që mund të jetë me zhurmë fishkëllyese. Mund të ketë kollë të thatë dhe të shpeshtë, ndjesi shtrëngimi në gjoks dhe në fyt. Në fillim mund të mos jenë të shfaqura të gjitha këto simptoma, por vetëm ndonjëra prej tyre. Simptomat astmatike mund të shfaqen në momentin kur pacienti bie në kontakt me substancën ndaj së cilës është alergjik dhe të vazhdon të përkeqësohet me ekspozimin e mëtutjeshëm në atë alergjen. Simptomat mund të shfaqen disa herë në një ditë ose javë tek individët e prekur nga astma, kurse për disa të tjerë bëhet më e keqe gjatë aktivitetit fizik ose gjatë natës.

Ndër shkaktarët alergjikë më të shpeshtë në ajër janë mikroorganizmat, që ndodhen në pluhurat e shtëpisë dhe polenet e ndryshme. Por këto nuk janë të vetmet alergjenë astmatikë. Simptomat astmatike mund të shfaqen edhe gjatë ekspozimit ndaj substancave të ndryshme me prejardhje nga kafshët shtëpiake si p.sh nga: qentë, macet, kuajt, lepujt, etj. Në këto raste, simptomat astmatike përkeqësohen me rastin e kontaktit me këto kafshë, por edhe në rast mungese të kafshëve, ndodh që alergjeni të ndodhet në shtëpi dhe të shkaktojë simptoma astmatike. Gjithashtu, me rastin e kontaktit me myket e ambienteve të brendshme, por edhe të jashtme, shkohet deri te një përkeqësim i simptomave astmatike. Alergjenët e tjerë mund të



gjenden edhe në ilaçe dhe ushqim, në viruse të ndryshme që prekin, gjegjësisht atakojnë, rrugët e frymëmarrjes.

Në faktorët e jashtëm astmatikë bënë pjesë edhe cilësia e ajrit si: lagështia, presioni atmosferik, tymrat dhe ndotësit e ndryshëm, faktorë këta që zënë një peshë të rëndësishme në rëndimin e gjendjes shëndetësore të personave që kanë problem me astmën. Gjithashtu, stresi emocional mund të jetë një shkas për sulme të astmës. Manifestimet ekstreme si: e qeshura, lotimi, zemërimi, ose frika mund të shkaktojnë rritje të frekuencës së frymëmarrjes dhe fluksit të ajrit në mushkëri.

Duke iu referuar numrit në rritje të frekuencës së astmës, veçanërisht në vendet e industrializuara, konkludojmë seë kjo problematikë do na shoqërojë edhe për një kohë ndoshta të gjatë, ndonëse shkaku i kësaj rritje nuk është aktualisht i qartë. Në këtë rritje kanë qenë të implikuar faktorë të tillë si alergjenët, ndotësit e ndryshëm, kushtet e jetës, ushqimi, etj.

Një faktor që lidhet me rritjen e astmës është reduktimi i paraqitjes së sëmundjeve infektive (hepatitit A, fruthit, TBC, etj.). Në vendet e zhvilluara, si shkas i rritjes së rasteve me astmë, konsiderohet përmirësimi i stilit të jetës dhe vaksinimit.

Sipas kësaj teorie, një reduktim i disa sëmundjeve infektive gjatë fëmijërisë, çon në një stimulim të reduktuar të sistemit imun, që, si pasojë, shkakton më shumë gjasa për zhvillimin e reaksioneve alergjike, e madje edhe astmë.

Për sa i përket moshës, astma ka një frekuencë të konsiderueshme në fëmijëri dhe njëherësh është sëmundja më e shpeshtë kronike dhe shkasi kryesor i hospitalizimeve në fëmijëri. Me rritjen e moshës vërehet një lehtësim i simptomave në 20-30 % të rasteve, sidomos në kohën e pubertetit te meshkujt. Një kulm i dytë, me frekuencë të lartë të astmës bronkiale, është gjetur në moshën madhore.

Në aspektin gjinor ekziston një dallim mes gjinive. Meshkujt, në moshën e fëmijërisë, janë më shumë të prekur nga astma bronkiale në raport me femrat (2 meshkuj: 1 femër). Ndërsa në adoleshencë dhe në moshën e rritur nuk ka asnjë ndryshim mes gjinive.

Sa i përket faktorëve të mjedisit, përqindja më e lartë është në zonat e industrializuara urbane. Gjithashtu fëmijët, të cilët lindin nga prindër astmatikë, kanë mundësi dy herë më shumë të preken nga astma, në raport me fëmijët të cilët lindin nga prindërit jo-astmatikë.

Diagnostikimi i astmës bronkiale bëhet duke shfrytëzuar të dhënat historike të sulmeve astmatike, ekzaminimit të përçueshmërisë së ajrit në rrugët e frymëmarrjes, ekzaminimeve rëntgenologjike dhe testeve alergjike.

Trajtimi i astmës bronkiale bëhet në raport me gjendjen e përgjithshme të pacientit dhe sulmeve astmatike që ka, duke shfrytëzuar preparate farmaceutike të caktuara nga mjeku specialist, qofshin ato në formë të spërkatjes ose tabletave, preparate të cilat ndikojnë që të zvogëlohet reaksioni inflamator në rrugët e frymëmarrjes, si dhe të hapen ose të zgjerohen rrugët e frymëmarrjes. ■

Pas shënimit të golit bën sexhde



Alban BILALLI

Futbollisti i Interit dhe i Kombëtares së Ganës, Ali Sulley Muntari, pas shënimit të çdo goli, falënderon Allahun duke rënë në sexhde në fushën e lojës. Bashkëlojtarët e tij e presin deri kur të ngrihet nga sexhdja për ta përgëzuar për golin e shënuar. Por kur shënoi gol kundër Juventusit, që ishte një takim shumë i rëndësishëm për Interin, bashkëlojtarët nuk e pritën të ngrihet nga sexhdja duke u hedhur mbi të. Ai shënon rrallë gola, por golat e tij janë vendimtarë, sepse ai nuk është sulmues tipik. Ai e falënderon Allahun kur përfundon takimi, qoftë kur humbasin, qoftë kur fitojnë, sepse është100% i vetëdijshëm se si e mira, ashtu edhe keqja, janë krijuar nga Allahu.

Krerët e Bashkësisë Islame në Itali e kanë përshëndetur veprimin e Muntarit, duke shpresuar se të rinjtë do ta marrin atë si shembull. "Ne jemi të sigurt se shembulli i Muntarit do të jetë i rëndësishëm për mijëra të rinj muslimanë që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sportit në Itali,"- ka thënë kreu i Bashkësisë Islame në Itali, Dachan Mohamed Nour.

Muntari njihet si njeri që praktikon rregullat e fesë islame. Ai, pos që e fal namazin, po ashtu agjëron edhe Ramazanin. Madje agjërimi i Ramazanit të fundit shkaktoi një polemikë të madhe mes tij dhe trajnerit të tij, Hoze Murinjo, që u bart edhe jashtë fushës te komuniteti islam në Itali. Hoze Murinjo e kishte nxjerrë nga fusha e lojës Muntarin pas vetëm 30 minuta lojë, pasi kishte vërejtur shenja lodhjeje te Muntari, i cili ishte duke agjëruar edhe pse luante. "Muntari ka disa probleme në lidhje me Ramazanin, ndoshta në këtë temperaturë të lartë, nuk është e mirë për të që të agjërojë. Ramazani nuk ka ardhur në momentin ideal për një lojtar që të luajë një ndeshje futboll,"- ka shtuar Murinjo. Muntari, edhe pas këtij gjesti të trajnerit të tij nuk u largua nga qëllimi i tij, që ta agjëronte Ramazanin deri në fund. Në mbrojtje të Muntarit doli komuniteti musliman nga e tërë bota, e në veçanti ai në Itali, duke e përkrahur Muntarin. "Një lojtar që agjëron nuk mund të thuhet se është dobësuar, sepse ne e dimë nga Instituti i Mjekësisë Sportive se stabiliteti mendor dhe psikologjik mund t'i japë një sportisti një avantazh shtesë në fushë", - ka thënë udhëheqësi i muslimanëve në Itali, Dachan Mohamed Nour.

Karriera e Muntarit

Muntari është vetëm 25 vjeçar dhe ka arritur suksese të mëdha në karrierë. Ai, si 18 vjeçar, u transferua në kampionatin më të fortë në botë Serie A, te klubi i Udinezes, ku qëndroi plot 5 vite, ku luajti 125 ndeshje dhe shënoi 8 gola. Në vitin 2007, ai zgjodhi ofertën e Porsmuthit, para ofertave të klubeve si Juventus, Milan, Roma, Inter etj., duke treguar dashurinë e tij për futbollin anglez. Pas një viti qëndrimi në këtë klub, ku luajti 29 ndeshje dhe shënoi 4 gola, ai u kthye prapë në Itali, te klubi i Interit. Në Inter luan rolin e mesfushorit të majtë dhe të qendrës. Njihet për goditje shumë të forta dhe si i fuqishëm në duele me kundërshtarët. Vitin e kaluar, ai u shpall kampion i Italisë me Interin dhe po këtë mundësi e ka edhe këtë vit. Madje, ka mundësi të shpallet edhe kampion i Evropës, ngase Interi është në çerekfinalen e Ligës së Kampionëve.

Për vendin e tij, Ganën, ai luan që nga viti 2000, ku deri tani ka luajtur plot 52 ndeshje dhe ka shënuar 15 gola. Në kombëtare, ai ka pasur mjaft telashe me krerët e federatës së këtij vendi, duke u larguar disa herë nga kombëtarja dhe duke u kthyer prapë. Ai është përzgjedhur në mesin e futbollistëve që do të paraqiten për Ganën në Kampionatin Botëror "Afrika e Jugut 2010". ■



AUTOR: AGIM GASHI	ERË SHUMË E FUQISHME	PËSHPËRIS NËPËR DHËMBË	TËRËSIA E IMAMËVE	RUD ... NISTELROJ	THIRRJA PËR NAMAZ	DËSHMORI, KIÇINA	SINGAPURI	INDIA	TË LASHTA	E PËRCAKTOI MASËN	QË TË JEP FORCË	INSTITUTE for NEW ENERGY		SKIATORË
SHKOLLA E LARTË ME SHUMË FAKULTETE													SUEDIA / RRUGËTIMI	
MUAJI I AGJËRIMIT (pashq.)								BOSTAN / KRIJIMTARI MUZIKORE A LETRARE						
BANOR I AMANIT							POROSIA / TETOVA							
GENERALIZED ADDITIVE MODELS				KRIPA E ACIDIT NITRIK / AKTORJA, JOSIPI								ITALISHT / OSMANE		
SULMIME									PIKTURA KISHTARE					
DRAMË E JOSIP RELËS										LLOJ GAZI PA NGJYRË				
	SHOSHIT / JO E NJËJTA, E ...										SAHAT / I PESHËM			
FOSFORI		LLOJ USHQIMI BRUMOR	AMPERI / LËVRIMI							KËNGËTARJA, QAZIMI				ALI PASHË ... (Foto)
EMNAK I AMARËS										JO POSHTË				
ILAÇI										MAHI E ÇATISË				
EMËR MASHKULLI ILIR										SELENI			PORTUGALIA / KËRCIMTAR BALETI	
KËSTI MUJOR										TONI		BASHKIMI EVROPIAN / ELEMENT KIMIK		
DUKATI, FLORIRI				EDITIM	ANËCAKE	REPUBLIKA	ZBUKURIM, STOLI	IBRAHIM TUKIÇI	MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE	HERO ITALIAN				
GJUAJTJA ME BOMBA										KILOGRAM / LLOJ PIJEJE ALKOOLIKE				
JO KATION						HAPËSIRË QIELLORE / NEAR REAL TIME					CIËLSI LËKURE / PJESË NDËRTESE			
RADIUMI			ARMË E RËNDË LUFTARAKE / GJITAR BREJTËS					I VARFËR / BASHKËSIA ISLAME						
TELEFONI		BAKTER / SEKONDA							SOLISTI, SALI / KALIUMI					AUSTRIA
JO SIMETRIK										KËNGËTARJA, TARNER				